The European Union's IPA Civil Society Facility (CFS) Programme 2012-2013

Transparenca e procesit buxhetor tek komunat në Maqedoni

форум

Projekti është financuar nga
Bashkimi Evropian

Projekti është implementuar nga Qendra për
Analiza Ekonomike dhe Forum -CSID

Transparencat e procesit buxhetor tek komunat në Maqedoni

Dokument për politika:
Gjetje nga përcjellja e transparencës së procesit buxhetor te njësitë e vetëqeverisjes lokale në Maqedoni dhe rekomandime për përparim

QENDRA PËR ANALIZA EKONOMIKE (QAE)
FORUM- CSID

Dr. Borçe Trenovski
Mr. Vesna Gavranlieva Andonova
Dr. Marjan Nikollov
Sllagjan Penev
Iskra Andreeva
Ana Janevska Deleva

Projekti: Koalicioni për Monitorim Buxhetor
IPA 2014/338-852

Ueb-faqe:
www.kbm.mk
www.cea.org.mk
www.forum-csrd.org.mk

Projekti është financuar nga Bashkimi Evropian

Ky publikim është përgaditur me ndihmën e Unionit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e e autorëve dhe në asnjë mënyrë nuk reflekton opinionin e Unionit Evropian.

Shkup, 2015

Botues	Qendra për Analiza Ekonomike - QAE
Për botuesin	Marjan Nikollov
Titulli	Transparencat e procesit buxhetor tek komunat në Maqedoni Dokument për politika: Gjetje nga përcjellja e transparencës së procesit buxhetor te njësitë e vetë-qeverisjes lokale në Maqedoni dhe rekomandime për përparim
Autorë	D-r Borçe Trenovski M-r Vesna Gavranlieva Andonova D-r Marjan Nikolov Sllagjan Penev Iskra Andreeva Ana Janevska Deleva
Ilustrimi	Jordan Gjorçev
Tirazhi	100

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

336.146:352(497.7)(035)

TRANSPARENCA e procesit buxhetor tek komunat ne Maqedoni / [autore Borce Trenovski...[и др.] ; ilustrimi Jordan Gjorcev]. - Shkup : Qendra per analiza ekonomike-QAE, 2015. - 113 стр. : илустр. ; 21 см

Ауторё: Борсе Треновски, Весна Гарванлиева Андонова, Марјан Николов, Сллагјан Пенев, Искра Андреева, Ана Јаневска Делева. - Библиографија: стр. 95-96. - Содржи и: Dodatoci

ISBN 978-608-4731-23-8
1. Trenovski, Borce [автор] 2. Garvanlieva Andonova, Vesna [автор] 3. Nikolov, Marjan [автор] 4. Penev, Sllagjan [автор] 5. Andreeva, Iskra [автор] 6. Janevska Deleva, Ana [автор]
а) Локална самоуправа - Буџет - Транспарентност - Македонија - Прирачници
COBISS.MK-ID 99178506

Përmbajtja

Shkurtesa 5
Nocione bazë 6
Rezyme përmbaruese 9
Hyrje 13
Struktura dhe kontributi në analizën për transparencë buxhetore në nivel lokal 14
Pjesa 1 17
1.Transparenca buxhetore dhe përvojat ndërkombëtare për matjen e saj? 17
2.Nevoja për transparencë buxhetore në nivel lokal 21
Pjesa 2 24
3.Përcjellja e transparencës së procesit buxhetor të NJVL në Maqedoni 24
3.1.Struktura e metodologjisë 25
3.2.Procesi i implementimit 26
3.3.Sfida dhe kufizime në metodologjinë e krijuar 29
3.4.Baza për monitorimin e transparencës fiskale në nivel lokal në legjislacionin maqedonas 31
3.5.Metodologjia dhe qasja në monitorim 34
3.6.Pasqyra e rezultateve nga përcjellja e transparencës së procesit buxhetor të NJVL në Maqedoni 34
3.7.Qasja dhe adekuenca e strukturës së dokumenteve buxhetore bazë te komunat (Pyetësori 1) 35
3.8.Perceptimi i organizatave civile që kanë bërë monitorim për bashkëpunimin dhe gjetjet lidhur me transparencën e procesit buxhetor (Pyetësori 2) 48
3.8.1.Komunat në plan rajonin e Shkupit 48
3.8.2.Komunat në plan rajonin e Vardarit 50
3.8.3.Komunat në plan rajonin lindor 51
3.8.4.Komunat në plan rajonin jugperëndimor 52
3.8.5.Komunat në plan rajonin juglindor 53
3.8.6.Komunat në plan rajonin e Pellagonisë 55
3.8.7.Komunat në plan rajonin e Pollogut 56
3.8.8.Komunat në plan rajonin verilindor 57
3.9.Perceptimi i anëtarëve të Këshillit të komunave në NJVL për transparencën buxhetore (Pyetësori 3) 58
3.10.Perceptimi i punonjësve në NJVL për transparencën buxhetore (Pyetësori 4) 63
3.11.Perceptimi i qytetarëve, mediave lokale dhe organizatave civile për transparencën buxhetore në komunat e tyre (Pyetësori 5) 69
Pjesa 3 80
4.Përfundime dhe rekomandime 80
4.1.Gjendja e transparencës së procesit buxhetor dhe mësimet e marra 80
4.2.Përfundimet nga gjetjet mbi transparencën e procesit buxhetor 83
4.3.Rekomandime për përparimin e transparencës së procesit buxhetor 86
Bibliografia dhe literatura e shfrytëzuar 90

Shkurtesa

NJVL	Njësia e vetëqeverisjes lokale
BE	Bashkimi Evropian
KMB	Koalicioni për Monitorim Buxhetor
QAE	Qendra për Analiza Ekonomike
FORUM-CSID	Forum-Qendra për Hulumtime Strategjike dhe Dokumentacion
MVL	Ministria e Vetëqeverisjes Lokale
MF	Ministria e Financave
ESHR	Enti Shtetëror i Revizionit
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
PBN	Partneriteti Buxhetor Ndërkombëtar
IBH	Iniciativa për Buxhet të Hapur
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
IKP	Informata me karakter publik

Nocione bazë

Buxheti i R. së Maqedonisë është plan vjetor i të hyrave, i influkseve të tjera dhe i mjeteve të lejuara që përfshin Buxhetin qendror dhe buxhetet e fondeve.

Buxheti qendror është plan vjetor i të hyrave, i influkseve dhe mjeteve të tjera të lejuara, që kanë të bëjnë me shfrytëzuesit buxhetorë të pushtetit qendror dhe përfshin buxhetin bazë, buxhetin e donacioneve, buxhetin e huave dhe buxhetin e aktiviteteve vetëfinancuese.

Të dala janë të gjitha llojet e pagesave (nxjerrjet) nga buxhetet për destinimet e lejuara, përveç pagesës së kryegjësë së huave.

Të hyrat janë tatimet dhe pagesat tjera të domosdoshme të përcaktuara me ligj, influkset që dalin nga pronësia mbi mjetet (kamata, dividenda, qiraja dhe ngjashëm), kompensimet për të mirat ose shërbimet e dhëna, dhuratat, donacionet, subvencionet dhe transfertat.

Influkse të tjera janë të ardhura nga huatë, shitja e mjeteve kapitale, letrat shtetërore me vlerë të akorduar e të tjera.

Deficit buxhetor është ndryshimi negativ ndërmjet të hyrave të planifikuara, përkatësisht të paguara dhe mjeteve të lejuara, përkatësisht të dalave.

Suficit buxhetor është dallimi pozitiv mes të hyrave të planifikuara, përkatësisht të paguara dhe mjeteve të lejuara, përkatësisht të dalave.

Shfrytëzues buxhetor janë shfrytëzuesit e linjës së parë nga sfera e legjislacionit, pushtetit ekzekutiv dhe gjyqësor, fondeve, shfrytëzuesve të buxheteve të komunave dhe shfrytëzuesve të themeluar me ligj, të cilëve u është besuar kryerja e autorizimeve publike.

Klasifikimi buxhetor është pasqyrimi hierarkik i shifrave kushtuar klasifikimit të funksioneve, njësive organizative, aktiviteteve dhe transaksioneve ekonomike në mënyrë unike dhe konzistente.

Klasifikime buxhetore:

- ✓ **klasifikim organizacional,** që paraqet strukturën e shifrave për klasifikimin e shfrytëzuesve buxhetorë dhe të njësive të tyre gjegjëse strukturore në strukturën organizacionale hierarkike të shtetit,
- ✓ **klasifikim ekonomik,** që paraqet strukturën e shifrave për klasifikimin e të hyrave dhe influkseve të planifikuara e të realizuara, mjeteve të lejuara me

buxhet, të drejtave për shpenzim, obligimeve të ndërmarra e të dala dhe derdhjeve të realizuara,

- ✓ **klasifikim funksional,** që paraqet klasifikimin e funksioneve të pushtetit qendror dhe të komunave me klasifikimin e pranuar ndërkombëtar, të aktuar nga ana e Kombeve të Bashkuara,
- ✓ **klasifikim programor,** që paraqet strukturën e shifrave për klasifikimin e programeve dhe të nënprogrameve të përcaktuara me buxhet.

Pjesa e përgjithshme e buxhetit është pjesa e buxhetit që i përmban të hyrat e përgjithshme dhe influkset tjera dhe të dalat e përgjithshme dhe derdhjet tjera të buxhetit për vitin fiskal, si dhe projeksionet globale të të hyrave, të influkseve, të shpenzimeve dhe të derdhjeve për dy vitet në vazhdim dhe të dhëna të tjera.

Pjesa e veçantë e buxhetit është pjesa e buxhetit që e përmban planin e mjeteve të lejuara të shfrytëzuesve buxhetorë dhe të fondeve sipas programeve, nënprogrameve dhe zërave për vitin fiskal.

Pjesa zhvillimore e buxhetit është pjesë e buxhetit e cila i përmban planet e programeve për zhvillim të shfrytëzuesve buxhetorë.

Buxheti i komunave është plan vjetor i të hyrave, i influkseve dhe i mjeteve të tjera të lejuara dhe përfshin buxhetin bazë, buxhetin e dotacioneve, buxhetin e donacioneve, buxhetin e huave dhe buxhetin e aktiviteteve vetëfinancuese.

Buxheti bazë është plan vjetor i të hyrave, i influkseve dhe i mjeteve të tjera të lejuara me buxhetin për financimin e kompetencave bazë të shfrytëzuesve buxhetorë.

Buxheti i aktiviteteve vetëfinancuese është plan vjetor i të hyrave nga aktivitetet e shfrytëzuesve buxhetorë, përkatësisht shfrytëzuesve si njësi që i plotësojnë aktivitetet bazë të definuara me ligj dhe mjetet e lejuara.

Donacionet janë mjete të pakthyeshme, të marra nga qeveritë e shteteve të tjera ose nga organizatat ndërkombëtare, si dhe nga personat juridikë ose fizikë të vendit ose të huaj, që shfrytëzohen për të dala korrente ose kapitale në pajtim me kushtet dhe destinimet e kontraktuara me donatorin.

Buxhet i donacioneve është plani vjetor i të hyrave nga donacionet dhe mjetet e lejuara, të cilat shfrytëzohen me destinim të rreptë dhe në pajtim me kontratën e lidhur me donatorin.

Dotacione janë transfertat nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë që i shkojnë buxhetit të komunës.

Buxheti i dotacioneve është plani vjetor i të hyrave nga dotacionet dhe mjetet e lejuara të cilat shfrytëzohen për financimin e kompetencave të komunës, për financimin e një destinimi, kompetence, programi dhe projekti investues konkret.

Buxheti i huave është plan vjetor i influkseve nga huatë dhe mjetet e lejuara që shfrytëzohen për financimin e kompetencave, programeve dhe projekteve.

Rezyme përmbaruese

Transparencën buxhetore të njësive të vetëqeverisjes lokale, për nevojat e kësaj analize, e definojmë si qasje në kohë dhe të plotë në dokumentet e rëndësishme për procesin buxhetor për qytetarët dhe faktorët tjerë ndërlidhës. Gjatë një viti u ndoq qasja në tetë dokumente buxhetore të rëndësishme (Propozim-buxhet, Buxhet, Raporte tremujore për përmbarimin e Buxhetit, Llogari përfundimtare e komunës, Raport vjetor, Buxhet qytetar, Raport i revizionit, Statut). Qasja në dokumentet buxhetore u ndoq përmes ueb-faqeve të komunave, gazetave zyrtare të komunave, kërkesës për të marrë dokumentet përmes komunikimit direkt, si dhe qasjes tek informacionet me karakter publik. Në mënyrë plotësuese janë ndjekur edhe perceptimet për shkallën e transparencës dhe të pjesëmarrjes në procesin buxhetor te të gjitha komunat në Maqedoni, të më shumë palëve të ndërlidhura (qytetarëve, sektorit civil, këshilltarëve të këshillave komunalë, të të punësuarve në komuna etj.). Përcjellja është bërë sipas një metodologjie të përcaktuar në një periudhë prej një viti, për 80 komuna, nga ana e 20 organizatave si pjesë e Koalicionit për Monitorim Buxhetor.

Gjetjet kryesore nga monitorimi i kryer i transparencës së procesit buxhetor tek komunat në Maqedoni dëftojnë se ka hapësirë të mjaftueshme për përparimin e transparencës së procesit buxhetor, por gjithashtu ka edhe pengesa të konsiderueshme të cilat e dobësojnë lidhjen dhe komunikimin ndërmjet pushtetit lokal dhe qytetarëve, edhe atë:

- Matja e transparencës buxhetore te të gjitha komunat është sfidë për shkak të numrit më të madh të NJVL, ndërsa vetë procesi përfshin një numër të madh aspektesh dhe më shumë palë të ndërlidhura, të cilat në mënyrë direkte ose indirekte janë të lidhur me procesin buxhetor;
- Rregullativa ligjore lë mundësinë, por nuk i obligon komunat për paraqitjen e plotë të informatave dhe të dokumenteve që lidhen me procesin buxhetor;
- Komunat rrallë e publikojnë Propozim-buxhetin, i njëjti për vitin 2015 në ueb-faqet e NJVL ka qenë me qasje vetëm te 9 komuna, te 33 komuna është marrë pas kërkesës, ndërsa te 38 komunat tjera nuk ka qenë me qasje ose nuk është marrë;
- Buxheti i miratuar për vitin 2015 është marrë pothuajse te të gjitha komunat, edhe atë përmes ueb-faqeve të komunave, nga gazetat zyrtare ose mbi bazë të kërkesës së dorëzuar për të marrë dokumentin;
- Ka komuna të cilat ende nuk kanë ueb-faqe zyrtare funksionale (tri komuna), komuna që kanë ueb-faqe njëgjuhësore (8 komuna), informacione të papërditësuara (të vjetruara) të ueb-faqeve, faqe të cilat aspak nuk kanë dokumente që lidhen me buxhetin etj., që e vështirëson

përcjelljen e qasjeve në dokumente që kanë të bëjnë me transparencën buxhetore;

- Komunat përgatisin Llogarinë përfundimtare dhe Raportin vjetor, por të njëjtat nuk i publikojnë në tërësi në ueb-faqe; Llogaria përfundimtare për vitin 2014 ka qenë me qasje në ueb-faqe te 24 komuna, te 17 komuna e njëjta është publikuar në ueb-faqe në kuadër të gazetës zyrtare, për 30 komuna është marrë pas kërkesës, ndërsa për 9 komuna e njëjta nuk është marrë.
- Buxhet të NJVL me plan për buxhetin në vitet në vazhdim (një ose dy) ka vetëm te 19 komuna, ndërsa gjendja me borxhin si pjesë e buxhetit (viti 2014 ose 2015) publikohet vetëm te 9 komuna. Gjendja me borxhin te NJVL më shpesh arrihet të zbulohet pas dorëzimit të kërkesës për qasje tek informacionet me karakter publik.
- Buxheti qytetar, si publikacion i cili në mënyrë të thjeshtë, të kuptueshme e paraqet shpenzimin e NJVL dhe të Buxhetit, nuk është evidentuar në periudhën e monitorimit.
- Te numri më i madh i komunave në Maqedoni nuk ka informacione të kontaktit për këshilltarët e këshillit komunal, ndërsa një numër i madh i komunave nuk i publikojnë rendet e ditës ose diskutimet nga mbledhjet në Këshill, ndërsa shpesh prania në Këshill e qytetarëve ndiqet me procedura për të lejuar praninë;
- Pothuajse gjysma e anëtarëve të Këshillit të komunës rrallë shfrytëzojnë dokumente buxhetore, ndërsa 10% aspak nuk shfrytëzojnë dokumente buxhetore;
- Më shumë se gjysma e anëtarëve të këshillave komunalë konsiderojnë se i kuptojnë mirë dokumentet buxhetore, ndërsa 45% konsiderojnë se i kuptojnë pjesërisht. Shkaku më i shpeshtë që kuptohen pjesërisht dokumentet buxhetore është mungesa e kohës së mjaftueshme për t'i shqyrtuar ato, ndërsa struktura, stili dhe klasifikimet bashkë përbëjnë 53% e shkaqeve të theksuara;
- Si institucion më i rëndësishëm për nga pesha në procesin buxhetor, sipas këshilltarëve, është Këshilli komunal, ndjekur nga Kryetari komunal dhe Ministria e Financave, ndërsa dokumente më të rëndësishme buxhetore janë Propozim-buxheti, Buxheti i komunës, pastaj dhe Cirkulari buxhetor;
- Pjesëmarrës më të rëndësishëm që i kontribuojnë transparencës së procesit buxhetor për qytetarët dhe për anëtarët e këshillit komunal janë: pushtetet qytetëse, televizionet lokale dhe qytetarët dhe sektori civil;
- Më shumë se ¾ e këshilltarëve deklaruan se kanë ndikuar në marrjen e vendimeve për ndryshime të caktuara në buxhet, ndërsa pothuajse ¼ kanë deklaruar se nuk kanë ndikuar në ndryshimet në Buxhet;
- Të gjithë faktorët një nga një konsiderojnë se është i nevojshëm komunikimi më intensiv dhe më i hapur mes komunës dhe qytetarëve, si dhe aktiviteti më i madh nga të dyja palët për intensifikimin e pjesëmarrjes

së qytetarëve në procesin e krijimit të Buxhetit dhe realizimit të tij, gjë që do ta kishte shtuar transparencën dhe llogaridhënien;

- Nga të punësuarit të cilët drejtpërdrejt marrin pjesë në procesin buxhetor të komunës, 68% janë përgjigjur se shpesh i shfrytëzojnë dokumentet buxhetore të komunës, 1 çerek (26%) janë përgjigjur se rrallë i shfrytëzojnë; ndërsa pjesa më e madhe e tyre (79%) konsiderojnë se mirë i kuptojnë dokumentet buxhetore me të cilat punojnë, ndërsa 19% pjesërisht i kuptojnë, e si shkaqe që pjesërisht kuptohen ose nuk kuptohen dokumentet theksohen koha e pamjaftueshme dhe stili profesional me të cilin janë shkruar dokumentet;
- Mediat, qytetarët dhe organizatat qytetare më rrallë i shfrytëzojnë dokumentet buxhetore dhe atë 13% kanë deklaruar se shpesh i shfrytëzojnë dokumentet buxhetore, 43% rrallë i shfrytëzojnë dokumentet buxhetore, ndërsa 44% të tjerë aspak nuk shfrytëzojnë kurrfarë dokumentesh buxhetore;
- Më shumë se një çerek (27%) nga qytetarët e anketuar konsiderojnë se plotësisht i kuptojnë dokumentet buxhetore dhe financiare të komunave, më shumë se gjysma pjesërisht i kuptojnë (52%), ndërsa rreth 5% aspak nuk i kuptojnë dokumentet buxhetore të cilat i përgatit/i publikon komuna. Si shkaqe më të shpeshta theksohen (1) koha e pamjaftueshme, përkatësisht interesi i pamjaftueshëm për të njëjtat nga ana e qytetarëve, (2) stili profesional i dokumenteve, si dhe (3) klasifikimet e pakuptueshme;
- Sipas shikimeve të qytetarëve, si dokument më i rëndësishëm në procesin buxhetor llogariten (1) Buxheti i komunës (33%) dhe (2) Propozim-buxheti (31%).
- Një pjesë e madhe e qytetarëve konsiderojnë se komunat shumë rrallë ndërmarrin aktivitete për t'i thjeshtuar informacionet rreth buxhetit dhe shpenzimit të të hollave publike, ndërsa sipas tyre shkaqet më të shpeshta janë mungesa e interesimit të NJVL për nxjerrjen në dritë të këtyre informacioneve, "fshehja e informacioneve" apo mosdija për nevojën e *transparencës.*

Rekomandime të përgjithshme për përparimin e transparencës buxhetore në nivel lokal janë:

- *Ndryshimi i rregullativës ligore, me qëllim që komunat të obligohen që tërësisht të publikojnë Propozim-buxhetin, Buxhetin dhe Raportet e kohëpaskohshme për përmbarimin e buxhetit, të gjitha këto në kohë dhe në mënyrë të plotë;*
- *Publikimi i plotë dhe me detaje i dokumenteve dhe raporteve të rregullta për përmbarimin e Buxhetit, me të dhëna të cilat mundësojnë krahasimin me buxhetet e kaluara, si dhe me ato të planifikuara dhe të projektuara për periudhën vijuese;*

- *Mundësimi i revizionit të jashtëm më të rregullt/më të shpeshtë për të gjitha komunat;*
- *Instalimi i mekanizmave dhe procedurave për organizimin e rregullt të debateve publike dhe procesit të konsultimeve para nxjerrjes së Buxhetit, si dhe instalimi i mekanizmave për informimin dhe participimin e qytetarëve në procesin buxhetor;*
- *Përgatitja dhe praktikimi i publikimit të rregullt të buxhetit qytetar, si publikacion i cili do t'i informojë qytetarët për planin e të hyrave dhe të dalave buxhetore për vitin korrent, si dhe realizimi i buxhetit, në mënyrë të thjeshtë e të kuptueshme, për të gjithë qytetarët;*
- *Ndërmarrja e masave për rritjen e vetëdijes, interesit dhe aktivizmit të qytetarëve për të drejtat e tyre dhe të formave të pjesëmarrjes në punën e pushteteve komunale;*
- *Edukimi i anëtarëve të Këshillit komunal në pjesën e financave publike, të dokumenteve buxhetore, buxhetimit e të ngjashme, para se të merren funksionet, me qëllim që të merren vendime të informuara dhe efikase;*
- *Aktivizmi në organizatat qytetare, rrjetet dhe koalicionet të cilat kanë qëllim rritjen e transparencës dhe të llogaridhënies, por dhe vënien e lidhjeve (të bashkëpunimit dhe të kontakteve) me bartësit e vendimeve te pushteti lokal dhe të Këshillave, përmes të cilëve qytetarët do të jenë pjesëmarrës në marrjen e vendimeve.*

Hyrje

Planifikimi dhe zbatimi i Buxhetit të komunës paraqet planifikimin dhe zbatimin e planeve dhe prioriteteve të saj për periudhën e ardhshme njëvjeçare, që do të kenë ndikim në vitin kur është nxjerrë, por që do të jenë po ashtu me shumë rëndësi edhe për një numër aktivitetesh që do të realizohen në të ardhmen. Qytetarët presin një jetë cilësore, kështu që për këtë shkak qytetarët duhet të jenë të informuar se përse shpenzohen të hollat dhe çka fitojnë nga shpenzimi i buxhetit të komunës së tyre konform kompetencave.

Informacionet dhe njohuritë për shpenzimin e financave publike në Republikën e Maqedonisë janë të pamjaftueshme, ndërsa aktivitetet për kontrollimin e këtyre shpenzimeve janë të kohëpaskohshme dhe të pazhvilluara, në mënyrë të pamjaftueshme, kështu që pushtetet kanë mundësi që t'i harxhojnë të hollat e qytetarëve në mënyrë arbitrare, duke simuluar kohë pas kohe transparencë dhe llogaridhënie.

Një pjesë e madhe e komunave nuk i përfshin qytetarët në përgatitjen e buxhetit (propozimin e ideve që lidhen me alokimin e mjeteve buxhetore) dhe nuk janë shumë azhurne në paraqitjen e aktiviteteve buxhetore në ueb-faqet e tyre. Më shpesh të dhënat buxhetore mund të gjenden në gazetat zyrtare, por edhe ato më shpesh publikohen në ueb-faqet zyrtare me vonesa të shpeshta. Nga ana tjetër, vetëdija e qytetarëve është në nivel të ulët, gjë që më tej e determinon nivelin e ulët të interesit për shpenzimin e mjeteve publike. Kjo, për një pjesë të njësive të vetëqeverisjes lokale (NJVL) paraqet arsyetim për përpjekjet modeste që i bëjnë për paraqitjen transparente të aktiviteteve që i realizojnë. Çfarë të bëhet në këtë situatë?

Niveli i ulët i transparencës i procesit buxhetor në vetëqeverisjen lokale dhe zhvillimi i pamjaftueshëm i vetëdijes për kontrollin civil ndaj shpenzimit të të hollave publike po e thekson nevojën për mjete të reja dhe efektive për pjesëmarrje më të madhe të qytetarëve në procesin e marrjes së vendimeve në NJVL, nga njëra anë, dhe të mekanizmave për nxitjen e NJVL-ve që në mënyrë transparente dhe përmes llogaridhënies t'i realizojnë agjendat e tyre, nga ana tjetër.

Në Programin për zbatimin e procesit të decentralizimit dhe zhvillimit të vetë-qeverisjes lokale të Republikës së Maqedonisë 2011-2014, miratuar nga Ministria e Vetëqeverisjes Lokale, theksohet nevoja e inkurajimit të pjesëmarrjes civile në vendosjen për çështjet në pushtetin lokal dhe ngritjen e partneriteteve midis vetëqeverisjes lokale dhe shoqërisë civile, si dhe organizatave dhe trupave të tjerë relevantë. Mbështetet dhe nxitet zhvillimi i mekanizmave institucionalë për inkurajimin e pjesëmarrjes civile në proceset e vendosjes në nivel lokal dhe të forcimit të kapaciteteve të vetëqeverisjeve lokale për bashkëpunim me shoqërinë

civile, zbatimin e përbashkët të projekteve, si dhe të konsultimeve me grupe të caktuara të targetit në lidhje me politikat lokale. Transparenca dhe llogaridhënia janë theksuar si elemente të rëndësishme dhe që nxisin zhvillimin e shkathtësive të reja, të mjeteve dhe të praktikave në kuadër të vetëqeverisjes lokale dhe të shoqërisë civile e më gjerë, me qëllim që të mundësohet informimi i vazhdueshëm i qytetarëve.

Procesi i decentralizimit fiskal, që po zbatohet në dhjetë vitet e fundit, krahas rritjes së autonomisë fiskale, duhej të ndiqej me zhvillimin e kapaciteteve të NJVL për punë transparente dhe të mbështetur në llogaridhënie, si dhe në rritjen e vetëdijes të organizatave qytetare për monitorimin e transparencës së buxheteve të NJVL-së. Mungesa e përvojës dhe e njohjeve nga kjo sferë ishte shkak për mungesën e aktiviteteve dhe të mekanizmave që do të mundësonin monitorimin e transparencës fiskale në nivel lokal dhe përfshirjen e qytetarëve në krijimin dhe realizimin e buxheteve të NJVL në Republikën e Maqedonisë.

Ky ishte një ndër shkaqet për iniciativën e ngritur në kuadër të këtij projekti, që iu bashkua iniciativave të organizatave të tjera qytetare të cilat në disa vitet e fundit filluan ta aktualizojnë temën për punë transparente dhe llogaridhënëse të NJVL-së. Rritja e vetëdijes te qytetarët për mënyrën e shpenzimit të të hollave të tyre në nivel lokal e hapi "rrethin e transparencës", e cila më tej çon kah iniciativa e përforcuar për përfshirjen e tyre në procesin buxhetor dhe drejt presionit të vazhdueshëm ndaj NJVL për një punë sa më transparente në vetëqeverisjet lokale. Megjithatë, që të hapej ky rreth, ishte e nevojshme përpjekja e përbashkët nga më shumë organizata nga tërë territori i R. së Maqedonisë, të cilat mbi bazë të dëshmive (analizës dhe përcaktimit të shkallës së transparencës të NJVL) do të mund edhe më tej të ndikojnë në rritjen e nivelit të transparencës fiskale në nivel lokal. Qëllimi dhe objektivi ynë në kuadër të Koalicionit për Monitorim Buxhetor ishte pikërisht ky – të krijojmë masë kritike e cila do të angazhohet për transparencë më të lartë në NJVL në tërë territorin e R. Maqedonisë.

Struktura dhe kontributi në analizën për transparencë buxhetore në nivel lokal

Hulumtimet tona tregojnë se qytetarët kanë njohje të pamjaftueshme për proceset buxhetore, e sidomos për procedurat përmes të cilave nxirret dhe realizohet buxheti. Prandaj njëri prej qëllimeve kryesore të aktiviteteve që i përgatitëm në bashkëpunim me përfaqësuesit e organizatave qytetare nga të gjitha rajonet planore në Republikën e Maqedonisë është rritja e transparencës së proceseve buxhetore në vetëqeverisjet lokale, me përfshirjen e përfaqësueseve të shoqërisë civile në proceset e vendosjes, si dhe me inkurajimin e qytetarëve që t'i kontrollojnë shpenzimet e financave publike.

Çka nevojitej që të arrihej kjo? U desh të trajnohen organizatat qytetare që duan të marrin pjesë në proceset e lidhura me buxhetet komunale, sesi në mënyrë të saktë, në kohë dhe me një konzistencë metodologjike ta monitorojnë procesin buxhetor në NJVL. Me aktivitetet e KMB-së synojmë të ndikojmë në instalimin e praktikave më transparente nga ana e pushteteve lokale në lidhje me procesin e krijimit dhe të harxhimit të buxheteve komunale. Por, gjithashtu duam të arrijmë edhe një rezultat tjetër shumë të rëndësishëm – krijimin e klimës së re, ku qytetarët do të mund të ndërmarrin rol aktiv në buxhetimin lokal, duke i theksuar prioritetet e tyre gjatë kohës së procesit të krijimit të buxheteve lokale, si dhe të interesimit gjithnjë e më të madh që të mbikëqyret harxhimi i të hollave të qytetarëve.

Hapat logjik kyç për përmbushjen e këtyre qëllimeve dhe detyrave, që i shtruam para nesh në periudhën e kaluar, mund të sublimohen në këtë mënyrë:

1) Krijimi i Koalicionit për Monitorim Buxhetor, që e mbulon tërë territorin e R. së Maqedonisë;

2) Përgatitja e Doracakut për monitorimin e procesit buxhetor, që duhet t'u shërbejë aktivistëve dhe organizatave lokale në monitorimin e tyre të proceseve buxhetore, si dhe i mundësisë që të konsultohen shembuj ndërkombëtarë relevantë për përcjelljen e transparencës buxhetore;

3) Përfaqësues të trajnuar të sektorit civil për ndjekjen profesionale dhe të sistemuar të procesit buxhetor dhe të aktiviteteve fiskale në nivel lokal;

4) Monitorimi i parë prej një viti, i realizuar në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes lokale në R. e Maqedonisë nga ana e Koalicionit për Monitorim Buxhetor, duke pasur për mentor QAE dhe Forum-CSID.

Në studimin "Transparenca e procesit buxhetor në nivel lokal", më parë janë përpunuar konceptet për transparencë fiskale në nivel nacional dhe lokal, është dhënë një analizë e shkurtër për gjendjen në R. të Maqedonisë (niveli i transparencës dhe legjislacioni), është elaboruar metodologjia e cila është zhvilluar për përcaktimin e transparencës fiskale në nivel lokal, janë sublimuar rezultatet nga analiza nga sfera të ndryshme, të dhëna me konkluzione dhe rekomandime që dalin nga hulumtimi i bërë.

Cili është kontributi i këtij studimi dhe cila është rëndësia e tij për R. e Maqedonisë dhe rajonin:

- Duke e pasur parasysh që nuk ka udhëzues dhe metodologji ndërkombëtare për analizën e transparencës në nivel lokal, ky studim do ta japë kontributin e vet në plotësimin e këtij jazi në kuadër global;
- Kjo është përpjekja e parë për monitorimin e transparencës buxhetore në nivel lokal në tërë territorin e shtetit;

- R. e Maqedonisë do të jetë një ndër vendet e para në rajon (në përjashtim të Kroacisë) që e përpilon këtë analizë;
- Analiza që e bëjmë do të jetë e bazuar në përcjelljen për një kohë më të gjatë e transparencës në nivel lokal (në dallim nga analizat e mëparshme);
- Është bërë përpjekje që të eliminohen disa prej mungesave që hasen te metodologjitë në analizat-pilot, të realizuara më parë;
- Përmes metodologjisë së krijuar për këtë problematikë mundësohet që komunat dhe organizatat qytetare ta përcaktojnë dhe ta përmirësojnë transparencën në nivel lokal.

Kufizimet dhe sfidat që janë paraqitur gjatë realizimit të hulumtimit:

- Nuk ka metodologji ndërkombëtare me pranim të gjerë për matjen e transparencës në nivel lokal;
- Në R. e Maqedonisë nuk ekzistonte më parë infrastruktura e definuar (rrjeti) i organizatave qytetare që mund të realizojnë një aktivitet kaq kompleks;
- Edhe pse në sektorin civil ekzistonin do njohje për konceptin e transparencës dhe të llogaridhënies, nuk kishte masë kritike të organizatave të cilat në mënyrë të sistemuar dhe sipas një metodologjie të qartë do të mund ta analizonin dhe ta përcaktonin transparencën fiskale. Kjo përbënte një kufizim të veçantë nga aspekti i disperzimit lokal të organizatave të këtilla qytetare;
- Organizimi dhe mentorimi i Koalicionit për Monitorim Buxhetor (rrjeti i organizatave qytetare) ishte sfidë e veçantë duke pasur parasysh dallimet në kapacitetin e tyre, njohjet e mëparshme, sferën ku punojnë, si dhe disiplinën e tyre në realizimin e aktiviteteve;
- Harmonizimi i dallimeve te të dhënat/informatat të marra nga organizata të ndryshme që janë pjesë e rrjetit, analiza e bazës së madhe të të dhënave që u mblodh, selektimi i segmenteve më të rëndësishme dhe paraqitja e sublimuar e tyre në hapësirën e kufizuar.

Duke e pasur parasysh se kjo është përpjekja e parë për monitorimin e transparencës së procesit buxhetor tek NJVL në tërë territorin e shtetit, shpresojmë që kjo përpjekje e jonë të jetë një bazë e mirë që në të ardhmen të ndërmerren hulumtime edhe më serioze dhe më vëllimore në këtë sferë, duke përparuar metodologjinë dhe duke zbatuar leksionet e arritura që rezultuan nga realizimi.

Pjesa 1

1. Transparenca buxhetore dhe përvojat ndërkombëtare për matjen e saj?

Transparenca fiskale është element kyç për një menaxhim efektiv me financat publike, përcaktimin e rreziqeve fiskale, marrjen në mënyrë racionale të vendimeve financiare, rritjen e llogaridhënies së kreatorëve të politikave dhe krijimin më të mirë të politikës fiskale. Transparenca fiskale siguron që qeveritë të jenë të hapura përpara publikut për strukturën dhe funksionet e shtetit, pozicionet fiskale, rreziqet potenciale, benefitet kundrejt harxhimeve nga aksionet dhe projeksionet financiare. Transparenca fiskale mundëson një nivel më të lartë debati ndërmjet kreatorëve të politikave dhe të opinionit publik për disenjimin dhe rezultatet nga politikat fiskale dhe i furnizon legjislatorët, tregjet dhe qytetarët me informacione që janë të nevojshme për ta në përcjelljen e llogaridhënies për aktivitetet fiskale. Sipas Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECDE) dhe një numri studimesh të tjera, transparenca dhe llogaridhënia fiskale për financa publike është një ndër parakushtet për stabilitet më të mirë makroekonomik dhe fiskal, për rejting më të mirë kreditor, për disiplinë më të mirë fiskale (borxhi dhe deficiti publik më i ulët), për shkallë më të ulëta korrupsioni dhe determinanta për shkallë më të larta të rritjes ekonomike (IMF factsheet, 2014).

Si e definojmë transparencën fiskale? FMN (2008) e shfrytëzon termin transparencë fiskale dhe e definon si: "të jesh i hapur ndaj opinionit publik për aktivitetet fiskale të kaluara, të tashme dhe të ardhme të shtetit, si dhe për strukturën dhe funksionet e shtetit, të cilat i determinojnë politikat dhe rezultatet fiskale". OECD e definon transparencën fiskale si një paraqitje të plotë publike të të gjitha informacioneve fiskale relevante, në kohë dhe në mënyrë sistematike (OECD, 2002). IBP (International Budget Partnership, 2008) e definon transparencën buxhetore si mundësi që njerëzit në një vend të kenë qasje tek informacionet për atë se sa të dala publike janë bërë sipas pozicioneve të caktuara dhe sa/si janë grumbulluar të hyrat publike.

Në dekadën e fundit, sidomos pas Krizës së madhe ekonomike (2007-2009), studimet që e konfirmojnë rëndësinë e transparencës fiskale dhe apelet për rritjen e saj u bënë më të zëshme dhe më të shpeshta. Tri shkaqe kryesore qëndrojnë pas rivlerësimit të organizatave ndërkombëtare në drejtim të rritjes së transparencës fiskale (Cottarelli, 2012): së pari, në një numër të madh vendesh (veçanërisht në vendet e zhvilluara) studimet treguan se pozicionet fiskale – borxhi dhe deficiti publik nuk janë të definuara dhe të vendosura në mënyrë adekuate; e dyta, në një

numër të madh rastesh vendet i nënçmojnë rreziqet fiskale me të cilat ballafaqohen, veçmas ato që vijnë nga sektori financiar; dhe shkaku i tretë është çrregullimi i dukshëm i pozicioneve fiskale dhe i nevojave për konsolidim në një numër të madh vendesh në fillim të krizës globale. E gjithë kjo e konfirmon në mënyrë të qartë nevojën për revitalizimin e përpjekjeve ndërkombëtare për përmirësimin e transparencës fiskale në të gjitha nivelet.

Literatura akademike dhe hulumtimet që kanë të bëjnë me transparencën fiskale (dhe transparencën e institucioneve buxhetore) për vendet në zhvillim është në formë të rrallë dhe të rudimentuar. Më shpesh hulumtimet e realizuara udhëzojnë se mungesa e kapaciteteve, sektori civil joefikas/i pazhvilluar dhe faktorët politik veprojnë si faktorë kufizues për modernizimin dhe rritjen e nivelit të transparencës të institucioneve buxhetore (Allen, 2009). Në këto vende targetet numerike dhe kufizimet formale të shpenzimeve publike dhe deficitet buxhetore zakonisht ekzistojnë vetëm në letër dhe të njëjtat nuk zbatohen në paktikë. Shkaku për këtë shihet në atë që mekanizmat që i obligojnë institucionet t'u nënshtrohen rregullave, procedurave për transparencë dhe rregullave/procedurave që e sigurojnë llogaridhënien e institucioneve shtetërore, zakonisht nuk janë me definim dhe organikë të mirë. Sipas kësaj, rritja e transparencës dhe e llogaridhënies tek institucionet buxhetore, gjithëpërfshirja e procesit buxhetor dhe diseminacioni publik i dokumenteve buxhetore dhe i informatave mund të jetë me rëndësi të jashtëzakonshme madje edhe atëherë kur nuk ka rregulla formale (Campos and Pradhan, 1996). Studimet që janë publikuar në të kaluarën në mënyrë dominante fokusohen në nivelin nacional, ndërsa studimet e fokusuara në nivel lokal janë vërtet të rralla. Sipas kësaj, ka një jaz të madh në hulumtimin në nivel global të kësaj problematike, ku studimi ynë duhet të japë kontribut modest.

Analizat dhe hulumtimet që kanë të bëjnë me transparencën fiskale zakonisht shfrytëzojnë metodologji (më shpesh, pyetësor ose anketë) e cila mundëson që të bëhet matja e nivelit të transparencës fiskale, të llogariten indekset që mundësojnë në të ardhmen rangimin e vendeve, rajoneve ose njësive lokale. Në kuadër të këtij grupi të hulumtimeve vetëm një numër i kufizuar i analizave janë të fokusuara në përcaktimin e transparencës fiskale në nivel lokal. Sipas kësaj, për matjen e transparencës buxhetore/fiskale në nivel lokal ende nuk është instaluar ndonjë metodologji ndërkombëtarisht e pranuar. Hulumtimet kryesisht shfrytëzojnë metodologjitë të cilat tashmë aplikohen për përcaktimin e nivelit të transparencës në nivel nacional. Një prej hulumtimeve relevante të rralla në këtë sferë është studimi i cili i analizon metodologjitë e shfrytëzuara në dhjetë projekte-pilot të IBP-së (Argjentina, Bolivia, Brazili, Kroacia, Ekuadori, India, Indonezia, Mali, Mongolia dhe Peru), të cilat gjithashtu paraqesin hapin e parë drejt zhvillimit të doracakut dhe të metodologjisë për matjen e transparencës buxhetore në nivel lokal (shih Kroth, IBP, 2012). Bilis dhe Tomson (2010) e kanë matur transparencën fiskale të 136 komunave në Virxhinia, SHBA, përmes analizimit të informacioneve

me qasje në ueb-faqet e tyre. Bubeta etj. (2010) e kanë përcaktuar transparencën fiskale të 33 komunave në Galici, Spanjë, duke shfrytëzuar pyetësorin mbi bazë të Kodit të FMN-së dhe njohjes së autorëve të procesit buxhetor në vend.

KORNIZA 1

Nga rajoni ynë, analiza/metodologjia e vetme për transparencën fiskale në nivel lokal është rasti i Kroacisë. Kroacia e zhvilloi metodologjinë dhe e realizoi hulumtimin në disa hapa. Së pari, ishte kryer hulumtimi i cili mbulonte më shumë aspekte nga transparenca fiskale në nivel lokal (shih Institut javnih finansija, 2010). Si e realizoi Kroacia analizën iniciale? Analiza (mbi bazë të pyetësorit) për matjen e transparencës buxhetore lokale në 33 qytete (njehsimi i Indeksit për transparencë buxhetore lokale – COLBI). Më tej, ishte realizuar anketa mes përfaqësuesve lokalë që u dorëzojnë informacione trupave ekzekutiv në nivel lokal, trupave që e përfaqësojnë komunën, asociacionet qytetare lokale dhe përfaqësuesit nga Ministria e Financave.

Çfarë rezultatesh dha analiza për transparencën fiskale në rastin e Kroacisë?

- Pjesa më e madhe e komunave nuk përfshin klasifikim funksional të të dalave në Propozim-buxhet dhe në raportet buxhetore
- Pjesa më e madhe e komunave/qyteteve nuk kanë shpjegim narrativ sipas klasifikimit funksional për të hyrat/të dalat (derisa ka shpjegim modest për pjesën programore)
- Pothuajse 80% e komunave nuk kanë buxhet qytetar
- Pjesa më e madhe e komunave nuk prezantojnë të dhëna adekuate për vitet e mëparshme dhe ato në vazhdim në Propozim-buxhet
- 80% nuk prezantojnë parashikime makroekonomike në Propozim-buxhet
- Mospublikim të rendeve të ditës për mbledhjet e Këshillit në ueb-faqet zyrtare dhe mospublikim të dokumenteve të tjera (varion)
- Diskrepancë në pikëpamjet për shkëmbimin e dokumenteve dhe transparencë mes anëtarëve të pushtetit/opozitës në Këshill
- Një pjesë e madhe e asociacioneve qytetare nuk i kuptojnë dokumentet buxhetore
- Më tej, hulumtimi i hapjes dhe transparencës fiskale ishte harmonizuar në më shumë raste; e njëjta i përfshin të gjitha zhupanitë, komunat dhe qytetet në Kroaci, ndërsa fokusin e vet e ka ruajtur vetëm në qasjen ndaj transparencës në lidhje me pesë dokumentet buxhetore – Propozim - buxhetin, Buxhetin e miratuar, Raportet gjysmëvjetore, Llogarinë vjetore dhe Buxhetin qytetar (shih Ott, Bronic, Petrusic, 2013, 2014, 2015).

Rezultatet nga këto cikle të hulumtimeve tregojnë se:

- Edhe pse shkallë-shkallë përmirësohet niveli i transparencës në nivel lokal, i njëjti ende është shumë larg nivelit të kënaqshëm;
- Nga aspekti i llojeve të njësive lokale më transparente janë zhupanitë, qytetet janë dukshëm më pak transparente, ndërsa komunat janë jotransparente;

- Numri i banorëve, i të hyrave buxhetore ose puna e njësive lokale nuk ndikojnë dukshëm në rezultatet për transparencën, pas së cilës mund të supozohet se niveli i transparencës në mënyrë dominante varet nga vullneti politik i pushteteve lokale.

Definimi i transparencës buxhetore është proces i vështirë, megjithatë është një sfidë jazakonisht e madhe matja e saj. Kjo është kështu për shkak se hulumtues dhe institucione të ndryshme shfrytëzojnë mënyra të ndryshme për matjen e nivelit të transparencës - më shpesh përmes pyetësorëve ose anketave. Më parë i përmendëm studimet të cilat bëjnë përpjekje për përcaktimin e transparencës fiskale në nivel lokal, ndërsa në vazhdim do të bëjmë vetëm një shqyrtim të shkurtër të metotodologjive më relevante me pranim ndërkombëtar mbi të cilat e ka fundusin pjesa dominate e hulumtimit tonë:

1. Kodi i praktikave të mira në transparencën fiskale të FMN. Më parë i publikuar në vitin 1998, më vonë i zgjeruar në vitin 2007 dhe, edhe një herë pas sfidave të Krizës së madhe ekonomike. (IMF 2014, Cottarelli, 2012) bashkë me doracakun dhe udhëzuesin e FMN e paraqesin thelbin e standardeve globale për transparencën fiskale (IMF, 2017). Në vite ky dokument e ka siguruar kornizën për vlerësimin e transparencës fiskale për një numër të madh vendesh (93 vende) si pjesë e Raporteve për mbikëqyrjen e standardeve dhe të kodeve të FMN (ROSC).
2. OECD-praktika më të mira për transparencë buxhetore. Janë të disenjuara si praktika referenciale, të cilat qeveritë duhet t'i shfrytëzojnë me qëllim rritjen e e nivelit të transparencës në vendet e tyre. Praktikat më të mira janë të ndara në tri pjesë: pjesa e parë i prezanton raportet buxhetore kryesore dhe strukturën e tyre, e dyta ka të bëjë me informacionet specifike financiare dhe jofinanciare, të cilat duhet t'i përmbajnë këto dokumente/raporte; dhe pjesa e tretë i sublimon prtaktikat më të mira për sigurimin e kualitetit dhe të integritetit të këtyre raporteve (OECD, 2002).
3. Udhëzuesi për pyetësorin për buxhet të hapur të IBP 2012 (2006-2012) përfshin mbi 100 vende nga e tërë bota dhe analizon tri aspekte se si qeveritë qeverisin me financat publike: së pari e mat transparencën buxhetore, ku për çdo vend është përcaktuar indeksi për buxhet të hapur (Open Budget Index), i cili lëviz në shkallë prej 0 deri në 100; e dyta, pjesëmarrja në procesin buxhetor; e treta, organika dhe efikasiteti i institucioneve supervizore.

Kuadri 2 - leksionet e mësuara për transparencën buxhetore në nivelin lokal
Leksionet e mësuara nga analizat e bëra gjer më tani për transparencën buxhetore në nivel lokal (Kroth, 2012):

- Informacionet buxhetore në të shumtën e rasteve nuk janë me qasje për për opinionin publik
- Dokumentete buxhetore shpeshherë janë të paqarta dhe në formë të paktueshme për opinionin publik
- Ka mosharmonizime të dukshme në legjislacion ndërmjet pushtetit qendror dhe lokal
- Grumbullimi i të dhënave në këtë sferë është mjaft problematik

2. Nevoja për transparencë buxhetore në nivel lokal

Procesi i decentralizimit që ende bëhet në shtetin tonë bëri që një pjesë e madhe e të mirave publike të sigurohen nga njësitë e vetëqeverisjes lokale, e gjithashtu edhe ingjerecat e tyre në grumbullimin e të hyrave për realizimin e tyre janë gjithnjë e më të mëdha. Sipas kësaj, me qëllim që të mirat publike nga njësitë lokale të realizohen në mënyrë sa më efikase, duhet të përmbushen dy kushte: qytetarët duhet t'i njohin mirë buxhetet lokale (planet për shpenzimin dhe sigurimin e të mirave publike në nivel lokal) dhe në mënyrë aktive të marrin pjesë në procesin buxhetor. Kjo, nga njëra anë, është direkt e lidhur me transparencën dhe me qasjen tek informacionet për të hyrat dhe të dalat buxhetore lokale (dokumente), ndërsa nga ana tjetër, në mënyrë indirekte do të ndikonte në llogaridhënien e pushteteve lokale për aktivitetet dhe procedurat e tyre. Megjithëkëtë, ky proces nuk është i thjeshtë, duke pasur parasysh njohuritë e kufizuara të qytetarëve për procesin buxhetor, si dhe mospasjen e shpeshtë të qasjes në informacione/dokumente të caktuara që kanë të bëjnë me të njëjtën. Për këto shkaqe aktiviteti ynë projektues u drejtua kah:

- monitorimi dhe përcaktimi i transparencës fiskale në nivel lokal;
- prezantimi i rezulatateve për rritjen e njohurive te qytetarët dhe nxitjen e debatit publik, dhe
- rritjen e llogaridhënies së pushteteve lokale.

Të sublimuara dhe drejtpërdrejt, shkaqet për nevojën nga monitorimi/rritja e transparencës fiskale në nivel lokal mund të nxirren nga një studim i Iniciativës për buxhet të hapur (Open Budget Initiative OBI) – **Përse është e rëndësishme transparenca në nivel lokal** (Kroth, 2012, OBI):

1. *I monitoron praktikat e pushtetit lokal, të cilat kanë rëndësi të veçantë për alokacionin e resurseve dhe sigurimin e shërbimeve*
2. *I zbulon zbrazëtirat në menaxhmentin financiar publik në nivel lokal dhe ka potencial për uljen e korrupsionit dhe të gabimeve në qeverisje*

3. *I ndjek rrjedhat financiare nga burimi deri te vendi i shfrytëzimit të tyre, jep përgjigje për çështjet ex-post të përmbarimit, implementimit dhe të furnizimit*
4. *E rrit llogaridhënien para opinionit publik për çështje me interes publik (shkolla, infrastrukturë etj.)*
5. *E stimulon dhe e rrit aktivitetin qytetar dhe debatin publik*
6. *Mundëson monitorimin dhe ndihmën gjatë kontrollit të borxheve lokale*
7. *Mundëson krahasimin në nivel nacional dhe nxit konkurrencën në nivel ndërlokal.*

Hapja e dyerve për qytetarët në procesin buxhetor është hap i rëndësishëm për demokratizimin e qeverisjes në vetëqeverisjet lokale. Transparenca buxhetore e lehtëson qasjen e qytetarëve tek informacionet për të hyrat dhe të dalat e pushteteve në nivel qendror dhe lokal, e meqë buxhetet janë dokumentet kryesore ku janë theksuar prioritetet e pushteteve në lidhje me politikat, qasja më e lehtë e qytetarëve tek ato është parakusht për pjesëmarrjen publike në shpërndarjen e mjeteve publike.

Duke u mundësuar qytetarëve që të ndërmarrin rol aktiv në proceset buxhetore, përmes theksimit të nevojave dhe prioriteteve të tyre gjatë procesit të propozimit të buxhetit, do të rritet interesi i qytetarëve për mbikëqyrje në një afat më të gjatë jo vetëm për atë se si harxhohen të hollat e tyre (publike), por edhe se si realizohen idetë e tyre.

Buxheti transparent, me qasje të lehtë dhe lehtë i kuptueshëm, është karakteristikë e pushtetit llogaridhënës. Transparenca e tillë e lehtëson mbikëqyrjen e shpenzimit të financave publike dhe e dekurajon keqpërdorimin e këtyre mjeteve nga ana e pushteteve. E, po qe se qytetarët kanë besim në harxhimin e financave publike, do të jenë më të motivuar që t'i paguajnë tatimet dhe taksat, gjë që sërish në mënyrë pozitive do të pasqyrohet edhe te Buxheti i vetëqeverisjes lokale.

Si plotësim të kësaj në vazhdim i prezantojmë **gjashtë parimet sipas të cilave duhet të udhëhiqemi gjatë rritjes së transparencës në nivel lokal,** të nxjerra nga hulumtimi i Iniciativës së partneritetit të IBP (IBP Partnership Initiative, Lakin, 2011):

1. Pushtetet lokale duhet t'i sigurojnë informacione plotësisht transparente dhe gjithëpërfshirëse publikut, në lidhje me të hyrat dhe të dalat e buxhetuara dhe faktike në të gjitha fazat e procesit buxhetor
2. Pushtetet lokale duhet të jenë të kontrolluara (revizion) në mënyrë interne dhe eksterne, gjithashtu edhe raportet e revizorëve duhet të jenë me qasje për publikun (me të gjitha pjesët konform akteve ligjore)
3. Aty ku pushtetet lokale kanë pasur diskrecionin në shfrytëzimin e fondeve, që u janë transferuar nga nivelet tjera të pushtetit, ose nga të hyrat e tyre

personale, duhet të jepet mundësia që Këshilli lokal dhe qytetarët ta japin inputin e tyre në më shumë faza të procesit buxhetor.

4. Buxheti i nxjerrë në nivel qendror dhe lokal duhet të përmbajë informacione të detajuara (kuantitative dhe kualitative) për transfertat nga nivelet tjera të pushtetit, përfshi madhësinë e tyre, rregullat/parimet sipas të cilave janë marrë dhe janë harxhuar (ku është e mundur, edhe formula sipas së cilës janë distribuuar).
5. Distribuimi i mjeteve ndërmjet njësive sub-nacionale duhet ta ketë parimin e barazimit dhe duhet të udhëhiqet nga nevoja/kërkesa për shërbime (e jo vetëm nga ana e ofertës/infrastruktura, personeli). Buxheti duhet të përmbajë informata narrative dhe kuantitative për nevojën/kërkesën për shërbime në lidhje me atë se si janë distribuuar mjetet.
6. Aty ku fondet janë të decentralizuara, Propozim-buxheti dhe dokumentet tjera buxhetore që janë me qasje publike duhet të përmbajnë informata narrative për përgjegjësitë e secilit nivel të pushtetit në lidhje me sigurimin e shërbimeve të decentralizuara, zyrave publike ose personave përgjegjës dhe fondeve/mjeteve që janë të ndara për ato përgjegjësi.

Pjesa 2

3. Përcjellja e transparencës së procesit buxhetor të NJVL në Maqedoni

Derisa për matjen dhe monitorimin e transparencës në nivel nacional ekzistojnë studime dhe hulumtime të shumta, shumë rrallë ose pothuajse aspak nuk ka hulumtime dhe metodologji të definuara për përcaktimin e transparencës në nivel lokal. Numri më i madh i studimeve që merren me matjen e transparencës në nivel nacional, të njëjtën e realizojnë përmes plotësimit të pyetësorëve, të cilët në të shumtën e rasteve janë të bazuar te doracakët nga metodologjitë e zhvilluara nga FMN, OECD dhe OBI.

Së *këndejmi, bazat e transparencës fiskale/buxhetore në nivel nacional janë vënë në:*

- "Kodi i praktikave të mira për transparencë fiskale i Fondit Monetar Ndërkombëtar" (2007)
- "Praktika më të mira për transparencë buxhetore" e Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (2002).
- Indeksi për buxhet të hapur (OBI)

Megjithatë, situata është specifike kur nevojitet të shfrytëzohet metodologjia ndërkombëtarisht e përcaktuar për matjen e transparencës në nivel lokal, e më specifike është situata kur transparenca në nivel lokal duhet të përcillet/të monitorohet në mënyrë të vazhdueshme në një periudhë të caktuar kohore[1] (siç është rasti në projektin tonë).

- Nuk është me qasje publike/nuk ekziston/ nuk është marrë

	Propozim-buxheti	Buxheti i nxjerrë	Raportet tremujore	Llogaria përfundimtare	Raporti vjetor	Buxheti qytetar	Raport nga revizioni	Statuti
Novaci	Publikisht	Publikisht	Publikisht	Publikisht	Publikisht	Nuk	Nuk	Publikisht
Resnjë	Nuk	Publikisht	Është me qasje pas kërkesës joformale ose LQIKP	Publikisht	Publikisht	Nuk	Nuk	Publikisht
Manastir	Publikisht	Publikisht	Publikisht	Publikisht	Publikisht	Nuk	Nuk	Publikisht
Prilep	Nuk	Publikisht	Publikisht	Publikisht	Publikisht	Nuk	Nuk	Publikisht
Krushevë	Publikisht	Publikisht	Është me qasje pas kërkesës joformale ose LQIKP	Është me qasje pas kërkesës joformale ose LQIKP	Është me qasje pas kërkesës joformale ose LQIKP	Nuk	Nuk	Publikisht
Dollneni	Nuk	Publikisht	Publikisht	Publikisht	Publikisht	Nuk	Nuk	Publikisht
Demir-Hisar	Nuk	Publikisht	Nuk	Publikisht	Nuk	Nuk	Nuk	Publikisht
Krivogashtani	Nuk	Publikisht	Publikisht	Publikisht	Publikisht	Nuk	Nuk	Publikisht
Mogilla	Publikisht	Publikisht	Është me qasje pas kërkesës joformale ose LQIKP	Është me qasje pas kërkesës joformale ose LQIKP	Është me qasje pas kërkesës joformale ose LQIKP	Nuk	Nuk	Publikisht

Qasja në dokumente Lidhur me procesin buxhetor

Rajoni planor i Pollogut

- Publikisht është me qasje në ueb-faqe
- Publikisht është me qasje si pjesë e gazetës zyrtare në internet
- Është me qasje pas kërkesës joformale ose LQIKP
- Nuk është me qasje publike/nuk ekziston/ nuk është marrë

	Propozim-buxheti	Buxheti i nxjerrë	Raportet tremujore	Llogaria përfundimtare	Raporti vjetor	Buxheti qytetar	Raport nga revizioni	Statuti
Tearcë	✕	Është me qasje pas kërkesës joformale ose LQIKP	✕	Është me qasje pas kërkesës joformale ose LQIKP	Është me qasje pas kërkesës joformale ose LQIKP	✕	✕	Është me qasje pas kërkesës joformale ose LQIKP
Bërvenicë	Është me qasje pas kërkesës joformale ose LQIKP	Është me qasje pas kërkesës joformale ose LQIKP	Është me qasje pas kërkesës joformale ose LQIKP	Është me qasje pas kërkesës joformale ose LQIKP	Është me qasje pas kërkesës joformale ose LQIKP	✕	✕	✕
Bogovinë	Është me qasje pas kërkesës joformale ose LQIKP	Publikisht është me qasje në ueb-faqe	Është me qasje pas kërkesës joformale ose LQIKP	Është me qasje pas kërkesës joformale ose LQIKP	Është me qasje pas kërkesës joformale ose LQIKP	✕	✕	Publikisht është me qasje në ueb-faqe
Vrapçisht	✕	Është me qasje pas kërkesës joformale ose LQIKP	Është me qasje pas kërkesës joformale ose LQIKP	✕	✕	✕	✕	✕
Gostivar	✕	Publikisht është me qasje si pjesë e gazetës zyrtare në internet	Publikisht është me qasje si pjesë e gazetës zyrtare në internet	Publikisht është me qasje si pjesë e gazetës zyrtare në internet	Publikisht është me qasje si pjesë e gazetës zyrtare në internet	✕	✕	Publikisht është me qasje në ueb-faqe
Zhelinë	✕	Publikisht është me qasje në ueb-faqe	Është me qasje pas kërkesës joformale ose LQIKP	Publikisht është me qasje në ueb-faqe	Është me qasje pas kërkesës joformale ose LQIKP	✕	Publikisht është me qasje në ueb-faqe	Është me qasje pas kërkesës joformale ose LQIKP
Jegunovcë	✕	Është me qasje pas kërkesës joformale ose LQIKP	✕	Është me qasje pas kërkesës joformale ose LQIKP	Është me qasje pas kërkesës joformale ose LQIKP	✕	✕	Publikisht është me qasje në ueb-faqe
Mavrovë-Rostushë	✕	Publikisht është me qasje në ueb-faqe	✕	Publikisht është me qasje në ueb-faqe	✕	✕	✕	Publikisht është me qasje në ueb-faqe
Tetovë	Është me qasje pas kërkesës joformale ose LQIKP	Publikisht është me qasje si pjesë e gazetës zyrtare në internet	✕	Publikisht është me qasje si pjesë e gazetës zyrtare në internet	Publikisht është me qasje si pjesë e gazetës zyrtare në internet	✕	✕	Publikisht është me qasje në ueb-faqe

Qasja në dokumente
Lidhur me procesin buxhetor

Rajoni planor verilindor

- Publikisht është me qasje në ueb-faqe
- Publikisht është me qasje si pjesë e gazetës zyrtare në internet
- Është me qasje pas kërkesës joformale ose LQIKP
- Nuk është me qasje publike/nuk ekziston/ nuk është marrë

	Propozim-buxheti	Buxheti i nxjerrë	Raportet tremujore	Llogaria përfundimtare	Raporti vjetor	Buxheti qytetar	Raport nga revizioni	Statuti
Kumanovë	Është me qasje pas kërkesës joformale ose LQIKP	Publikisht është me qasje si pjesë e gazetës zyrtare në internet	Është me qasje pas kërkesës joformale ose LQIKP	Është me qasje pas kërkesës joformale ose LQIKP	Është me qasje pas kërkesës joformale ose LQIKP	Nuk është me qasje publike/nuk ekziston/ nuk është marrë	Nuk është me qasje publike/nuk ekziston/ nuk është marrë	Është me qasje pas kërkesës joformale ose LQIKP
Kratovë	Nuk është me qasje publike/nuk ekziston/ nuk është marrë	Është me qasje pas kërkesës joformale ose LQIKP	Është me qasje pas kërkesës joformale ose LQIKP	Është me qasje pas kërkesës joformale ose LQIKP	Është me qasje pas kërkesës joformale ose LQIKP	Nuk është me qasje publike/nuk ekziston/ nuk është marrë	Nuk është me qasje publike/nuk ekziston/ nuk është marrë	Është me qasje pas kërkesës joformale ose LQIKP
Kriva-Pallanka	Nuk është me qasje publike/nuk ekziston/ nuk është marrë	Publikisht është me qasje si pjesë e gazetës zyrtare në internet	Është me qasje pas kërkesës joformale ose LQIKP	Publikisht është me qasje si pjesë e gazetës zyrtare në internet	Është me qasje pas kërkesës joformale ose LQIKP	Nuk është me qasje publike/nuk ekziston/ nuk është marrë	Nuk është me qasje publike/nuk ekziston/ nuk është marrë	Publikisht është me qasje si pjesë e gazetës zyrtare në internet
Likovë	Nuk është me qasje publike/nuk ekziston/ nuk është marrë	Është me qasje pas kërkesës joformale ose LQIKP	Është me qasje pas kërkesës joformale ose LQIKP	Është me qasje pas kërkesës joformale ose LQIKP	Është me qasje pas kërkesës joformale ose LQIKP	Nuk është me qasje publike/nuk ekziston/ nuk është marrë	Nuk është me qasje publike/nuk ekziston/ nuk është marrë	Është me qasje pas kërkesës joformale ose LQIKP
Rankovcë	Është me qasje pas kërkesës joformale ose LQIKP	Publikisht është me qasje si pjesë e gazetës zyrtare në internet	Është me qasje pas kërkesës joformale ose LQIKP	Publikisht është me qasje si pjesë e gazetës zyrtare në internet	Është me qasje pas kërkesës joformale ose LQIKP	Nuk është me qasje publike/nuk ekziston/ nuk është marrë	Nuk është me qasje publike/nuk ekziston/ nuk është marrë	Është me qasje pas kërkesës joformale ose LQIKP
Staro Nagoriçan	Nuk është me qasje publike/nuk ekziston/ nuk është marrë	Është me qasje pas kërkesës joformale ose LQIKP	Është me qasje pas kërkesës joformale ose LQIKP	Nuk është me qasje publike/nuk ekziston/ nuk është marrë	Nuk është me qasje publike/nuk ekziston/ nuk është marrë	Nuk është me qasje publike/nuk ekziston/ nuk është marrë	Nuk është me qasje publike/nuk ekziston/ nuk është marrë	Është me qasje pas kërkesës joformale ose LQIKP

Propozim-buxhetin, si dokument, komunat rrallë e publikojnë, e atje ku tek ai ka qasje Propozim-buxheti kryesisht mund të shihet gjatë periudhës që i prin nxjerrjes/miratimit të Buxhetit për vitin e ardhshëm. I njëjti është me qasje të rrallë, në të vërtetë për vitin 2015 Propozim-buxheti në ueb-faqet e NJVL ka qenë me qasje vetëm te 9 komuna, ndërsa i njëjti te 33 komuna për nevojat e procesit të monitorimit që është marrë pas kërkesës, ndërsa te 38 komuna të tjera nuk ka mundur të arrihet ose nuk është marrë për nevojat e hulumtimit në periudhën në shqyrtim[10]. Duke marrë parasysh rëndësinë e Propozim-buxhetit dhe qasjen tek ai nga një numër më i madh qytetarësh para nxjerrjes të buxhetit në vitin në vazhdim, e me qëllim të informimit më të madh të qytetarëve dhe të mundësimit të pjesëmarrjes së tyre në dhënien e propozimeve, ky dokument edhe pse i ranguar si më i rëndësishëm nga ana e qytetarëve (shih perceptimin dhe mendimin e qytetarëve për dokumentin buxhetor) nuk shikohet dhe nuk ka qasje të mjaftueshme për qytetarët dhe për faktorët tjerë.

Buxheti i miratuar për vitin 2015 kishte qasje dhe u mor nga të gjitha komunat (përveç nga dy komuna) dhe i njëjti është publikuar në ueb-faqet e komunave në pjesën e veçantë që ka të bëjë me buxhetin dhe me dokumentet e ndërlidhura, që e bënë atë më të shikueshëm (te 38 komuna), ose në kuadër të gazetave zyrtare të komunave me qasje në ueb-faqet (te 11 komuna). Te komunat tjera Buxheti është marrë përmes kërkesës joformale nga ana e organizatave lokale ose pas dorëzimit të kërkesës për qasje tek informacionet me karakter publik (te gjithsej 29 komuna). Në të vërtetë, ka komuna të cilat aspak nuk kanë ueb-faqe (gjatë periudhës së monitorimit tri komuna: Zelenikova, Çuçer-Sandeva, Pllasnica), të tjerat që janë vetëm në gjuhën shqipe (në periudhën e monitorimit: Haraçina, Saraji, Çairi, Likova, Tearca, Vrapçishti, Zhelina, Dibra) me ndërprerje të kohëpaskohshme në funksionimin e faqeve, informacione jo të azhurnuara (të vjetruara) në ueb-faqe etj., gjë që e vështirëson përcjelljen e qasjes në dokumente, përveç vizitave dhe kërkesave personale për qasje në dokumentet buxhetore të komunës. Plus kësaj, qasja në dokumente në lidhje me strukturën është e ndryshme. Në të vërtetë, qasja në dokumentin i cili pjesërisht është publikuar (disa faqe/nene të buxhetit, apo konkluzioni nga mbledhja për nxjerrjen e buxhetit) nuk mund të klasifikohet si me qasje publike, edhe pse te disa komuna publikimi i këtillë i pjesërishëm është praktikë. Te dhjetëra komuna, edhe pse gjatë periudhës së monitorimit shumë herë ishin kërkuar të njëjtat dokumente, pjesa më e madhe e tyre nuk e vunë (dokumentin) në praktikën e azhurnimit dhe të publikimit të tyre të rregullt përmes ueb-faqeve.

---

[10] Periudha e përcjelljes është prej 15 korrik 2014 deri më 15 korrik 2015, përmes organizatave lokale që i përcjellin NjVL-të në rajonin planor të dhënë. Duke pasur parasysh se periudha e përcjelljes filloi në korrik të vitit 2014, Propozim-buxheti për vitin 2014 ishte me qasje vetëm pas kërkesës dhe për një numër të vogël komunash. Propozim-buxhetet për vitin 2015 ishin përcjellë në periudhën relevante kur ato përgatiten dhe publikohen.

Raportet tremujore për përmbarimin e buxhetit të komunës më rrallë publikohen në ueb-faqet e komunave e shumë më shpesh publikohet vetëm konkluzioni nga mbledhja e Këshillit për miratimin e raporteve tremujore nga përmbarimi i buxhetit, më shpesh në kuadër të gazetave zyrtare. Komunat që dallohen për nga shembujt e mirë për publikimin e rregullt të raporteve tremujore për përbarimin e buxhetit janë: Gazi-Baba, Karposhi, Manastiri, Vinica, Prilepi, Novaci, Ohri, Struga, etj.

Për periudhën e shqyrtuar mund të përcaktohet se që nga fillimi i periudhës së monitorimit janë arritur përmirësime në publikimin e raporteve tremujore, ose në ueb-faqe, ose në kuadër të gazetave zyrtare. Deri te raporti tremujor i fundit për përmbarimin e buxhetit, që ishte me qasje, mund të konstatojmë se shtatë komuna i publikojnë rregullisht në pjesën e veçantë të faqes së tyre, 13 i publikojnë në kuadër të gazetave zyrtare (tërësisht ose vetëm vendimet), 48 komuna i dorëzuan pas kërkesës (e-posta/telefon, personalisht ose zyrtarisht përmes kërkesës për qasje në IKP), ndërsa për 13 komuna raportet tremujore nuk janë marrë.

Komunat përgatisin **Llogarinë përfundimtare dhe Raportin vjetor** (në pajtim me rregullativën ligjore[11]), por të njëjtat nuk i publikojnë tërësisht në ueb-faqet. Praktika dëfton se këto dokumente buxhetore publikohen më shpesh pjesërisht ose, ndërkaq, të njëjtat merren pas kërkesës, gjë që e rëndon dukshëm qasjen e qytetarëve tek këto informacione, në kohë dhe në mënyrë të plotë. Në kontekst të publikimit "parcial" të të dhënave buxhetore të disagreguara sipas zërave[12], të dhënat për harxhimin e mjeteve buxhetore rrallë publikohen. Ka përjashtime, por të njëjtat nuk janë praktikë. Megjithatë, te pjesa më e madhe e komunave në raportet vjetore për përmbarimin e buxhetit, të përgatitura i kanë të gjitha elementet që i përmban buxheti, të paraqitura si të hyra/të dala të planifikuara dhe të realizuara. Në të vërtetë, llogaria përfundimtare për vitin 2014 është me qasje në ueb-faqet e 24 komunave, te 17 komuna e njëjta është publikuar në kuadër të gazetës zyrtare në ueb-faqe, për 30 komuna janë marrë pas kërkesës dhe për 9 komuna e njëjta nuk është marrë. Raportet vjetore për vitin 2014 janë marrë nga 65 komuna (8 përmes ueb-faqes në pjesën e veçantë, 18 nga gazetat zyrtare, ndërsa 39 pas kërkesës).

Në periudhën e monitorimit te Buxhetet për vitin 2015, me qasje dhe të fituara, te 15 komuna (nga 80) buxheti i miratuar nuk ka të dhëna për klasifikimin e të dalave sipas funksionit (sipas destinimit – funksionit të shpenzimeve), te Buxhetet e 68 NJVL publikohen të dalat sipas klasifikimit funksional, ndërsa te të tjerat nuk është e njohur. Te 34 komuna në buxhetin për vitin 2015 ekziston klasifikimi i të

[11] Ligji për financimin e NjVL

[12] Prezantimi analitik i të dalave të realizuara

dalave sipas shfrytëzuesve (te të tjerët nuk ka ose është e pjesshme), ndërsa te 69 komuna të dalat në buxhet janë paraqitur sipas programeve për realizim.

Edhe pse buxheti i komunës është dokument i cili duhet të jetë mjet për realizimin e qëllimeve strategjike në afat të mesëm (τ+2)[13], megjithatë pjesa nga **Buxheti i NJVL si dokument që ka qasje, nuk e përmban arsyetimin për të dhënat makroekonomike ose indikatorëve të tjerë ekonomik** (përjashtim janë Gjorçe Petrovi dhe Llozova), plan për buxhetin në dy vitet e ardhshme (τ+1/τ+2) ka në 19 komuna, ndërsa gjendja e borxhit si pjesë e buxhetit (viti 2014 ose 2015) publikohet vetëm te 9 komuna. Gjendja e borxhit te pjesa më e madhe e NJVL është fituar pas kërkesës së dorëzuar për qasje në informacione me karakter publik (si pjesë e raporteve tremujore që përgatiten për Këshillin komunal).

Buxheti qytetar, si publikim i cili në mënyrë të thjeshtë, të kuptueshme e paraqet harxhimin e NJVL dhe buxhetin, e që i kushtohet publikut joprofesional, nuk është identifikuar tek asnjë NJVL në periudhën e monitorimit. Ekzistonin disa përpjekje në vitin e kaluar të paraqitjes të raportit vjetor të disa komunave, megjithatë nuk është bërë praktikë e rregullt dhe nuk ka përparim në paraqitje. Ky indikator i lidhur me treguesit se qytetarët tregojnë dhe kanë nevojë nga prezantimi i informatave financiare, përkatësisht të buxhetit, si dhe i harxhimit të të hollave publike në komunën e tyre në një mënyrë të thjeshtë dhe të kuptueshme, moskuptimi i dokumenteve buxhetore për shkak të stilit dhe klasifikimeve, e bën të nevojshme kërkesën për instalimin e praktikës nga ana e NJVL në përgatitjen e buxhetit qytetar.

Revizioni i jashtëm te NJVL kryhet nga ESHR sipas programeve vjetore[14], ku selektohet një numër i caktuar i NJVL (sipas programit për vitin 2014 janë planifikuar 21 NJVL, ndërsa për vitin 2015 janë planifikuar 6) dhe kryhet revizioni i raporteve financiare dhe revizioni i harmonizimit. Të njëjtat janë me qasje në ueb-faqen e Entit Shtetëror të Revizionit, ndërsa rrallë janë me qasje në ueb-faqet e NJVL (përjashtim bëjnë Karposhi, Zhelina, Llozova, Dellçeva, Ohri, të cilat i publikojnë raportet nga revizioni i jashtëm për më shumë vite më parë, përkatësisht për ato vite për të cilat është bërë revizioni nga ana e ESHR). Këto raporte janë me qasje në faqet e ESHR nga viti 2002, ndërsa në ueb-faqet e tyre i kanë publikuar vetëm pesë komuna.

---

[13]Kahet themelore për përgatitjen e buxheteve të NjVL për vitin 2015, Ministria e Financave: "Me qëllim që të përgatitet një buxhet efektiv të komunës për vitin 2015, është e nevojshme të planifiohet procesi buxhetor, përkatësisht të përfshihen këto faza: I Vënia e qëllimeve strategjike të komunës për vitin 2015, 2016 dhe 2017, me përmbajtje në programet për zhvillim, me të cilat do të sigurohet kryerja efikase e kompetencave dhe përmbushja e nevojave të qytetarëve ..."

[14] Neni 23 i Ligjit për revizion shtetëror

Statutet e komunave, ku përcaktohen parimet bazë të pjesëmarrjes së qytetarëve, te pjesa më e madhe e komunave janë me qasje, përveç për 8 komuna, për të cilat gjatë monitorimit nuk arritëm t'i marrim përmes organizatave që bënin monitorimin.

3.8. Perceptimi i organizatave civile që kanë bërë monitorim për bashkëpunimin dhe gjetjet lidhur me transparencën e procesit buxhetor (Pyetësori 2)

Gjatë kryerjes së monitorimit të procesit buxhetor në komunat organizatat lokale (dhjetë organizata me përfaqësues të tyre) i kanë ndjekur proceset dhe me qëllim që të merren më shumë informata organizatat kanë qenë në kontakt me komunat përmes punonjësve në komunat dhe anëtarëve të Këshillit. Kështu, duke evidentuar ndryshimet dhe aktivitetet, si dhe përmes perceptimit të tyre për nivelin e hapjes për bashkëpunim të përfaqësuesve të komunave, organizatat lokale kanë mbajtën shënime në bazë mujore.

3.8.1. Komunat në plan rajonin e Shkupit

Në lidhje me bashkëpunimin me komunat në plan rajonin e Shkupit, monitoruesit na organizatat Akcija Zdruzhenska dhe ZIP Institut kanë konstatuar se gati në të gjitha komunat në përgjithësi kanë pasur bashkëpunim të mirë. Përjashtime dhe ndryshime në bashkëpunimin gjatë monitorimit njëvjeçar janë evidentuar në Komunën e Kisella Vodës, ku madje kah fundi i monitorimit është evidentuar bashkëpunim i pjesërishëm, dhe përmirësim i dukshëm me Komunën Qendër nëse krahasohet fillimi me fundin e periudhës së monitorimit. Pengesa më e madhe në komunat e rajonit të Shkupit, kur bëhet fjalë për monitorimin e procesit buxhetor dhe disponueshmërinë e dokumenteve buxhetore paraqet mungesa e ueb faqeve aktive dhe e komunikimit elektronik, prandaj edhe nevoja për vizita të detyrueshme personale me qëllim që të merren dokumentet buxhetore. Për këtë arsye, qasja në to është dukshëm e vështirësuar, duke marrë parasysh se nëse qytetarët janë të interesuar t'i kërkojnë informatat është e nevojshme të shkojnë në komunë, të kërkojnë personin përgjegjës dhe të presin që dokumenti t'u jepet në letër. Këtu bëjnë pjesë komunat Butel, Sopishtë, Saraj, Çair, Haraçinë.

Në një pjesë të komunave ku dokumentet nuk janë të disponueshme në ueb faqe, dokumentet e kërkuara janë dorëzuar relativisht shpejtë, në një periudhë prej një deri në dhjetë ditë në 6 komuna, në 7 komuna deri edhe në 30 ditë, ndërsa në disa komuna për dokumente të caktuara nuk është marrë asnjë përgjigje.

Lidhur me kërkesat e dërguara, nuk ekziston diçka që në veçanti theksohet, për shkak se varësisht nga nevoja dhe nga periudha kohore janë kërkuar dokumente të ndryshme të cilat janë shqyrtuar në këtë periudhë.

Kontakti me këshilltarët dhe punonjësit në komunat

Në 11 komuna nga rajoni i Shkupit në ueb faqet e tyre ekziston listë e këshilltarëve me emër dhe mbiemër, ndërsa informata më të hollësishme duke përfshirë emrat, përkatësinë politike, postën elektronike dhe numrin e telefonit ka vetëm në disa komuna, edhe atë në Sopishtë, Gazi Babë dhe Gjorçe Petrov. Në pesë komuna në ueb faqet e tyre nuk ka asnjë informatë për këshilltarët (Saraj, Haraçinë, Shuto Orizarë, Studeniçan), kurse Komuna e Zelenikovës nuk ka ueb faqe. Kontakte me punonjësit në administratën e komunave që janë të lidhur drejtpërsërdrejti me aktivitetet e buxhetimit (Njësia për buxhet, financa) ka në tetë komuna nga komunat e Shkupit (e-mail dhe/ose telefon), ndërsa në 12 komuna në ueb faqet e tyre nuk ka informata për kontakt për punonjësit.

Gjashtë komuna i publikojnë agjendat ditore të seancave të Këshillit në ueb faqet e tyre (në Aerodrom, Gazi Babë, Karposh dhe Kisella Vodë rregullisht, kurse në Gjorçe Petrov dhe Qendër ndonjëherë), ndërsa komunat e tjera nuk i publikojnë. Diskutimet (edhe pse shpeshherë vendime) nga mbledhjet e Këshillit janë të disponueshme përsëri vetëm në komunat Karposh, Kisella Vodë, Qendër, Aerodrom dhe Gjorçe Petrov.

Në nëntë komuna statutet e tyre kërkojnë që agjendat ditore dhe materialet të bëhen publike, ndërsa 9 komuna në statutet e tyre kanë pjesë që më afër e definojnë transparencën dhe/ose llogaridhënien e qeveritarëve të qytetit lidhur me procesin buxhetor. Pikërisht ato janë: Buteli, Gazi Baba, Studeniçani Zelenikova, Sopishtja, Saraji, Çairi, Haraçina dhe Shuto Orizarja.

Pjesëmarrja në seancat e Këshillit të komunave në rajonin e Shkupit në përgjithësi është e hapur dhe me paralajmërim, mirëpo e ngarkuar me leje për pjesëmarrje dhe pëlqim gjegjësisht leje nga Këshilli tek disa komuna, me çka në veçanti theksohet Komuna e Kisella Vodës (ku vetëm një herë është marrë leje pas disa përpjekjeve), apo vështirë merret informatë lidhur me kohën e saktë për mbajtjen e seancave të Këshillit, sikur në Komunën e Petrovecit.

Gjatë përpjekjeve për të marrë pjesë në seancat (janë bërë 41 përpjekje, mirëpo gjatë 4 përpjekjeve organizatave nuk u është lejuar pjesëmarrja) monitoruesit morën leje për pjesëmarrje së paku një herë pothuajse në të gjitha komunat, por gjithashtu janë ballafaquar edhe me komente dhe vërejtje të ndryshme, si dhe refuzim për pjesëmarrje në seancat, sikur në komunat Studeniçan, Çuçer Sandevë dhe Kisella Vodë, sugjerime që të mos marrin pjesë në seancë të caktuar, leje për prezencë vetëm për disa pika të caktuara të agjendës ditore, ndryshime të

shpeshta të datës dhe kohës së seancave të caktuara më parë, që e vështirëson pjesëmarrjen dhe ngjajshëm.

Aktivitete për përfshirjen e qytetarëve në procesin buxhetor

Gjatë monitorimit njëvjeçar, prej shtatëmbëdhjetë komunave nga rajoni i Shkupit, të dy organizatat monitoruese që i kanë ndjekur komunat konstatuan se në nëntë komuna Kryeprefekti apo Këshilli organizojnë aktivitete me qëllim që qytetarët të përfshihen në procesin buxhetor, edhe atë përmes Forumeve të bashkësisë (të financuara nga donatorë të huaj), diskutimeve publike dhe takimeve me qytetarët. Këto konstatime bazohen në ndjekjen e ueb faqeve, komunikimin me qytetarët dhe komunikimin me punonjësit në komunat). Në asnjërën nga komunat nuk është vërejtur diskutim publik, as për Projekt buxhetin e as për raportin vjetor (shqyrtimi në seancën e Këshillit nuk konsiderohet si diskutim publik).

3.8.2. Komunat në plan rajonin e Vardarit

Organizata Fokus e cila ka kryer monitorimin e procesit buxhetor në plan rajonin e Vardarit, ka konstatuar se në të gjitha komunat ka bashkëpunim të mirë kur bëhet fjala për përfaqësuesit të cilët janë të përfshirë drejtpërsëdrejti në procesin buxhetor. Gjatë kërkimit të dokumenteve që kanë të bëjnë me procesin buxhetor, monitoruesit më së shpeshti i kanë marrur në afat prej 1 deri në 5 ditë. Ato janë marrur përmes postës elektronike, kanë qenë të publikuara në ueb faqe ose janë dërguar me postë. Më së shpeshti janë kërkuar datat dhe agjendat ditore të seancave të Këshillit, pastaj Buxheti dhe raportet tremujore për realizimin e buxhetit të komunës.

Kontakti me këshilltarët dhe punonjësit në komunat

Në 8 nga gjithsej 9 komuna nga rajoni i Vardarit në ueb faqet e tyre ekziston listë e këshilltarëve me emër dhe mbiemër, ndërsa informata më të hollësishme duke përfshirë emrat, përkatësinë politike, postën elektronike dhe/ose numrin e telefonit ka vetëm në komunat Sveti Nikole dhe në Veles.

Ndërsa gjatë monitorimit janë përmirësuar listat e kontakteve në shumicën e komunave, ndërkohë që në një komunë, atë të Kavadarit, ende nuk ka listë apo ndonjë informatë për kontakt të këshilltarëve.

Sa i përket kontakteve me punonjësit në administratën e komunave që janë të lidhur drejtpërsëdrejti me aktivitetet e buxhetimit (Njësia për buxhet, financa), në ueb faqet e komunave të rajonit të Vardarit (e-mail dhe/ose telefon) nuk ka informata për kontakt me punonjësit përkatës.

Dy komuna rregullisht i publikojnë agjendat ditore të seancave të Këshillit në ueb faqet e tyre (Sveti Nikole dhe Veles), ndërsa komunat e tjera nuk i publikojnë. Diskutimet nga mbledhjet e Këshillit janë rregullisht të disponueshme në Veles,

Gradsko (praktikë e vendosur), Negotinë, Rosoman dhe Sveti Nikole, kurse ndonjëherë janë pjesërisht të disponueshme (vetëm vendimet).

Në gjashtë komuna statutet e tyre kërkojnë që agjendat ditore dhe materialet të bëhen publike, ndërsa në tre komuna kjo nuk ekziston (Llozovë, Sveti Nikole dhe Rosoman). Njëkohësisht, pesë komuna në statutet e tyre kanë pjesë që më afër e definojnë transparencën dhe/ose llogaridhënien e qeveritarëve të qytetit lidhur me procesin buxhetor (Sveti Nikole, Kavadarë, Llozovë, Rosoman dhe Çashkë).

Pjesëmarrja në seancat e Këshillit të komunave në rajonin e Vardarit në përgjithësi është e hapur me paralajmërim, dhe gjatë përpjekjeve për të marrë pjesë në seancat (23 prezenca në seancat e këshillave) monitoruesit kanë pasur mundësi të jenë prezent së paku një herë në të gjitha komunat, pa komente dhe vërejtje të posaçme.

Aktivitete për përfshirjen e qytetarëve në procesin buxhetor

Gjatë monitorimit njëvjeçar, prej nëntë komunave nga rajoni i Vardarit, monitoruesit kanë konstatuar se në gjashtë komuna Kryeprefekti apo Këshilli organizojnë aktivitete me qëllim që qytetarët të përfshihen në procesin buxhetor, edhe atë përmes forumeve, takimeve, diskutimeve publike, me atë se në Veles, Kavadarë, Gradsko, Negotinë dhe Demir Kapi janë organizuar diskutime publike ose sesione të forumeve për Projekt buxhetin, ndërsa në asnjë nga komunat nuk është vërejtur diskutim publik për raportin vjetor apo Llogarinë përfundimtare (shqyrtimi në seancën e Këshillit nuk konsiderohet si diskutim publik).

3.8.3. Komunat në plan rajonin lindor

Organizata Fondacioni për zhvillim të bashkësisë lokale, e cila ka kryer monitorimin e procesit buxhetor në plan rajoni lindor, ka konstatuar se gati në të gjitha komunat ka bashkëpunim të mirë kur bëhet fjala për përfaqësuesit të cilët janë të përfshirë drejtpërsëdrejti në procesin buxhetor, megjithëse bashkëpunim i pjesërishëm me përfaqësuesit e komunave që janë të lidhur drejtpërsëdrejti me procesin buxhetor është evidentuar në Karbinci dhe Dellçevë.

Gjatë kërkimit të dokumenteve që kanë të bëjnë me procesin buxhetor, monitoruesit më së shpeshti i kanë marrur ato në afat prej 1 deri në 10 ditë, edhe atë përmes postës elektronike. Më së shpeshti janë kërkuar Buxheti, Llogaria përfundimtare dhe raportet tremujore për realizimin e buxhetit të komunës.

Kontakti me këshilltarët dhe të punësuarit në komunat

Në të gjitha 11 komunat e rajonit lindor në ueb faqet e tyre ekziston listë e këshilltarëve me emër dhe mbiemër, ndërsa informata më të hollësishme duke përfshirë emrat, përkatësinë politike, postën elektronike dhe numrin e telefonit ka vetëm në: Koçanë, Vinicë dhe Shtip. Kontakte me punonjësit në administratën e

komunave që janë të lidhur drejtpërsëdrejti me aktivitetet e buxhetimit (Njësia për buxhet, financa) në komunat e këtij rajoni ka vetëm në Dellçevë dhe Zërnovcë.

Shtatë komuna deri në fund të monitorimit kanë vendosur praktikë t'i publikojnë agjendat ditore të seancave të Këshillit në ueb faqet e tyre (ose pjesërisht), ndërsa diskutimet nga mbledhjet e Këshillit janë të disponueshme në Vinicë, Berovë dhe Zërnovcë.

Sipas monitoruesve në këtë rajon, komunat në statutet e tyre nuk kërkojnë që agjendat ditore dhe materialet të bëhen publike, ndërsa tre komuna në statutet e tyre kanë pjesë që më afër e definojnë transparencën dhe/ose llogaridhënien e qeveritarëve të qytetit lidhur me procesin buxhetor, edhe atë në Shtip, Koçanë dhe Berovë.

Pjesëmarrja në seancat e Këshillit të komunave në rajonin lindor në përgjithësi është e hapur me paralajmërim ose pëlqim, dhe gjatë përpjekjeve për të marrë pjesë në seancat e Këshillit (janë ndjekur 19 mbledhje të këshillave) monitoruesit kanë qenë prezent në të gjitha komunat, edhe atë pa komente dhe vërejtje të posaçme.

Aktivitete për përfshirjen e qytetarëve në procesin buxhetor

Gjatë monitorimit njëvjeçar të njëmbëdhjetë komunave në rajonin lindor, monitoruesit kanë konstatuar se në shtatë komuna Kryeprefekti apo Këshilli organizojnë aktivitete me qëllim që qytetarët të përfshihen në procesin buxhetor, edhe atë përmes forumeve, takimeve, diskutimeve publike, shpalljeve, tribunave me bashkësitë lokale, dhe se në Shtip, Probishtip, Koçanë, Vinicë dhe Makedonska Kamenicë janë organizuar diskutime publike për Projekt buxhetin, ndërsa në asnjë komunë nuk është vërejtur diskutim publik për raportin vjetor apo Llogarinë përfundimtare (shqyrtimi në seancën e Këshillit nuk konsiderohet si diskutim publik).

3.8.4. Komunat në plan rajonin jugperëndimor

Organizata monitoruese e cila ka kryer ndjekjen e procesit buxhetor lidhur me bashkëpunimin e komunave në plan rajonin jugperëndimor, Qendra për zhvillim të qëndrueshëm të bashkësisë – Dibër, ka konstatuar se gati në të gjitha komunat ka bashkëpunim të mirë kur bëhet fjala për përfaqësuesit të cilët janë të përfshirë drejtpërsëdrejti në procesin buxhetor.

Gjatë kërkimit të dokumenteve që kanë të bëjnë me procesin buxhetor, monitoruesit më së shpeshti i kanë marrur ato në afat prej 1 deri në 5 ditë, dhe më së shpeshti janë kërkuar Buxheti, Llogaria përfundimtare, raportet tremujore për realizimin e buxhetit të komunës dhe gjendja e borxhit.

Kontakti me Këshilltarët dhe punonjësit në komunat

Në ueb faqet e shtatë komunave nga rajoni jugperëndimor (Dibër, Debarcë, Makedonski Brod, Kërçovë, Vevçanë, Strugë dhe Ohër) ekziston listë e këshilltarëve me emër dhe mbiemër, derisa informata më të hollësishme, duke përfshirë emrat, përkatësinë politike, postën elektronike dhe numrin e telefonit ka Komuna e Ohrit, ndërsa Komuna e Strugës në versionin shqip të ueb faqes zyrtare ka listë me numrat e telefonit të këshilltarëve. Kontakte me punonjësit në administratën e komunave që janë të lidhur drejtpërsëdrejti me aktivitetet e buxhetimit (Njësia për buxhet, financa) në komunat e këtij rajoni ka në Ohër, Vevçanë, Kërçovë dhe Debarcë.

Katër komuna deri në fund të monitorimit kanë vendosur praktikë t'i publikojnë agjendat ditore të seancave të Këshillit në ueb faqet e tyre (ose pjesërisht), ndërsa diskutimet nga mbledhjet e Këshillit (shpeshherë vetëm vendimet) janë të disponueshme në komunat e Dibrës, Strugës dhe Ohrit.

Sipas monitoruesve në këtë rajon, Komuna e Vevçanit në Statutin e saj kërkon që agjendat ditore dhe materialet të bëhen publike, ndërsa tre komuna në statutet e tyre kanë pjesë që më afër e definojnë transparencën dhe/ose llogaridhënien e qeveritarëve të qytetit lidhur me procesin buxhetor, edhe atë Dibra, Ohri dhe Vevçani.

Pjesëmarrja në seancat e Këshillit të komunave në rajonin jugperëndimor në përgjithësi është e hapur me paralajmërim ose pëlqim, dhe gjatë përpjekjeve për të marrë pjesë në seancat (13 seanca të këshillit) monitoruesit kanë pasur mundësi të jenë prezent së paku një herë pothuajse në të gjitha komunat, pa komente dhe vërejtje të posaçme.

Aktivitete për përfshirjen e qytetarëve në procesin buxhetor

Gjatë monitorimit njëvjeçar, prej nëntë komunave nga rajoni jugperëndimor, monitoruesit kanë konstatuar se në katër komuna Kryeprefekti apo Këshilli organizojnë aktivitete me qëllim që qytetarët të përfshihen në procesin buxhetor, edhe atë përmes forumeve dhe takimeve (në Dibër, Strugë, Ohër dhe Vevçanë).

3.8.5. Komunat në plan rajonin juglindor

Monitoruesit nga organizata EHO, të cilët i kanë ndjekur proceset buxhetore në komunat e plan rajonit juglindor, kanë konstatuar se prej dhjetë komunave gjysma kanë bashkëpunim të mirë (diku të ndryshueshëm), ndërsa bashkëpunim të pjesërishëm ose të pakënaqshëm gjatë procesit kanë me përfaqësuesit e komunave që janë të lidhur drejtpërsëdrejti me procesin buxhetor në Bogdanci, Dojran, Radovish, Vallandovë, Vasilevë dhe Novo Sellë.

Gjatë kërkimit të dokumenteve që kanë të bëjnë me procesin buxhetor, monitoruesit më së shpeshti i kanë marrur ato në afat prej 1 deri në 10 ditë, disa deri në 30 ditë, kurse për kërkesa të caktuara fare nuk janë marrë përgjigje. Dokumente të kërkuara më së shpeshti janë Buxheti, Llogaria përfundimtare dhe raportet tremujore për realizimin e buxhetit të komunës.

Kontakti me këshilltarët dhe punonjësit në komunat

Në 7 nga gjithsej 10 komuna nga rajoni juglindor në ueb faqet e tyre ekziston listë e këshilltarëve me emër dhe mbiemër dhe përkatësinë politike, ndërsa informata të hollësishme për kontakt nuk ka në asnjë komunë. Kontakte me punonjësit në administratën e komunave që janë të lidhur drejtpërsëdrejti me aktivitetet e buxhetimit (Njësia për buxhet, financa) në këtë rajon ka në gjashtë komuna.

Në dy nga komunat është evidentuar se gjatë periudhës së monitorimit i kanë publikuar agjendat ditore të seancave të Këshillit në ueb faqet e tyre, edhe atë në Strumicë dhe Vasilevë, ndërsa diskutimet nga mbledhjet e Këshillit janë të disponueshme në Strumicë, Radovish, Bogdanci dhe Vasilevë vetëm sikur vendime.

Sipas monitoruesve në këtë rajon, komunat në statutet e tyre nuk kanë parashikuar që agjendat ditore dhe materialet të bëhen publike, ndërsa gjashtë komuna në statutet e tyre kanë pjesë që më afër e definojnë transparencën dhe/ose llogaridhënien e qeveritarëve të qytetit lidhur me procesin buxhetor (në Strumicë, Vasilevë, Bogdanci, Bosillovë, Konçe dhe Radovish).

Pjesëmarrja në seancat e Këshillit të komunave në rajonin juglindor në përgjithësi është e hapur me paralajmërim ose pëlqim, përveç në Dojran ku organizatat civile nuk kanë leje për pjesëmarrje. Gjatë përpjekjeve për të marrë pjesë në seancat (9 seanca të këshillit) monitoruesit kanë pasur mundësi të jenë prezent pothuajse në të gjitha komunat, përveç në Dojran dhe Gjevgjeli.

Aktivitete për përfshirjen e qytetarëve në procesin buxhetor

Gjatë monitorimit njëvjeçar, monitoruesit kanë konstatuar se në pesë komuna Kryeprefekti apo Këshilli organizojnë aktivitete me qëllim që qytetarët të përfshihen në procesin buxhetor, edhe atë përmes forumeve, takimeve, diskutimeve publike, shpalljeve, tribunave me bashkësitë lokale (në Strumicë, Radovish, Bogdanci, Vasilevë dhe Gjevgjeli) dhe se në Bogdanci dhe Strumicë janë organizuar diskutime publike për Projekt buxhetin, ndërsa në Komunën e Bogdancit ka qenë i organizuar diskutim publik edhe për raportin vjetor apo Llogarinë përfundimtare (shqyrtimi në seancën e Këshillit nuk konsiderohet si diskutim publik).

3.8.6. Komunat në plan rajonin e Pellagonisë

Monitoruesit nga organizata KLEA, të cilët i kanë ndjekur proceset buxhetore në komunat e plan rajonit të Pellagonisë, kanë konstatuar se në të gjitha nëntë komunat ka bashkëpunim të mirë me përfaqësuesit që janë të përfshirë drejtpërsëdrejti në procesin buxhetor.

Gjatë kërkimit të dokumenteve që kanë të bëjnë me procesin buxhetor, monitoruesit më së shpeshti i kanë marrur ato në afat prej 1 deri në 10 ditë, megjithëse ka pasur raste kur ka zgjatur edhe deri në 30 ditë. Gjatë monitorimit është vërejtur reduktim i nevojave për kërkesë, si rezultat i publikimit më të shpeshtë të dokumenteve në ueb faqet e komunave. Më së shpeshti janë kërkuar Buxheti, Llogaria përfundimtare, raportet tremujore për realizimin e buxhetit të komunës dhe gjendja e borxhit (formulari K2), dhe të njëjtat janë dorzuar përmes postës elektronike.

Kontakti me këshilltarët dhe punonjësit në komunat

Në shumicën e komunave të rajonit të Pellagonisë në ueb faqet e tyre ekziston listë e këshilltarëve me emër dhe mbiemër, ndërsa të dhëna për përkatësinë politike dhe informata kontakt ka në Resnjë, Krivogashtani dhe Mogillë.

Kontakte me punonjësit në administratën e komunave që janë të lidhur drejtpërsëdrejti me aktivitet e buxhetimit (Njësia për buxhet, financa) në komunat e këtij rajoni ka në pesë komuna përmes telefonit dhe postës elektronike. Ende nuk ka kontakte për nëpunësit nga njësitë për buxhet në Manastir, Mogillë dhe Novaci.

Gjatë monitorimit në katër komuna kanë qenë të publikuara agjendat ditore të seancave të Këshillit në ueb faqet e tyre, edhe atë në Resnjë, Manastir, Krivogashtani dhe Demir Hisar, ndërsa diskutimet nga mbledhjet e Këshillit në periudhën e monitorimit janë vërejtur si të disponueshme (tërësisht ose pjesërisht si vendime) në Novaci dhe Demir Hisar. Në komunat e tjera diskutimet, por edhe vendimet, nuk publikohen.

Sipas monitoruesve në këtë rajon, të gjitha komunat në statutet e tyre kërkojnë që agjendat ditore dhe materialet të bëhen publike, ndërsa gjashtë komuna në statutet e tyre kanë pjesë që më afër e definojnë transparencën dhe/ose llogaridhënien e qeveritarëve të qytetit lidhur me procesin buxhetor, edhe atë në Manastir, Prilep, Krushevë, Dollneni, Demir Hisar dhe Mogillë, ndërsa në tre komuna pjesërisht.

Pjesëmarrja në seancat e Këshillit të komunave në rajonin e Pellagonisë në përgjithësi është e hapur edhe atë më së shpeshti me paralajmërim. Gjatë përpjekjeve për të marrë pjesë në seancat e Këshillit (30 seanca) monitoruesit kanë pasur mundësi të jenë prezent në të gjitha komunat, megjithëse në Komunën e

Mogillës ka pasur më shpesh telefonata që të mësohet data e seancës dhe më gjatë kanë pritur pëlqimin për pjesëmarrje.

Aktivitete për përfshirjen e qytetarëve në procesin buxhetor

Gjatë monitorimit njëvjeçar, prej nëntë komunave në rajonin e Pellagonisë, monitoruesit kanë konstatuar se në pesë komuna Kryeprefekti apo Këshilli organizojnë aktivitete me qëllim që qytetarët të përfshihen në procesin buxhetor, edhe atë përmes forumeve, takimeve me qytetarët dhe ditëve të hapura. Sikur edhe në shumicën e komunave të tjera, diskutim publik për Projekt buxhetin dhe diskutim publik për raportin vjetor apo Llogarinë përfundimtare nuk ka pasur (shqyrtimi në seancën e Këshillit nuk konsiderohet si diskutim publik).

3.8.7. Komunat në plan rajonin e Pollogut

Organizatat monitoruese (në partneritet) të cilat kanë kryer ndjekjen e procesit buxhetor në komunat e rajonit të Pollogut, Aleanca rinore dhe Qendra për edukim dhe zhvillim, kanë konstatuar se në të gjitha nëntë komunat kanë bashkëpunim të mirë me përfaqësuesit të cilët janë të përfshirë drejtpërsëdrejti në procesin buxhetor.

Gjatë kërkimit të dokumenteve që kanë të bëjnë me procesin buxhetor, monitoruesit më së shpeshti i kanë marrur ato në afat prej 1 deri në 5 ditë, megjithëse ka pasur edhe deri në 30 ditë, por ka pasur edhe kërkesa për të cilat nuk është marrë përgjigje edhe atë pas shumë përpjekjeve (në Tearcë dhe Mavrovë dhe Rostushë për kërkesa për Buxhetin, raportet tremujore dhe raportet vjetore). Më së shpeshti janë kërkuar Buxheti, Llogaria përfundimtare, raportet tremujore për realizimin e buxhetit të komunës dhe të njëjtat janë dorëzuar përmes postës elektronike.

Kontakti me këshilltarët dhe punonjësit në komunat

Në 4 nga gjithsej 9 komuna në rajonin e Pollogut në ueb faqet e tyre ekziston listë e këshilltarëve me emër dhe mbiemër, ndërsa të dhëna për përkatësinë politike dhe informata për kontakt ka vetëm në Tetovë dhe Jegunovcë. Në komunat e tjera nuk ka informata të hollësishme për kontakt. Kontakte me punonjësit në administratën e komunave që janë të lidhur drejtpërsërdrejti me aktivitetet e buxhetimit (Njësia për buxhet, financa) ka në pesë komuna nga komunat e këtij rajoni, me telefon dhe/ose postë elektronike, edhe atë në Bërvenicë, Vrapçishtë, Gostivar, Tetovë dhe Jegunovcë.

Gjatë monitorimit në dy komuna kanë qenë të publikuara agjendat ditore të seancave të Këshillit në ueb faqet e tyre, edhe atë në Tetovë dhe Gostivar. Diskutimet nga mbledhjet e Këshillit në periudhën e monitorimit janë të disponueshme vetëm Gostivar, ndërsa pjesërisht me vendime janë të

disponueshme vetëm në Tetovë dhe Mavrovë dhe Rostushë. Në komunat e tjera as diskutimet e as vendimet nuk publikohen.

Sipas monitoruesve në këtë rajon, dy komuna në statutet e tyre kërkojnë që agjendat ditore dhe materialet të bëhen publike (Gostivar dhe Tearcë), ndërsa gjashtë komuna në statutet e tyre kanë pjesë që më afër e definojnë transparencën dhe/ose llogaridhënien e qeveritarëve të qytetit lidhur me procesin buxhetor, edhe atë në Gostivar, Tetovë, Zhelinë, Mavrovë dhe Rostushë, Bogovinë dhe Tearcë.

Pjesëmarrje në seancat e Këshillit të komunave në rajonin e Pollogut në përgjithësi është e hapur edhe pa paralajmërim (monitoruesit kanë qenë prezent në 7 seanca të Këshillit) në pesë komuna. Janë parashtruar 11 kërkesa zyrtare për qasje në informatat me karakter publik dhe për 2 nuk është marrë përgjigje.

Aktivitete për përfshirjen e qytetarëve në procesin buxhetor

Gjatë monitorimit njëvjeçar të nëntë komunave në rajonin e Pollogut, monitoruesit kanë konstatuar se në dy komuna Kryeprefekti apo Këshilli organizojnë aktivitete me qëllim që qytetarët të përfshihen në procesin buxhetor, edhe atë përmes forumeve në Gostivar Vrapçishtë. Sikur edhe në shumicën e komunave të tjera, diskutim publik për Projekt buxhetin dhe diskutim për raportin vjetor apo Llogarinë përfundimtare nuk ka pasur (shqyrtimi në seancën e Këshillit nuk konsiderohet si diskutim publik).

3.8.8. Komunat në plan rajonin verilindor

Monitoruesit nga organizata DROM, të cilët i kanë ndjekur proceset buxhetore në komunat e plan rajonit verilindor, kanë konstatuar se në të gjitha gjashtë komunat ka bashkëpunim të mirë me përfaqësuesit që janë të përfshirë drejtpërsëdrejti në procesin buxhetor.

Dokumentet që kanë të bëjnë me procesin buxhetor, monitoruesit më së shpeshti i kanë marrur në afat prej 1 deri në 5 ditë, kurse gjatë monitorimit është vërejtur reduktim i nevojave për kërkesë, si rezultat i publikimit më të shpeshtë të dokumenteve në ueb faqet e komunave. Më së shpeshti janë kërkuar Buxheti, Llogaria përfundimtare dhe raportet tremujore për realizimin e buxhetit të komunës.

Kontakti me këshilltarët dhe punonjësit në komunat

Në 4 nga gjithsej 6 komuna në rajonin verilindor në ueb faqet e tyre ekziston listë e këshilltarëve me emër dhe mbiemër, ndërsa të dhëna për përkatësinë politike dhe informata për kontakt me adresën elektronike dhe numrin e telefonit ka vetëm në Kratovë.

Kontakte me punonjësit në administratën e komunave që janë të lidhur drejtpërsërdrejti me aktivitetet e buxhetimit (Njësia për buxhet, financa) ka në katër komuna nga komunat e këtij rajoni, me postë elektronike, edhe atë në Kumanovë, Staro Nagoriçane, Rankovcë dhe Kratovë.

Gjatë monitorimit në dy komuna është evidentuar publikimi i agjendave ditore të seancave të Këshillit në ueb faqet e tyre, edhe atë në Kriva Pallankë dhe Kumanovë. Diskutimet nga mbledhjet e Këshillit në periudhën e monitorimit nuk janë vërejtur si të disponueshme për asnjë komunë, por me kërkesë mund të merren në Kumanovë, derisa për të gjitha seancat e Këshillit të Kriva Pallankës ekziston video shënim, ndërsa Kratova i publikon pjesërisht, gjegjësisht vetëm vendimet.

Sipas monitoruesve në këtë rajon, katër komuna në statutet e tyre kërkojnë që agjendat ditore dhe materialet të bëhen publike, ndërsa tre komuna në statutet e tyre kanë pjesë që më afër e definojnë transparencën dhe/ose llogaridhënien e qeveritarëve të qytetit lidhur me procesin buxhetor, edhe atë në Kriva Pallankë, Kumanovë dhe Likovë.

Pjesëmarrja në seancat e Këshillit të komunave në rajonin verilindor në përgjithësi është e hapur edhe atë me paralajmërim paraprak. Gjatë përpjekjeve për të marrë pjesë në seancat e Këshillit (23 seanca) monitoruesit kanë pasur mundësi të jenë prezent në të gjitha komunat e rajonit.

Aktivitete për përfshirjen e qytetarëve në procesin buxhetor

Gjatë monitorimit njëvjeçar në rajonin verilindor, monitoruesit kanë konstatuar se në dy komuna Kryeprefekti apo Këshilli organizojnë aktivitete me qëllim që qytetarët të përfshihen në procesin buxhetor, edhe atë përmes forumeve, takimeve me qytetarët, edhe atë në Kriva Pallankë dhe Kumanovë. Sikur edhe në shumicën e komunave të tjera, diskutime publike për Projekt buxhetin dhe raportin vjetor apo Llogarinë përfundimtare nuk janë organizuar (shqyrtimi në seancën e Këshillit nuk konsiderohet si diskutim publik).

3.9. Perceptimi i anëtarëve të Këshillit të komunave në NJVL për transparencën buxhetore (Pyetësori 3)

Për të parë perceptimin e anëtarëve të Këshillit të komunave për transparencën e procesit buxhetor janë bërë gjithsej 365 intervista gjatë periudhës së monitorimit, shumica e të cilave janë bërë në plan rajonin lindor dhe në rajonin e Shkupit, të cilët njëkohësisht kanë numër më të madh të komunave, ndërsa numri më i vogël i intervistave janë bërë në plan rajonin jugperëndimor, juglindor dhe atë të Vardarit. Janë zhvilluar intervista me nga minimum 1 këshilltar (përveç në Komunën e Kisella

Vodës, ku nuk është zhvilluar asnjë), mirëpo më shpesh janë intervistuar nga 4 këshilltarë për komunë, por ka pasur komuna ku janë zhvilluar intervista me të gjithë këshilltarët (kryesisht në rajonin lindor). Gjatë kësaj është mbajtur llogari të ketë ekuilibër në mes të këshilltarëve nga shumica qeverisëse dhe të opozitës, por edhe përfaqësues të bashkësive etnike (atje ku është e aplikueshme).

Numri i intervistave të bëra me anëtarë të Këshillit të NJVL (sipas plan rajonit)	# i intervistave	%
Rajoni i Shkupit	**78**	**21%**
Rajoni i Vardarit	**35**	**10%**
Rajoni juglindor	**30**	**8%**
Rajoni lindor	**90**	**25%**
Rajoni verilindor	**24**	**7%**
Rajoni i Pellagonisë	**47**	**13%**
Rajoni i Pollogut	**42**	**12%**
Rajoni jugperëndimor	**19**	**5%**
Gjithsej	**365**	**100%**

Sa anëtarët e Këshillit të komunës i përdorin dokumentet buxhetore dhe nëse i kuptojnë ato

Nga anëtarët e intervistuar të Këshillit të komunave pothuajse gjysma e tyre rrallë përdorin dokumente buxhetore, ndërsa 10% fare nuk përdorin dokumente buxhetore. Vetëm 43% e këshilltarëve shpesh përdorin dokumente buxhetore dhe 40% prej tyre janë deklaruar se i përdorin të gjitha dokumentet dhe raportet buxhetore (buxhetin, projekt buxhetin, llogarinë përfundimtare, raportet tremujore dhe vjetore, etj). Anëtarët e këshillave komunal në rajonin jugperëndimor dhe atë juglindor më së shpeshti i përdorin dokumentet buxhetore, ndërsa më së paku (si përqindje e këshilltarëve në komunat e rajonit të cilit i takon këshilltari i intervistuar) dokumentet buxhetore i përdorin në plan rajonin e Pollogut dhe atë lindor.





Këshilltarët konsiderojnë se i kuptojnë mirë dokumentet buxhetore me të cilat ata punojnë. Përkatësisht, 52% e këshilltarëve besojnë se i kuptojnë mirë dokumentet buxhetore, 45% konsiderojnë se i kuptojnë pjesërisht dhe vetëm 2% kanë deklaruar se nuk i kuptojnë. Duke pasur parasysh se Këshilli i NJVL është ai që i merr vendimet lidhur me buxhetin, propozon ndryshime për linja të ndryshme buxhetore, voton për miratimin e raporteve dhe kështu me radhë, të kuptuarit e këtyre dokumenteve pjesërisht nga pothuajse çdo këshilltari i dytë është një përqindje shumë e lartë, që tregon në faktin se është i nevojshëm edukim dhe informim i të gjithë këshilltarëve me bazat e financave publike, që të përdoren në marrjen e vendimeve të informuara dhe ekonomikisht të shëndosha, të cilat janë në përputhje me politikat e komunës dhe të shtetit, si dhe në ndjekjen e punës dhe arritjen e objektivave të pushtetit ekzekutiv, respektivisht të kryeprefektit.
Shkaqet më të shpeshta për kuptimin e pjesërishëm ose moskuptimin e dokumenteve buxhetore janë mospasja kohë të mjaftueshme për shqyrtimin e tyre (32%), stili profesionist në të cilin janë shkruar (28%) dhe klasifikimet e pakuptueshme (15%). Megjithatë, shikuar në nivel të komunave sipas rajoneve, këshilltarët në plan rajonin verilindor dhe atë të Vardarit konsiderojnë se shkaqe kryesore janë stili profesionist dhe struktura e dokumenteve. Duke marrë parasysh se struktura, stili dhe klasifikimet bashkërisht paraqesin 53% e përgjigjeve të këshilltarëve të cilët i kuptojnë pjesërisht ose nuk i kuptojnë dokumentet buxhetore, vërtetohet nevoja për përgatitjen e këshilltarëve në këtë sferë, sepse ata kanë profile dhe shkollim të ndryshëm.





Institucioni më i rëndësishëm në procesin buxhetor sipas këshilltarëve të komunave

Këshilltarët konsiderojnë se institucion dhe aktorë më me rëndësi në procesin buxhetor janë vetë ata, respektivisht Këshilli i komunës, pastaj Kryetari i komunës dhe Ministria e financave. Në lidhje me renditjen e dokumenteve më të rëndësishme buxhetore, shumica konsideron se Projekt buxheti është në vendin e parë, pastaj Buxheti komunal i sjellur/miratuar dhe Qarkorja buxhetore e

Ministrisë së financave. Më pak rëndësi u jepet raportit të auditimit dhe raporteve tjera periodike. Ky kualifikim i rëndësishëm në renditjen e këtyre dokumenteve buxhetore është tregues për perceptimin e këshilltarëve në lidhje me dhënien e raporteve apo llogaridhënien ndaj qytetarëve përmes raporteve. Për dallim nga sjellja dhe miratimi i buxhetit, realizimi efektiv dhe ndjekja e buxhetit sipas tyre ka rëndësi më të ulët, që është në përputhje me gjetjet se qytetarët nuk kanë përshtypje se komunat rregullisht dhe hollësisht japin raporte për punën e bërë, dhe nga kjo vjen perceptimi për transparencë relativisht të kufizuar tek komunat.





Anëtarët e Këshillit të komunave konsiderojnë se pjesëmarrës më të rëndësishëm që kontribuojnë në transparencën e procesit buxhetor (pothuajse njëjtë me qytetarët) janë (1) qeveritarët e qytetit ku bëjnë pjesë edhe vetë ata, (2) televizionet lokale dhe (3) qytetarët dhe sektori civil. Dallime të veçanta kemi në plan rajonin e Pollogut, ku shumica e këshilltarëve konsiderojnë se sektori civil më së shumti kontribuon në transparencën e procesit buxhetor të NJVL, kurse qeveritarët e qytetit dukshëm më pak. Ndërsa në plan rajonin juglindor 58% konsiderojnë se pjesëmarrës më të rëndësishëm që kontribuojnë në transparencën e procesit buxhetor janë qeveritarët e qytetit, ndërkohë që sektori civil aspak nuk paraqitet si aktorë i rangut të parë.





Pjesa më e madhe apo 85% e këshilltarëve konsiderojnë se ata kanë kohë të mjaftueshme për të diskutuar dhe për të shqyrtuar buxhetin, si dhe prioritetet për vitin e ardhshëm para miratimit të buxhetit. Ndërsa 14% e këshilltarëve të anketuar konsiderojnë se ata nuk kanë kohë të mjaftueshme për shqyrtim efektiv, si dhe për diskutim të buxhetit dhe prioriteteve për planifikim. Ata që ishin përgjigjur negativisht me elaborim të mëtejshëm (60% e këshilltarëve që ishin përgjigjur negativisht) i kanë cekur këto shkaqe: koha e pamjaftueshme, mbasi nga sjellja e Projekt buxhetit deri në miratimin e tij kanë periudhë të shkurtër prej vetëm disa ditësh, kufizimi i diskutimit dhe refuzimi i propozimeve, por rrallë herë paraqiten edhe arsye sikur mosnjohja e çështjes dhe mospasja kohë të mjaftueshme personale.

Madje 76% e këshilltarëve të anketuar janë përgjigjur pozitivisht në pyetjen nëse ata kanë ndikuar në sjelljen e ndryshimeve të caktuara në buxhetin. Nga gjithsej 12 këshilltarë të cilët kanë dhënë koment mbi atë që kanë ndikuar, 8 prej tyre kanë komentuar se propozimet pothuajse gjithmonë refuzohen, kurse 81 këshilltarë (ose 22% e të anketuarve) kanë deklaruar se nuk kanë ndikuar në ndryshimet e buxhetit. Nga to, 32 kanë bërë vërejtje se arsyet kanë të bëjnë me atë se propozimet refuzohen, respektivisht nuk kanë mundësi për të bërë ndonjë ndryshim, ndërsa 6 prej tyre kanë bërë vërejtje se pamundësia për të ndikuar në buxhetin është rezultat i mosnjohjes apo paaftësisë lidhur me këtë temë.

Si të rritet transparenca dhe pjesëmarrja e qytetarëve në procesin buxhetor

Në pyetjen për atë se çfarë, sipas tyre, mund të ndikojë dukshëm në rritjen e transparencës dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin buxhetor, madje 69% e anëtarëve të Këshillit komunal (252 nga 365 të anketuar) janë përgjigjur për:

- ***Pjesëmarrje më të hapur të qytetarëve në seancat e Këshillit*** përmes hapjes më të madhe në seancat e Këshillit me dhënien e të drejtës së diskutimit, përfshirjen e qytetarëve në procesin buxhetor përmes tribunave publike dhe debateve mbi buxhetin, grumbullimin dhe pranimin e propozimeve të qytetarëve;
- ***Intensifikim të komunikimit me qytetarët,*** përmes informimit të rregullt dhe më të hollësishëm të qytetarëve rreth buxhetit, me mbulim më të madh medial të punës së komunës dhe përfshirje të sektorit civil, prezantim më të thjeshtë të buxhetit për qytetarët dhe ngritje të vetëdijes për përfshirjen në procesin buxhetor.

Pothuajse të gjithë këshilltarët kanë deklaruar se komunikojnë me qytetarët, edhe atë 72% rregullisht, kurse 27% ndonjëherë. Njëkohësisht, pjesa më e madhe e këshilltarëve (62%) deklaruan se kanë bashkëpunim të mirë me pushtetin ekzekutiv (kryeprefektin) apo me njësinë për financa lidhur me shkëmbimin e dokumenteve, informatave dhe të dhënave për procesin buxhetor, ku rezultate më

të larta janë arritur na rajonin jugperëndimor, kurse më të ulëta në rajonin e Pellagonisë.





Pothuajse një e treta e këshilltarëve të anketuar nuk janë përgjigjur se për cilat linja buxhetore ose dokumente buxhetore kanë diskutuar në mbledhjen e fundit të Këshillit të komunës. Në pyetjen se në cilën pjesë të procesit buxhetor dhe buxhetit ekzistojnë më shumë kundërshtime tek Këshilli i komunës janë përgjigjur vetëm 52 këshilltarë. Nga to, 24 janë përgjigjur se nuk ka mospajtim, ndërsa përgjigjet më të shpeshta për kundërshtimet në seancat e Këshillit kanë të bëjnë me linjat buxhetore, sikur: (1) Investimet e komunës dhe shpenzimet kapitale (32), (2) Projekt buxheti, miratimi i buxhetit dhe realizimi i buxhetit (45) dhe raporte të tjera, (3) Shërbimet kontraktuese dhe harxhimet e komunës (përfaqësitë, pagat, punësimet, harxhimet për karburante), (4) Ndërmarrjet komunale dhe urbanizmi, (5) Tatimet në komunë, (6) Huamarrja dhe servisimi i borxhit të komunës, (7) Buxheti suplementar dhe të tjera.

3.10. Perceptimi i punonjësve në NJVL për transparencën buxhetore (Pyetësori 4)

Pika kryesore fillestare e transparencës së procesit buxhetor është mundësia e qytetarëve për të pasur qasje në informatat për buxhetin, gjë e cila varet nga disponueshmëria e dokumenteve lidhur me procesin buxhetor. Disponueshmëria e dokumenteve në masë të madhe varet nga qeveria komunale, por edhe nga administrata komunale dhe përkushtimi dhe hapja e tyre ndaj qytetarëve. Për të parë perceptimin në mesin e punonjësve në NJVL lidhur me transparencën e procesit buxhetor janë bërë gjithsej 264 intervista gjatë periudhës së monitorimit, shumica e të cilave janë bërë në rajonin e Shkupit (i cili njëkohësisht ka numër më të madh të komunave), ndërsa numri më i vogël i intervistave janë bërë në plan rajonin jugperëndimor dhe atë juglindor.

Numri i intervistave të bëra me punonjës në NJVL (sipas plan rajonit)	# i intervistave	%
Rajoni i Shkupit	**88**	**33%**
Rajoni i Vardarit	**28**	**11%**
Rajoni juglindor	**17**	**6%**
Rajoni lindor	**36**	**14%**
Rajoni verilindor	**24**	**9%**
Rajoni i Pellagonisë	**29**	**11%**
Rajoni i Pollogut	**26**	**10%**
Rajoni jugperëndimor	**16**	**6%**
Gjithsej	**264**	**100%**

Janë zhvilluar intervista me nga minimum një punonjës, mirëpo më shpesh janë zhvilluar nga 3 intervista për komunë, por ka pasur edhe komuna ku janë zhvilluar intervista me numër më të madh të punonjësve. Gjatë kësaj është mbajtur llogari t'u jepet përparësi punonjësve që janë të kyçur drejtpërsëdrejti në procesin buxhetor.

Sa punonjësit në komunë i përdorin dokumentet buxhetore dhe nëse i kuptojnë ato

Nga punonjësit e intervistuar në komunë, 68% janë përgjigjur se i përdorin shpesh dokumentet buxhetore të komunës, një e katërta (26%) janë përgjigjur se i përdorin rrallë, ndërsa vetëm 6% janë përgjigjur se nuk i përdorin aspak dokumentet buxhetore. Nga ato 40% që kanë treguar se cilat dokumente i përdorin, janë cekur të gjitha dokumentet buxhetore, përkatësisht: Qarkorja buxhetore, raportet tremujore, Projekt buxheti, Buxheti, Llogaria përfundimtare, raporti vjetor, planet financiare, programet e buxhetit, rebalancët, monitorimi i ekzekutimit të buxhetit dhe të tjera.





Pjesa më e madhe (79%) e punonjësve në komunat (si përqindje nga numri i përgjithshëm i punonjësve të anketuar në komunat e rajonit të cilit ai i takon) konsiderojnë se i kuptojnë mirë dokumentet buxhetore me të cilat ata punojnë, 19% se i kuptojnë pjesërisht dhe vetëm 2% se nuk i kuptojnë. Duke pasur parasysh se bëhet fjalë për punonjës të cilët ditë për ditë punojnë me dokumentet dhe raportet buxhetore, është e kuptueshme përqindja e lartë e të kuptuarit. Përqindje më të lartë të kuptueshmërisë së dokumenteve, sipas perceptimit të vetë punonjësve, ka tek punonjësit në komunat e rajonit të Pollogut dhe atij juglindorë (mbi 94%), ndërsa rreth njëzet për qind të punonjësve në komunat e të gjitha rajoneve të tjera kanë deklaruar se i kuptojnë pjesërisht.
Gjithsej tetëdhjetë nga të intervistuarit kanë përmendur shkaqe për moskuptimin e dokumenteve, dhe pjesa më e madhe e tyre si shkaqe kanë cekur: (1) kohën e pamjaftueshme (29%), (2) stilin profesionist në të cilin dokumentet janë shkruar dhe (3) klasifikimet e pakuptueshme.



Përgjigjet për arsyet e mundshme të moskuptimit të dokumenteve buxhetore nuk kanë dallim të dukshëm në mes rajoneve dhe komunave, megjithatë është tregues se rreth 30% (80 nga 264) e punonjësve kanë konstatuar se ekziston një nivel i moskuptimit të dokumenteve (duke i identifikuar arsyet sipas mendimit të tyre), dhe se ka nevojë për "përparimin" e aftësive të tyre dhe t'i kushtohet më shumë kohë të kuptuarit më mirë të dokumenteve buxhetore me cilat çdo ditë punojnë.

Cilat janë dokumentet buxhetore dhe institucionet më me rëndësi për procesin buxhetor sipas punonjësve

Sa i përket renditjes së institucioneve dhe aktorëve në procesin buxhetor, nëpunësit komunal konsiderojnë se më të rëndësishëm janë Këshilli i komunës dhe Kryeprefekti, pastaj Ministria e financave, ndërsa aktorët e tjerë shumë rrallë janë radhitur të parët. Edhe në nivel rajonal rezultatet janë pothuajse të njëjta, ku ose Këshilli ose Kryeprefekti është renditur ose i pari ose i dyti.

Në lidhje me renditjen e dokumenteve buxhetore, dokumente më të rëndësishme janë: Buxheti komunal i sjellur, Projekt buxheti dhe Qarkorja buxhetore e Ministrisë së financave. Në nivel rajonal gjithkund Buxheti ka rëndësi më të madhe, përveç në rajonin jugperëndimor, ku Qarkorja buxhetore konsiderohet të ketë rëndësi të madhe, pastaj Projekt buxheti dhe Buxheti i votuar. Në të gjitha rajonet rëndësi më të vogël u jepet raporteve të tjera, sikur raportit të auditimit, raportit vjetor dhe raporteve periodike.





Punonjësit në komunat konsiderojnë se pjesëmarrës më të rëndësishëm që kontribuojnë në transparencën e procesit buxhetor janë ueb portalet, pastaj qeveritarët e qytetit, sektori civil dhe televizionet lokale dhe qytetarët. Dallime të veçanta kemi në plan rajonin e Pollogut dhe rajonin juglindor, ku shumica e të punësuarve konsiderojnë se qeveritarët e qytetit më së paku kontribuojnë për transparencën e procesit buxhetor të NJVL, kurse ueb portalet kontribuojnë dukshëm. Ndërsa, në rajonin e Shkupit, punonjësit në komunat konsiderojnë se ndikimi i sektorit civil ka pjesëmarrje më të madhe në transparencën.





Pjesa më e madhe apo 83% e punonjësve konsiderojnë se ata kanë kohë të mjaftueshme për të diskutuar dhe për të shqyrtuar Projekt buxhetin, si dhe prioritetet për vitin e ardhshëm para miratimit të buxhetit.
Ndërsa, 12% e punonjësve të anketuar konsiderojnë se ata nuk kanë kohë të mjaftueshme për shqyrtim efektiv, si dhe për diskutim për Projekt buxhetin dhe prioriteteve për planifikim të buxhetit. Nga ata që janë përgjigjur negativisht, mirëpo kanë dhënë elaborim të mëtejshëm për arsyet, janë cekur këto arsye: vonesa e tabelave nga qeveria qendrore, materiali tepër i shumtë dhe kohë e pamjaftueshme, si dhe mungesa e burimeve njerëzore.

Si të rritet transparenca dhe pjesëmarrja e qytetarëve në procesin buxhetor

Në pyetjen për atë se çfarë, sipas tyre, mund të ndikojë dukshëm në rritjen e transparencës dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin buxhetor, pjesa më e madhe e nëpunësve komunal, madje 77% (202 nga 264 të anketuar) janë përgjigjur se është e nevojshme:

- ***Hapje të seancave të Këshillit dhe mbajtje të debateve publike dhe konsultime*** *me qytetarët ose mbledhje me qytetarët në bashkësitë lokale, tribuna publike, mbledhje, forume, sondazhe dhe propozime nga qytetarët;*
- ***Informim të qytetarëve për punën e komunës dhe kompetencat e komunës*** *(ueb faqja e komunës, publikime të rregullta të dokumenteve, informata nga mediat, lajmërues zyrtarë, thjeshtësim të buxhetit);*
- ***Hapje të Projekt buxhetit*** për propozime nga qytetarët;
- ***Rritje të interesimit, motivim dhe iniciativë*** *që qytetarët të marrin pjesë në procesin dhe punën e komunës.*

Pothuajse gjysma (47%) e punonjësve kanë deklaruar se komunikojnë me qytetarët, edhe atë 72% rregullisht (nëpërmjet punës së përditshme, komunikimit përmes postës elektronike, transmetimit të propozimeve, pritjes së qytetarëve, kontakteve personale, përmes shërbimit për marrëdhënie me publikun, takimeve në bashkësitë lokale, mbledhjeve, forumeve, qendrës për informim, sondazheve, rrjeteve sociale, etj), ndërsa 22% ndonjëherë, kurse 5% kanë deklaruar se nuk komunikojnë me qytetarët.

Në pyetjen nëse kanë pranuar kërkesë nga ana e qytetarëve ose organizatave qytetare për dërgimin e informatave lidhur me buxhetin, pjesa më e madhe e punonjësve në komunë janë përgjigjur se ndonjëherë kanë pranuar, ndërsa një e katërta janë përgjigjur se shpesh pranojnë kërkesa në lidhje me buxhetin. Në nivel rajonal, sipas përgjigjeve të marra nga punonjësit në komunën të cilës i takon i anketuari, mund të shihet se kërkesa për informata lidhur me buxhetin rregullisht pranojnë në rajonin verilindor, ndërsa në rajonin jugperëndimor ka më së paku kërkesa për nëpunësit komunal për informata në lidhje me buxhetin.





Çrregullime dhe prolongime në procesin buxhetor dhe arsyet më të shpeshta

Sipas përgjigjeve të dhëna nga punonjësit në komunat dhe sipas informatave të tyre në vitet e fundit, në njëmbëdhjetë komuna ka qenë i çrregulluar procesi buxhetor, gjegjësisht nuk janë respektuar afatet ligjore, kryesisht për sjelljen e Buxhetit për vitin e ardhshëm (deri më 31 dhjetor vitin rrjedhës për vitin e ardhshëm), ku arsyet që janë përmendur kanë të bëjnë me: Këshilli nuk është pajtuar mbi buxhetin me çka është pranuar financim i përkohshëm, Këshilli nuk e ka sjellur Buxhetin dhe pas skadimit të mandatit të këshilltarëve është sjellur i njëjti buxhet, Qarkorja buxhetore nuk është dorëzuar në kohë, shfrytëzues buxhetor individual nuk janë përgjigjur në kohë, ose me kërkesë të këshilltarëve për shkak të vonesës së materialeve.
Arsyet më të shpeshta për ndryshimin ose prolongimin e procesit buxhetor janë ndryshimi e linjave të caktuara, vazhdimi i afateve, kërkesat për ndryshime në buxhet etj. Sipas 87 punonjësve të cilët kanë përmendur arsye, më së shpeshti paraqiten: (1) shpenzime të planifikuara joadekuate, për çka paraqitet nevojë për rishpërndarje, (2) të ardhura ose mjete të pamjaftueshme për linja të caktuara, (3) projekte të reja, donacione të miratuara, programe qeveritare që kërkojnë ndryshime dhe (4) ndryshime të rregullativës ligjore.

Pse qytetarët janë ose nuk janë të interesuar për procesin buxhetor

Sipas 91 punonjës komunal të intervistuar, qytetarët në komunën e tyre janë të interesuar për procesin buxhetor, edhe atë për shkak të: (1) vetëdijes së qytetarëve se harxhohen paratë e tyre, (2) kanë interes personal nga aktivitetet e komunës (komunale dhe infrastrukturore), (3) ekziston interesim për atë se cilat projekte dhe shërbime realizohen nga komuna, (4) komuna i informon dhe është transparente. Nga ana tjetër, 80 punonjës të intervistuar konsiderojnë se qytetarët nuk janë të interesuar për procesin buxhetor në komunën e tyre, dhe shkaqet kryesore të cilat më së shpeshti i kanë cekur janë: (1) mungesa e informimit dhe vetëdijes tek qytetarët se mund të marrin pjesë dhe të ndikojnë në punën e

komunës, (2) mosbesimi në institucionet dhe mundësia të ndryshojnë diçka, si dhe apati ndaj politikës dhe veprimtarisë civile, (3) mosdija dhe mosnjohja e procesit buxhetor, etj. Edhe në rastin e parë edhe në të dytin përgjigjet tregojnë se interesimi i qytetarëve në punën e komunës varet nga informueshmëria dhe niveli i disponueshmërisë së informatave në mesin e qytetarëve, gjë që nga ana tjetër është në pajtim me përgjigjet e tjera se është i nevojshëm angazhim më i madh nga ana e komunave për t'i informuar dhe përfshirë qytetarët në procesin buxhetor, por më së pari të angazhohen që informatat të jenë të disponueshme dhe t'i informojnë qytetarët për të drejtat dhe mundësitë e tyre dhe mënyrat se si të marrin pjesë në procesin buxhetor.

Niveli i bashkëpunimit me Ministrinë e financave

Pjesa më e madhe e punonjësve (235 nga gjithsej 251 që janë përgjigjur në pyetjen) konsiderojnë se kanë bashkëpunim të mirë me Ministrinë e financave, 12 besojnë se bashkëpunimi mund të përmirësohet dhe vetëm 4 konsiderojnë se nuk ka bashkëpunim të mirë.

3.11. Perceptimi i qytetarëve, mediave lokale dhe organizatave civile për transparencën buxhetore në komunat e tyre (Pyetësori 5)

Për të parë perceptimin e qytetarëve dhe përfaqësuesve të mediave dhe të sektorit civil lidhur me transparencën e procesit buxhetor në NJVL, janë bërë gjithsej 305 intervista gjatë periudhës së monitorimit, shumica e të cilave janë bërë në rajonin e Shkupit, i cili ka numër më të madh të komunave, ndërsa numri më i vogël i intervistave janë bërë në plan rajonin jugperëndimor dhe atë juglindor.

Numri i intervistave të bëra me qytetarët, organizatat civile dhe mediat (sipas plan rajonit)	# i intervistave	%
Rajoni i Shkupit	**81**	**27%**
Rajoni i Vardarit	**39**	**13%**
Rajoni juglindor	**20**	**7%**
Rajoni lindor	**54**	**18%**
Rajoni verilindor	**34**	**11%**
Rajoni i Pellagonisë	**29**	**10%**
Rajoni i Pollogut	**28**	**9%**
Rajoni jugperëndimor	**20**	**7%**
Gjithsej	**305**	**100%**

Sa qytetarët, mediat dhe organizatat civile përdorin dokumente lidhur me procesin buxhetor në komunat e tyre dhe cilat

Nga përgjigjet e qytetarëve dhe përfaqësuesve të mediave dhe të organizatave civile mund të konstatohet se një pjesë e vogël i përdorin dokumentet buxhetore. Pikërisht, 13% kanë deklaruar se i përdorin shpesh dokumentet buxhetore, 43% i përdorin rrallë dokumentet buxhetore, ndërsa pjesa e mbetur prej 44% nuk përdorin aspak ndonjë dokument buxhetor.





Sipas përgjigjeve të qytetarëve/organizatave civile/mediave të cilët shpesh përdorin dokumente buxhetore, më së shumti i shfrytëzojnë/shqyrtojnë (1) Buxhetin e NJVL ku ata jetojnë/punojnë dhe (2) Llogarinë përfundimtare të NJVL, kurse më rrallë i kanë përmendur Projekt buxhetin dhe raportet tremujore. Ndërsa ata të cilët kanë deklaruar se rrallë i përdorin dokumentet buxhetore, pjesa më e madhe nuk kanë cekur se cilat dokumente buxhetore i shfrytëzojnë apo shqyrtojnë. Pjesa më e vogël e atyre që kanë deklaruar se i përdorin rrallë dokumentet buxhetore, më së shpeshti i kanë cekur (1) Buxhetin e sjellur, (2) linja të caktuara të buxhetit që kanë të bëjnë me organizatat civile, apo dokumente konkrete për ndonjë furnizim të caktuar të NJVL.

Sa qytetarët i kuptojnë dokumentet lidhur me procesin buxhetor

Shikuar në nivel të Maqedonisë, mund të përfundohet se më shumë se një e katërta (27%) e qytetarëve të anketuar konsiderojnë se plotësisht i kuptojnë dokumentet buxhetore dhe financiare të komunës, më shumë se gjysma (52%) i kuptojnë pjesërisht, ndërsa rreth një e pesta fare nuk i kuptojnë dokumentet buxhetore të cilat i përgatit/publikon komuna.
Në bazë të përgjigjeve të qytetarëve sipas rajonit, niveli i atyre që plotësisht i kuptojnë dokumentet buxhetore dhe financiare është më e lartë në rajonin e Pellagonisë dhe atij juglindor, ndërsa më i ulët është në rajonin verilindor. Nga ata qytetarë të cilët kanë deklaruar se nuk i kuptojnë dokumentet buxhetore,

përqindja më e lartë paraqitet në rajonin e Pollogut, kurse më e ulët në rajonin e Pellagonisë.





Gjithsesi, gjetje me rëndësi janë edhe arsyet se pse qytetarët konsiderojnë se dokumentet buxhetore dhe financiare të komunave janë pjesërisht të kuptueshme apo nuk janë të kuptueshme. Arsyet e përmendura më së shumti se pse dokumentet buxhetore nuk kuptohen ose pjesërisht kuptohen janë: (1) koha, respektivisht interesimi i pamjaftueshëm për to nga ana e qytetarëve, (2) stili profesionist i dokumenteve, si dhe (3) klasifikimet e pakuptueshme. Koha e pamjaftueshme si shkak paraqitet me përqindje më të lartë në përgjigjet e dhëna (krahasuar me përgjigjet e tjera në atë rajon) në rajonin e Pellagonisë dhe atë lindor, ndërsa në rajonin e Pollogut dhe të Shkupit si shkaqe për kuptimin e pjesërishëm apo moskuptimin e dokumenteve buxhetore më së shumti janë përmendur klasifikimet e pakuptueshme në dokumentet dhe stili profesionist në të cilin janë shkruar. Ajo se 71% nga përgjigjet e dhëna referojnë se dokumentet buxhetore janë pjesërisht të kuptueshme apo nuk janë fare të kuptueshme për shkak të prezantimit dhe formës së pakuptueshme të dokumenteve buxhetore (struktura, klasifikimi, stili profesionist) tregon se ka nevojë për informim dhe edukim më të madh të qytetarëve dhe përfaqësuesve të organizatave civile dhe mediave për dokumentet lidhur me procesin buxhetor, kurse nga ana tjetër për prezantim më adekuat dhe më të thjeshtë të dokumenteve buxhetore qytetarëve dhe opinionit pa ekspertizë (shih Buxheti qytetarë).





A janë të njoftuar qytetarët me të drejtat e tyre të kërkojnë llogaridhënie nga NJVL

Pjesa më e madhe e qytetarëve kanë deklaruar se i njohin të drejtat e tyre për atë se si të marrin informata nga komunat dhe si të marrin pjesë në procesin buxhetor. Më shumë se 81% e qytetarëve janë deklaruar se i dinë ose pjesërisht i dinë të drejtat e tyre për pjesëmarrjen në punën e komunës, si dhe në procesin buxhetor. Shikuar sipas rajoneve (si përqindje e të anketuarve në rajonin përkatës), dallime të dukshme kemi në rajonin verilindor, ku shumica e qytetarëve kanë deklaruar se pjesërisht i njohin apo nuk i njohin të drejtat e tyre, ndërsa në rajonin jugperëndimor një përqindje e konsiderueshme e qytetarëve kanë deklaruar se i dinë të drejtat e tyre për të kërkuar të dhëna dhe për të marrë pjesë në pushtetin lokal.





Nga gjithsej 305 përgjigje, 38% e qytetarëve konsiderojnë se janë të informuar/njoftuar për të drejtat e tyre si qytetarë të kërkojnë informata dhe të dhëna nga pushteti lokal ku ata jetojnë, ndërsa 59% nuk janë të informuar për të drejtat dhe mënyrën/procedurën për të kërkuar të dhëna dhe llogaridhënie nga qeveritarët lokal. Në bazë të përgjigjeve (krahasuar me përgjigjet në rajonet e tjerë) qytetarët në rajonin e Shkupit dhe atë verilindor konsiderojnë se më së paku janë të njoftuar për të drejtën për llogaridhënie nga pushteti lokal, ndërsa më të

informuar për të drejtat e tyre për të marrë informata dhe për llogaridhënie nga NJVL janë qytetarët e komunave në rajonin e Pellagonisë, jugperëndimor dhe atë lindor. Ata që kanë vërejtur se i dinë të drejtat e tyre për t'u informuar kanë cekur vetëm Ligjin për qasje në informatat me karakter publik, ndërsa format e tjera të pjesëmarrjes në procesin buxhetor dhe qeverisjen lokale pothuajse edhe nuk përmenden si të drejta sipas Statutit, Ligjit për vetëqeverisje lokale, etj. Nga ata të cilët kanë cekur se janë të informuar për të drejtat e tyre për të kërkuar informata, më së shumti hasen vërejtje se ata janë të njoftuar për të drejtat në bazë të Ligjit për qasje në informatat me karakter publik, por edhe se marrin informata për të drejtat e tyre në lidhje me marrjen e të dhënave dhe informatave nga organizatat e sektorit civil (përmes takimeve informuese, trajnimeve, evenimenteve), si dhe nga vetë pushteti lokal dhe aktiviteteve të tija.





Cilat janë dokumentet dhe institucionet më me rëndësi për procesin buxhetor për qytetarët

Sipas qytetarëve dokumente më të rëndësishme në procesin buxhetor janë: (1) Buxheti i sjellur/miratuar (33%) dhe (2) Projekt buxheti (31%). Ndërsa dokumentet e tjera që janë renditur si më të rëndësishme, mirëpo në përqindje më të vogël, janë Qarkorja buxhetore, raporti vjetor, raportet periodike dhe raporti i auditimit. Nga ana tjetër, qytetarët konsiderojnë se institucione më të rëndësishme për procesin buxhetor në nivel të NJVL janë: (1) Këshilli i komunës, (2) Kryeprefekti dhe (3) Ministria e financave, ndërsa aktorët e tjerë, sipas qytetarëve kanë dukshëm më pak rëndësi për procesin buxhetor. Krahasuar me shkallën e disponueshmërisë së dokumenteve të lartpërmendura mund të konkludohet se edhe pse pjesa më e madhe e qytetarëve konsiderojnë se dokumenti i dytë sipas rëndësisë është Projekt buxheti, megjithatë ai rrallë herë është i disponueshëm për qytetarët në shqyrtim, edhe pse përfaqësuesit e NJVL shpesh deklarojnë se Projekt buxheti është i njëjtë me Buxhetin e sjellur.





Kush kontribuon më së shumti për transparencën e procesit buxhetor

Sipas qytetarëve faktorët më të rëndësishëm që kontribuojnë në transparencën e procesit buxhetor janë qeveritarët komunal (26%), televizionet lokale (18%), ueb portalet (14%), sektori civil (12%), qytetarët (13%) dhe të tjerë (nën 9%). Nga katër pjesëmarrësit e përmendur më së shumti, veçanërisht theksohet rëndësia e qeveritarëve komunal në rajonin e Shkupit dhe atë verilindor, rëndësia e sektorit civil është theksuar në rajonin e Shkupit, ndërsa për qytetarët e komunave të rajonit verilindor sektori civil ka dukshëm më pak rëndësi në kontributin për transparencën e procesit buxhetor. Veçanërisht theksohet opinioni në rajonin verilindor për rëndësinë e ueb portaleve si medium për informim. Ajo që qeveritarët e qytetit dhe mediat dallohen si pjesëmarrës më të rëndësishëm që kontribuojnë në transparencën e procesit buxhetor, tregon se qytetarët nismën për transparencë më të madhe e shohin tek vetë qeveritarët, respektivisht zbatuesit e buxhetit, ndërsa raportin me qeveritarët komunal kryesisht e shohim përmes mediave lokale.





A i thjeshtëson komuna informatat për buxhetin

Shumica e qytetarëve konsiderojnë se komunat shumë rrallë ndërmarrin aktivitete për t'i thjeshtësuar informatat për buxhetin dhe shpenzimin e parave publike.

Dallime më të mëdha paraqiten tek qytetarëve në rajonin jugperëndimor, ku 55% (nga gjithsej 20 intervista) konsiderojnë se komuna vazhdimisht ndërmerr veprime, ndërsa vetëm 5% (nga 81 të intervistuar) në rajonin e Shkupit dhe vetëm 7% (nga gjithsej 28 intervista) në rajonin e Pollogut konsiderojnë se komunat ndërmarrin aktivitete për thjeshtësimin e informatave lidhur me shpenzimet publike dhe buxhetin. Tek ata të cilët i kanë cekur format e veprimit (në ato komuna ku qytetarët janë përgjigjur se komunat vazhdimisht ndërmarrin aktivitete) veçanërisht theksohen Forumet e bashkësisë (përgjigjet në Strumicë, Ilinden, Novaci, Dellçevë dhe Gostivar), si dhe diskutime dhe debate publike mbi buxhetin (më shpesh të përmendura në Ohër, Aerodrom dhe Llozovë). Arsyet kryesore që janë cekur nga ana e qytetarëve të cilët konsiderojnë se NJVL nuk ndërmerr aktivitete, kryesisht shkojnë në dy drejtime:

(1) se në masë të madhe ***NJVL nuk dëshiron t'i shpalosë informatat*** lidhur me buxhetin për shkak të "mospasjes së interesimit, qëllimeve të fshehura, mosmarrjen parasysh të nevojave të qytetarëve apo moskuptimit se kanë obligim kundrejt qytetarëve për t'u dhënë shpjegim", gjë që tregon në mungesë të besimit në NJVL lidhur me harxhimin e mjeteve buxhetore; dhe kahja diametralisht e kundërt

(2) se ***qytetarët nuk janë të interesuar ose janë të painformuar*** për procesin buxhetor dhe financat publike që janë të panjohura për "qytetarët e zakonshëm" (29 nga 83 të anketuar janë përgjigjur me JO dhënë kanë dhënë mendim për arsyet apo 35%).

Nëse merren parasysh këto perceptime së bashku me faktin se asnjë komunë nuk ka përgatit Buxhet për qytetarët, mund të përfundohet se është i nevojshëm angazhim më i madh i NJVL që t'ua prezantojnë qytetarëve të dhënat për buxhetin në mënyrë të thjeshtë dhe të kuptueshme dhe të promovohen mes qytetarëve me intensitet më të madh, ndërsa format e buxhetimit participativ dhe pjesëmarrja aktive nëpërmjet konsultimeve me qytetarët (në format e përmendura) pritet të ketë një efekt pozitiv drejt ndërtimit të "besimit" si dhe demistifikim të buxhetit dhe procesit buxhetor. Përveç kësaj, asnjë komunë në periudhën e kaluar nuk ka përgatitur dokumentin e ashtuquajtur Buxheti qytetar, në të cilin në mënyrë të thjeshtë dhe të kuptueshme shpjegohen objektivat e buxhetit dhe të gjitha materialet përkatëse në një vend, nga i cili opinioni mund të informohet për harxhimin e mjeteve publike, prioritetet dhe efektet mbi jetesën e tyre dhe ku mund të marrë më shumë informata[15].

[15] http://www.oecd.org/gov/budgeting/48170438.pdf





Si të rritet transparenca për procesin buxhetor dhe pjesëmarrja e qytetarëve

Në të gjitha pyetjet që kanë të bëjnë me mënyrat dhe format se çfarë do të kontribuonte dhe si NJVL duhet vepruar për rritjen e transparencës së procesit buxhetor, pothuajse gjithmonë hasen përgjigje në të njëjtin drejtim për rritjen e transparencës së komunave lidhur me procesin buxhetor, edhe atë:

- ***Përfshirje të drejtpërdrejtë të qytetarëve në procesin buxhetor*** dhe shpërndarje të buxhetit përmes pjesëmarrjes së tyre në organe, debate dhe diskutime, përgatitje të sondazheve për prioritizimin e nevojave për harxhimin e mjeteve, elaborim të vendimeve para qytetarëve;
- ***Informim të rregullt, të plotë dhe me kohë për planet, politikat dhe harxhimin e mjeteve publike, në periudhën që i paraprinë miratimit të Buxhetit dhe Projekt buxhetit*** dhe duke publikuar informata të hollësishme në nivel mujor/tremujor/vjetor, përmes kontakteve të drejtpërdrejta me qytetarët dhe përmes mediave (nëpërmjet ueb faqeve);
- ***Informim të qytetarëve dhe aktorëve tjerë në bashkësinë lokale me një përfshirje më të madhe, për të drejtat e tyre dhe mënyrat e përfshirjes së tyre*** në procesin buxhetor dhe marrjen e vendimeve;
- ***Proaktivitet më të madh dhe hapje e pushtetit lokal*** ndaj qytetarëve nëpërmjet komunikimit intensiv dhe efikas të informatave në lidhje me procesin buxhetor.

Hapi i parë i transparencës dhe llogaridhënies lidhur me buxhetit është disponueshmëria e informatave relevante dhe me kohë. Sidomos duke pasur parasysh se pjesa më e madhe e qytetarëve, pa ndonjë dallim të madh, konsiderojnë se ndryshimet në buxhet nuk sjellen apo shumë rrallë sjellen në mënyrë transparente dhe pa ndonjë informim adekuat të qytetarëve.





Përveç kësaj, në pyetjen nëse ekzistojnë arsye përse komunat nuk hapin diskutim për Buxhetin në të gjitha fazat e tija, 45% e qytetarëve kanë deklaruar se nuk ka ndonjë arsye, ndërsa madje 39% janë përgjigjur se ekzistojnë arsye dhe pjesa më e madhe e tyre i kanë cekur arsyet, të cilat janë: korrupsioni i mundshëm, fshehja e shpenzimeve dhe të punuarit në mënyrë jotransparente dhe jo të duhur, si dhe joazhuriteti dhe joaktiviteti i komunës për nevojën për të informuar qytetarët.



Analizë empirike e transparencës fiskale të komunave në Maqedoni

Kemi dashur të testojmë nëse madhësia e komunës ndikon në transparencën fiskale. Madhësinë e kemi definuar sikur numri i popullsisë apo sipërfaqja në km^2 ose tatimi i grumbulluar nga burimet vetanake për banorë. Përderisa dy variablat e para janë të definuara si masë për madhësinë vetvetiu, besojmë se është i nevojshëm shpjegim plotësues për tatimin e grumbulluar nga burimet vetanake. Tatimi i grumbulluar nga burimet vetanake e ilustron madhësinë fiskale të komunës (nëse bëhet supozim iluzorë se të gjitha komunat kanë përpjekje të njëjtë fiskale, megjithëse edhe në atë rast dallimet nuk duhet të jenë të mëdha), thënë me fjalë tjera sa është e pasur komuna.

Marrim vlerën e tatimit të grumbulluar nga burimet vetanake për banorë, por jo të ardhurat totale të komunës, sepse duam që të marrim parasysh kapacitetin e komunës për t'i administruar tatimet e veta, si dhe përpjekjen tatimore të komunës, dhe jo transfertat nga pushteti qendrorë për financimin e shërbimeve komunale. Gjithashtu, nuk i marrim parasysh donacionet dhe vetëfinancimin, sepse ato nuk i parafytyrojnë vendimet e komunës për harxhimin e mjeteve, por ato janë vendime të donatorëve apo kontributi i qytetarëve i dedikuar për shërbimet komunale.

Në llogaritjen tonë, variabla e varur është treguesi për transparencën fiskale që matet përmes disponueshmërisë publike të dokumenteve, siç kemi shpjeguar në fillim të këtij studimi. Kështu, i japim numrin 1 ndryshores fiktive nëse komuna e publikon Llogarinë përfundimtare në faqen e internetit (drejtpërdrejt ose si pjesë e lajmëruesit zyrtare). Varijabla fiktive merr numrin 0 nëse komuna nuk e publikon Llogarinë përfundimtare. Merret parasysh vetëm Llogaria përfundimtare, pasi që është dokumenti më i rëndësishëm për të promovuar transparencën dhe llogaridhënien për atë se si janë harxhuar paratë. Kjo nuk do të thotë se dokumentet e tjera me të cilat e kemi ndjekur transparencën nuk janë të rëndësishëm (Projekt buxheti, Buxheti i miratuar, raportet tremujore, Buxheti qytetarë, raporti i auditimit dhe Statuti), dhe studime të tjera në të ardhmen mund të konsiderojnë qasje të ndryshme metodologjike.

Në modelin tonë ekonometrik ndjekim qasjen nga e përgjithshmja drejt specifikes dhe përdorim logaritëm (log) të variablave. Ky studim nuk ka për qëllim që të ofrojë një kërkim rigoroz ekonometrik, por për ta testuar hipotezën tonë që e kemi përmendur më parë, ajo se madhësia e komunës mund të ketë ndikim në transparencën fiskale të komunave në Maqedoni.

Rezultatet nga vlerësimi janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabelë: Vlerësimi i rezultateve të ndikimit të madhësisë së komunës në transparencën fiskale

Variablat $\beta_0 + \sum_1^5 \beta_i * OUT_i \beta_1$	**Modeli i katrorëve më të vegjël me logaritmimin e vlerave** [1)]
Prerja - β_0	-2,189*** (-3,441)
Banorët, gjithsej	0,093* (1,639)
Sipërfaqja	0,126** (2,322)
Tatimi	0,158** (2,153)
Durbin Watson	1,703

Vërejtje:
78 observime
1) t-statistika në kllapa
* i rëndësishëm në nivelin e signifikancës prej 10% (vlera kritike prej 1,293)
** i rëndësishëm në nivelin e signifikancës prej 5% (vlera kritike prej 1,665)
*** i rëndësishëm në nivelin e signifikancës prej 1% (vlera kritike prej 2,375)

Nga tabela mund të shihet se komunat më të mëdha, sipas të tri definicioneve të madhësisë së komunës, janë më transparente (transparenca është definuar si paraqitje e Llogarisë përfundimtare në faqen e internetit).

Në këtë pjesë, tentojmë të shohim nëse madhësia e komunës ka ndikim në transparencën fiskale. Definuam madhësinë e komunës sipas popullsisë, sipërfaqes dhe të ardhurave nga burimet vetanake për banorë, dhe transparencën përmes publikimit të Llogarive përfundimtare në faqen e internetit. Kemi gjetur se ka një korrelacion të caktuar midis madhësisë dhe transparencës së komunave në Maqedoni, mirëpo kjo duhet të shqyrtohet më tutje përmes analizave më rigoroze. Një studim më rigoroz mund të marrë parasysh efektin e kauzalitetit. Për shembull, Alt et al (2001) kanë konstatuar se transparenca fiskale e rrit madhësinë e qeverisë dhe kjo nënkupton se institucionet buxhetore më transparente nxisin që politikanët më shumë të tentojnë kundrejt llogaridhënies, të cilëve më pas votuesit u japin miratim më të madh të burimeve (mesatarisht). Votuesit, gjithashtu, reagojnë duke u besuar politikanëve më shumë burime atje ku institucionet janë më transparente, që çon në rritjen e madhësisë relative të buxheteve.

Literatura e përdorur: *Alt, James E.; Dreyer Lassen, David; Skilling, David (2001) : Fiscal Transparency, Gubernatorial Popularity, and the Scale of Government: Evidence from the States, EPRU Working Paper Series, No. 2001-16.*

Pjesa 3

4. Përfundime dhe rekomandime

4.1. Gjendja e transparencës së procesit buxhetor dhe mësimet e marra

Nga gjetjet e përmendura më sipër të cilat janë rezultat i monitorimit në një periudhë njëvjeçare nga ana e Koalicionit për monitorim buxhetor mund të konkludojmë se ekziston hapësirë e konsiderueshme për përparimin e transparencës buxhetore të komunave në Maqedoni. Pikërisht:

- Të rralla janë komunat të cilat në ueb faqen e tyre e publikojnë Projekt buxhetin për vitin e ardhshëm. Me këtë u mohohet mundësia qytetarëve të interesuar për të marrë pjesë në planifikimin e buxhetit të komunës së tyre.
- Asnjë komunë në Maqedoni nuk e përgatit dhe nuk e publikon Buxhetin qytetarë, që tregon se me rregullativën ligjore aktuale asnjë pushtet lokal nuk përpiqet për t'i nxitur më shumë qytetarët të marrin pjesë në krijimin e buxhetit të komunave dhe në ndjekjen e zbatimit të tij. Për shembull, në Kroaci 7 qarqe (nga gjithsej 20) publikojnë një dokument të tillë, 19 qytete (nga gjithsej 128) dhe 3 komuna[16].
- Vitin e kaluar vetëm 10 komuna në Maqedoni e kanë publikuar gjendjen e borxhit në ueb faqet e tyre (Gostivari, Strumica, Manastiri, Ilindeni, Berova, Çashka, Vevçani, Dollneni, Krivogashtani, Krusheva), megjithëse pesë prej tyre nuk e kanë bërë atë rregullisht, por në kuadër të një ose dy raporteve tremujore për ekzekutimin e buxhetit gjatë 12 muajve të monitorimit (Shtipi, Vevçani, Dollneni, Krivogashtani, Krusheva).
- Në periudhën e njëjtë, vetëm 20 komuna kanë publikuar raporte tremujore në faqet e internetit, edhe pse 8 prej tyre nuk e kanë bërë atë rregullisht dhe në kohë. Me çka qytetarëve u mohohet mundësia për të kontrolluar realizimin e rregullt të buxhetit, kur pushteti lokal dhe administrata komunale mbeten të vetmit pjesëmarrës të drejtpërdrejtë në procesin buxhetor në komunë. Jashtëzakonisht të rralla janë komunat të cilat raportet tremujore i publikojnë në ndonjë vend të posaçëm në ueb faqet e tyre (rregullisht vetëm Gazi Baba dhe Manastiri, kurse Prilepi dhe Vinica herë pas here), ndërsa komunat e tjera që i publikojnë këto dokumente, më së shpeshti atë e bëjnë në kuadër të lajmëruesit zyrtare. Lajmëruesit zyrtare, megjithatë, në raste të shumta janë dokumente voluminoze, në disa raste në formate të palexueshme (të skanuar dobët

[16] Otvorenost proračuna županija, gradova i općina: studeni 2014. – ožujak 2015, Institut za javne financije, Newsletter Br.97, http://www.ijf.hr/upload/files/file/newsletter/97.pdf

apo me hapësira boshe), të vështirë për kopjim ose për navigim. Me një qasje të tillë të vështirë mund të supozojmë se sa pak një qytetar mesatar do të jetë i interesuar t'i kërkon këto dokumente.

- Llogarinë përfundimtare për vitin 2014 nuk e kanë publikuar në ueb faqet e tyre më shumë se gjysma e komunave, edhe pse disa nga to e kanë publikuar Llogarinë përfundimtare për vitin 2013 ose për vitet e mëparshme. Ndër komunat më të mëdha të cilat nuk e kanë publikuar Llogarinë përfundimtare për vitin 2014 janë Kumanova, Çairi dhe Kërçova. Nga ato komuna të cilat e kanë publikuar Llogarinë përfundimtare për vitin 2014, 6 komuna e kanë publikuar vetëm pjesën e përgjithshme, pa prezantim të detajuar të kategorive të të ardhurave dhe shpenzimeve. Nga komunat më të mëdha, Tetova dhe Kriva Pallanka publikojnë vetëm pjesën e përgjithshme të Llogarisë përfundimtare.
- Dokumente buxhetore më të disponueshme për qytetarët janë buxhetet e komunave, meqenëse 60 komuna i publikojnë buxhetet në ueb faqet e tyre në kuadër të lajmëruesit zyrtare ose në ndonjë vend të posaçëm. Nga këto, 9 komuna nuk e kanë publikuar Buxhetin për vitin 2015, por për ndonjë vit të mëparshëm. Nga komunat më të mëdha të cilat nuk e kanë publikuar Buxhetin për vitin 2015 në ueb faqet e tyre janë Kumanova, Çairi dhe Shuto Orizarja.

Organizatat që kanë bërë monitorim si pjesë e Koalicionit për monitorim buxhetor kanë komunikuar me të gjitha komunat në Maqedoni dhe pothuajse nga të gjitha komunat morrën Buxhetin, kurse nga shumica e tyre edhe Llogarinë përfundimtare dhe raportet tremujore. Duhet të theksohen edhe disa shembuj të rrallë ku komuna i publikon dokumentet buxhetore në nivel të nën-linjave, me çka shumë më hollësisht tregohen burimet e të ardhurave të komunës dhe për çfarë qëllimesh konkrete harxhohen mjetet e komunës. Të tilla janë: Demir Kapija (e cila në nivel të nën-linjave e prezanton Llogarinë përfundimtare), Çashka (Llogarinë përfundimtare dhe raportet tremujore), Karposhi (Buxhetin, Llogarinë përfundimtare dhe raportet tremujore), Petroveci (raportet tremujore dhe Llogarinë përfundimtare), Gazi Baba (raportet tremujore dhe raportin vjetor) Negotina (Llogarinë përfundimtare), Struga (Llogarinë përfundimtare, raportet tremujore dhe Buxhetin), Vinica (raportet tremujore dhe Buxhetin), Gjorçe Petrovi (Buxhetin), Qendra (Buxhetin), Kisella Voda (Buxhetin dhe Llogarinë përfundimtare), Likova (raportet tremujore).

Pothuajse një e katërta e komunave publikojnë edhe raporte vjetore si shpjegim narrativ i llogarive përfundimtare. Forma dhe madhësia (niveli i detajeve) e këtyre raporteve ndryshon, respektivisht është zgjedhje e çdo komune. Pikërisht, janë publikuar raporte vjetore me nga 4 deri 8 faqe në të cilat ka një pjesë të shkurtër tekstuale dhe pjesë tabelore për të ardhurat dhe shpenzimet, raport për mjetet, kërkesat, detyrimet dhe burimet e mjeteve dhe vlerat e tyre, raport për realizimin e programeve investuese, dotacionet e destinuara, kapitale dhe ato bllok dhe

dotacionet për kompetenca të deleguara e kështu me radhë. Mirëpo, ekzistojnë raporte edhe më të hollësishme për rezultatet e punës së organeve komunale në vitin 2014, siç janë: numri i vendimeve për tatim dhe taksa komunale, vlera në të holla e rrugëve të ndërtuara, pjesëve të rrugëve, kanalizimeve, rindërtimeve, trotuareve, legalizimi i objekteve të ndërtuara në mënyrë të paligjshme, kërkesat për ndërtim, riparimet e shkollave, inspektimet, PUD-at e sjellur, raportet e detajuara për kërkesat dhe detyrimet e komunës ndaj personave fizikë dhe juridikë, si dhe takimet e realizuara të kryeprefektit me qytetarët.

Një numër i vogël i komunave e publikojnë të ashtuquajturën "llogaridhënie", e cila përmban fotografi të përfaqësuesve të pushtetit lokal dhe qendror, mirëpo në përmbajtjen e së cilës mungojnë elementet themelore të llogaridhënies[17]. Një pjesë e madhe e këtij publikimi ka të bëj me shumat e shpenzuara për projektet e pushtetit lokal, mirëpo duhet të ceken edhe procedurat me të cilat është arritur që të zbatohen ato projekte (procedurat për vendosjen lidhur me zbatimin e projekteve, procedurat për realizimin e furnizimeve publike apo zgjedhjen e ofertës më të mirë, si është dakorduar shuma finale për paratë komunale ose shtetërore të paguara për ndonjë investim të caktuar dhe ngjajshëm).

Së fundi, në lidhje me monitorimin e proceseve buxhetore rol të rëndësishëm kanë edhe mbikëqyrja dhe auditimi i punës financiare të komunave. Në vitin 2014 dhe 2015 Enti shtetëror për revizion ka bërë auditim të suksesshmërisë në 18 komuna[18] dhe auditim të rregullshmërisë në 2 komuna[19], mirëpo vetëm një nga këto komuna (Manastiri) i ka bërë publike dokumentet lidhur me auditimin në ueb faqen e saj[20]. Sidoqoftë, të gjitha auditimet janë të disponueshme në ueb faqen e Entit shtetëror për revizion, dhe disa prej tyre paraqesin gjetje serioze për punë të parregullt të komunave. Për qëllimet e këtij studimi është e panjohur (jashtë qasjes) nëse raportet e Entit shtetëror për revizion diskutohen në seancat e Këshillit të komunave (përveç në Ohër[21]). Në Veles ekziston shënim se ka pasur praktikë që raporti i Entit shtetëror për revizion të diskutohet në seancë të Këshillit (por kjo ka ndodhur në vitin 2007[22]), ndërsa për auditimin e fundit nuk ka informata të tilla.

---

[17] Sipas më shumë definicioneve: llogaridhënia përfshin elemente të performancës të cilat maten dhe raportohet mbi to (OECD Journal of Budegting, De Jong et al. 2013), Llogaridhënia definohet në kuptim të një sistemi të përgjithshëm të llogaridhënies, ku aktorët janë përgjegjës dhe përballen me pasojat në kuadër të qeverisë dhe jashtë qeverisë (Transparency and accountability Initiative, Budget Transparency, Folscher, 2010).

[18] http://dzr.mk/DesktopDefault.aspx?tabindex=17&tabid=1144

[19] http://dzr.mk/DesktopDefault.aspx?tabindex=17&tabid=1143

[20] Raporte të auditimit nga vitet e mëparshme kanë komunat Berovë, Karposh, Ohër, Llozovë, Dellçevë dhe Zhelinë

[21] http://www.webohrid.com/2013/12/05/gradonacalnikot-bakraceski-ja-prezentirase-informacijata-za-sprovedenata-revizija-na-drzavniot-zavod-za-revizija/

[22] Rendi i ditës i seancës së 54 të Këshillit të komunës së Velesit, 20.09.2007, http://veles.gov.mk/veles3/index.php/dneven-red/497----54------

Në Prilep edhe pse nuk ka asnjë informatë të publikuar mbi auditimin në faqen e internetit të komunës, ajo e ka informuar opinionin për raportet pozitive të marra nga Enti shtetëror për revizion[23].

4.2. Përfundimet nga gjetjet mbi transparencën e procesit buxhetor

Nga gjetjet e lartpërmendura të cilat bazohen në monitorimin e gjerë të transparencës së procesit buxhetor të komunave në Maqedoni me një metodologji konkrete, duke mbuluar më shumë aspekte të transparencës dhe me përfshirjen e perceptimeve të një numri të konsiderueshëm të palëve të interesuar, mund t'i përmbledhim konstatimet kryesore:

- Matja e transparencës buxhetore në të gjitha komunat është një sfidë për shkak numrit të madh të komunave, kurse vetë procesi përfshinë aspekte të shumta (disponueshmëria e dokumenteve, struktura e dokumenteve, forma e prezantimit, të qenurit në kohë dhe detajet, etj) dhe një numër të madh të palëve të interesuar të cilët në mënyrë të drejtpërdrejtë ose indirekte janë të lidhur me procesin buxhetor (perceptimet e tyre dhe niveli i pjesëmarrjes në atë proces);
- Rregullativa ligjore len mundësi, por nuk i detyron komunat për shpalosjen e tërësishme të informatave dhe dokumenteve lidhur me procesin buxhetor;
- Komunat rrallë e publikojnë Projekt buxhetin, dhe për vitin 2015 në ueb faqet e NJVL ky dokument ka qenë i disponueshëm vetëm në 9 komuna, me kërkesë ka qenë i disponueshëm në 33 komuna dhe në 38 komunat e tjera nuk ka qenë i disponueshëm ose nuk është fituar;
- Buxheti i miratuar për vitin 2015 është marrë pothuajse nga të gjitha komunat, edhe atë përmes faqes së internetit të komunave, lajmëruesve zyrtare ose nëpërmjet kërkesës së parashtruar;
- Ekzistojnë komuna të cilat: ende nuk kanë ueb faqe zyrtare funksionale (tre komuna), i publikojnë informatat në ueb faqe vetëm në gjuhën shqipe (tetë ueb komuna), informata të pa azhuruara (të vjetruara) në faqet e internetit, ueb faqe të cilat fare nuk kanë dokumente lidhur me buxhetin etj, që e komplikojnë monitorimin e disponueshmërisë së dokumenteve që kanë të bëjnë me transparencën buxhetore;
- Disponueshmëria e dokumenteve në lidhje me strukturën është e ndryshme dhe dokumentet shpesh publikohen pjesërisht ose në formë të përmbledhur apo publikohen vetëm vendime ose konkluza;

[23] http://www.patokazmagazin.com.mk/vesti/item/opshtina-prilep-drzhavniot-zavod-za-revizija-lani-ni-gi-dade-najpozitivnite-izveshtai-sdsm-znae-samo-da-lazhe-i-manipulira

- Raportet tremujore mbi ekzekutimin e buxhetit të komunës më rrallë publikohen në faqen e internetit të komunave, dhe shumë më shpesh publikohet vetëm konkluza nga seanca e Këshillit nga miratimi i raporteve tremujore mbi realizimin e buxhetit;
- Komunat përgatisin Llogari përfundimtare dhe Raport vjetor[24], por këto nuk i publikojnë tërësisht në faqet e internetit. Këto dokumente më shpesh publikohen pjesërisht (jo të plota apo të përmbledhura) ose fitohen vetëm me kërkesë. Llogaria përfundimtare për vitin 2014 është e disponueshme për 24 komuna në ueb faqet e komunave, për 17 komuna ajo është e publikuar në kuadër të lajmëruesit zyrtare në ueb faqen e komunës, për 30 komuna është marrë me kërkesë nga monitoruesit dhe për 9 komuna nuk është marrë;
- Nga buxhetet e disponueshme dhe të fituara për vitin 2015, Buxheti i miratuar në 15 komuna nuk ka të dhëna për shpenzimet sipas klasifikimit funksional, ndërsa në buxhetet e tjera këto të dhëna publikohen;
- Buxheti i NJVL me plan për buxhetin në vitet e ardhshme (një ose dy) ekziston vetëm për 19 komuna, ndërsa gjendja e borxhit si pjesë e buxhetit (të vitit 2014 ose 2015) publikohet vetëm në 9 komuna;
- Buxheti qytetarë si dokument i cili në mënyrë të thjeshtë dhe të kuptueshme paraqet shpenzimet e NJVL dhe buxhetit, dhe i kushtohet opinionit pa ekspertizë, nuk është identifikuar në ndonjë nga NJVL në periudhën e monitorimit;
- Tek pjesa më e madhe e komunave në Maqedoni nuk ka informata për kontakt të anëtarëve të Këshillit të komunave, gjë që e bën qasjen në to jashtëzakonisht të vështirë. Numër i pamjaftueshëm i komunave i publikojnë agjendat ditore apo diskutimet nga seancat e Këshillit, dhe shpesh interesimi i qytetarëve për të qenë të pranishëm në seancat e Këshillit shoqërohet me procedura për miratimin e pranisë, gjë që e vështirëson pjesëmarrjen e mundshme të qytetarëve në krijimin e vendimeve në nivel lokal;
- Prej 365 anëtarësh të Këshillit të komunave (të përfshirë me anketën) pothuajse gjysma e tyre rrallë përdorin dokumente buxhetore, ndërsa 10% fare nuk përdorin dokumente buxhetore;
- Më shumë se gjysma e këshilltarëve konsiderojnë se i kuptojnë mirë dokumentet buxhetore, kurse 45% besojnë se i kuptojnë pjesërisht ato. Arsyeja më e shpeshtë për kuptimin e pjesërishëm ose moskuptimin e dokumenteve buxhetore është mospasja kohë të mjaftueshme për shqyrtimin e tyre, ndërsa struktura, stili dhe klasifikimet bashkërisht përbëjnë 53% nga arsyet e deklaruara për moskuptimin;
- Si institucion dhe aktorë më me rëndësi në procesin buxhetor këshilltarët konsiderojnë se janë vetë ata, respektivisht Këshilli i komunës, pastaj

[24] Ligji për financimin e njësive për vetëqeverisje lokale

Kryetari i komunës dhe Ministria e financave, ndërsa dokumente më të rëndësishme buxhetore për to janë: Projekt buxheti, Buxheti komunal i sjellur/miratuar, pastaj Qarkorja buxhetore e Ministrisë së financave. Ndërsa si pjesëmarrës më të rëndësishëm që kontribuojnë në transparencën e procesit buxhetor këshilltarët, sikur edhe qytetarët, konsiderojnë se janë (1) qeveritarët e qytetit ku bëjnë pjesë edhe ata, (2) televizionet lokale dhe (3) qytetarët dhe sektori civil;

- Pjesa më e madhe (76%) e këshilltarëve të anketuar janë përgjigjur se ata kanë ndikuar në sjelljen e ndryshimeve të caktuara në buxhetin, kurse 22% e këshilltarëve kanë deklaruar se nuk kanë ndikuar në ndryshimet e buxhetit;
- Të gjithë aktorët individualisht konsiderojnë se është i nevojshëm komunikim më intensiv dhe më i hapur në mes të komunës dhe qytetarëve dhe aktivitet më i madh nga të dyja anët, si dhe intensifikim të pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e krijimit të buxhetit dhe realizimin e tij me çka do të ishte rritur transparenca dhe llogaridhënia;
- Nga punonjësit të cilët drejtpërsëdrejti marrin pjesë në procesin buxhetor të komunës, 68% janë përgjigjur se i përdorin shpesh dokumentet buxhetore të komunës dhe një e katërta (26%) janë përgjigjur se rrallë i përdorin ato. Pjesa më e madhe e tyre (79%) konsiderojnë se i kuptojnë mirë dokumentet buxhetore me të cilat ata punojnë, 19% i kuptojnë pjesërisht dhe vetëm 2% nuk i kuptojnë, ndërsa si shkaqe për kuptimin e pjesërishëm apo moskuptimin e dokumenteve janë cekur koha e pamjaftueshme dhe stili profesionist në të cilin dokumentet janë shkruar;
- Mediat, qytetarët dhe organizatat civile më rrallë i përdorin dokumentet buxhetore, kështu që 13% e të anketuarve kanë deklaruar se i përdorin shpesh dokumentet buxhetore, 43% i përdorin rrallë dokumentet buxhetore, ndërsa pjesa e mbetur prej 44% nuk përdorin aspak ndonjë dokument buxhetor;
- Më shumë se një e katërta (27%) e qytetarëve të anketuar konsiderojnë se plotësisht i kuptojnë dokumentet buxhetore dhe financiare të komunës, më shumë se gjysma (52%) i kuptojnë pjesërisht, ndërsa rreth një e pesta fare nuk i kuptojnë dokumentet buxhetore të cilat i përgatit/publikon komuna. Arsyet më të shpeshta se pse dokumentet buxhetore nuk kuptohen ose pjesërisht kuptohen janë: (1) koha respektivisht interesimi i pamjaftueshëm për to nga ana e qytetarëve, (2) stili profesionist i dokumenteve, si dhe (3) klasifikimet e pakuptueshme;
- Si dokumente më të rëndësishëm në procesin buxhetor kanë veçuar (1) Buxhetin e sjellur/miratuar (33%) dhe (2) Projekt buxhetin (31%);
- Shumica e qytetarëve konsiderojnë se komunat shumë rrallë ndërmarrin aktivitete për t'i thjeshtësuar informatat për buxhetin dhe shpenzimin e parave publike, dhe sipas tyre arsyet më të shpeshta për këtë janë

mospasja e interesimit nga ana e përfaqësuesve të NJVL, fshehja e informatave ose mosnjohja e nevojës për transparencë.

4.3. Rekomandime për përparimin e transparencës së procesit buxhetor

Gjetjet kryesore nga realizimi i monitorimit të transparencës së procesit buxhetor në komunat e Maqedonisë tregojnë se ekziston hapësirë e konsiderueshme për përparimin e transparencës së procesit buxhetor, si dhe ekzistojnë **pengesa** të cilat e dobësojnë lidhjen dhe komunikimin midis pushtetit lokal dhe qytetarëve, edhe atë:

• ***Qytetarët nuk janë të motivuar****, as që marrin iniciativë për të shprehur mendimin e tyre mbi performancat e pushtetit lokal, si rezultat i ndjenjës së pafuqisë, mosbesimit ose për shkak të mungesës së informatave të cilat konsiderojnë se janë të besueshme.*
• *Njëkohësisht **pushteti lokal nuk ka motivim** dhe nuk ndërmerr iniciativë t'u përgjigjet porosive dhe prioriteteve të qytetarëve atëherë kur ajo është e mundur. Përgjigjja dhe llogaridhënia e pushtetit lokal për nevojat e qytetarëve duhet të përforcohet përmes komunikimit dhe debatit më aktiv publik. Përmirësimi i komunikimit do të ndihmojë që të krijohet një klimë për t'i dëgjuar kërkesat dhe argumentet e të gjitha palëve dhe motiv për pushtetin lokal që t'u përgjigjet nevojave të qytetarëve. Kjo do të çojë në rritjen e besimit tek qytetarët, mbështetje më të madhe për veprimet, masat, si dhe për performancat e pushtetit lokal.*
• ***Kapacitet i ulët i pushtetit lokal për ta shndërruar feedback-un e qytetarëve në aktivitete.*** *Kjo është pjesërisht për shkak të kufizimeve politike dhe mungesës së aftësive dhe sistemeve/procedurave në komunë.* Pushteti lokal duhet t'i përmirësojë veglat që në mënyrë efikase t'i grumbullon dhe analizon informatat e qytetarëve dhe t'i shndërron ato në zgjidhje përmes shpërndarjes efikase të burimeve të disponueshme.
• ***Qytetarët nuk kanë mundësi për pjesëmarrje:*** *qytetarëve ju duhet një qasje e përparuar përmes veglave dhe procedurave më të mira, si dhe njohuri që më lehtë dhe në mënyrë më aktive të inkuadrohen në punën e pushtetit lokal ashtu që të rezulton në veprim të duhur nga ana e qeverisë, kurse nga anën tjetër në shoqëri civile më të fortë.*

Prandaj, rekomandimet e mëposhtme kanë për qëllim që ta rrisin efektivitetin e qytetarëve dhe të sektorit civil në kërkesën për transparencë dhe llogaridhënie më të madhe nga pushteti lokal, por edhe sistemet e nevojshme që duhet t'i ndërtojnë qeveritarët lokal për të përparuar komunikimin dhe transparencën drejt qytetarëve të tyre.

I. Rekomandime për pushtetin ekzekutiv dhe anëtarët e Këshillit të komunave për përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies së procesit buxhetor:

1. Proces i konsultimit para se të miratohet Buxheti. Në periudhën pas përgatitjes së Projekt buxhetit, por para se të prezantohet para Këshillit, është i nevojshëm konsultim me qytetarët (të cilët i paguajnë tatimet), që do të mundëson përfshirjen e nevojave lokale të qytetarëve dhe do të inkuadron një numër më të madh të mendimeve dhe ideve të cilat kanë një përfshirje më të gjerë se sa të Këshillit. Edhe pse zgjedhjet lokale japin një drejtim të përgjithshëm të nevojave dhe preferencave të qytetarëve, megjithatë kjo nuk është e mjaftueshme për vendimmarrësit për t'i marrë në konsideratë të gjitha nevojat e qytetarëve për të gjitha programet dhe detajet në Buxhet. Prandaj është i nevojshëm angazhim dhe pjesëmarrje e qytetarëve para se të dorëzohet Projekt buxheti tek këshilltarët, me çka to të mundësohet rritje të iniciativës dhe motivim të qytetarëve për të marrë pjesë dhe më pas edhe llogaridhënie dhe mbikëqyrja publike;
2. Ndryshim të rregullativës ligjore, me qëllim që komunat të obligohen plotësisht t'i publikojnë Projekt buxhetin, Buxhetin dhe raportet e kohëpaskohshme mbi ekzekutimin e buxhetit, në kohë dhe tërësisht (siç është obligimi për Buxhetin qendror në Ligjin për buxhetet), dhe jo vetëm në lajmëruesin zyrtare të komunës. Ministria e financave, e cila rregullisht i merr raportet nga komunat, mund të ndihmojë konsiderueshëm në shpalosjen e raporteve që janë veç më të përgatitur nga ana e komunave;
3. Publikim të kalendarit buxhetor të komunave në një vend publik dhe zbatimin e tij të rregullt dhe në kohë me futjen e diskutimeve publike për Projekt buxhetin dhe raportin vjetor, publikimin e raporteve mbi ekzekutimin e buxhetit në baza mujore, tremujore dhe gjashtëmujore;
4. Publikim të plotë të dokumenteve dhe raporteve të rregullta mbi ekzekutimin e buxhetit me të dhëna të cilat mundësojnë të bëhet krahasim me buxhetet e kaluara, si dhe të planifikuara dhe projektuara për periudhën (periudhat) e ardhshme, me çka do të mundësohet mbikëqyrje publike më të madhe dhe kontroll nga ana e qytetarëve dhe aktorëve të tjerë në kushte kur nuk kemi auditim të jashtëm të rregullt (çdo vit) të të gjitha komunave;
5. Mundësim të auditimit të jashtëm më të rregullt/më të shpeshtë për të gjitha komunat[25];

[25] Në Mal të Zi secila komunë ka obligim ligjor që të angazhon firmë komerciale për auditim që të bëj auditim të Llogarisë përfundimtare të buxhetit dhe të përpiloj raport mbi auditimin. Këto raporte u shërbejnë këshilltarëve në komunat si mendim i pavarur për atë nëse ajo që është e publikuar në Llogarinë përfundimtare korrespondon me gjendjen reale: http://mojgrad.me/komercijalna-revizija

6. Organizim të rregullt të debateve publike dhe zgjatje të periudhës në mes të Projekt buxhetit dhe miratimin e Buxhetit - mirëpo sipas një procedure të vendosur tek komunat, e cila do të zbatohet rregullisht, dhe nuk do varet nga vullneti i pushtetit ekzekutiv apo nga disponueshmëria e ndihmës së donatorëve;
7. Shpalosje të shumës së borxhit të komunave në kohë dhe rregullisht, përmes raporteve ose në ndonjë vend të veçantë[26];
8. Përgatitje dhe praktikë e rregullt të publikimit të Buxhetit qytetarë, si një dokument i cili do t'i informojë qytetarët për planin e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin rrjedhës dhe për realizimin e buxhetit në një mënyrë të thjeshtë dhe të kuptueshme për të gjithë qytetarët;
9. Publikim në ueb faqet e komunave të njoftimeve për seancat e Këshillit së bashku me agjendat ditore, si dhe raportet e tërësishme (shënimet) për seancat e mbajtura të Këshillit;
10. Lehtësimin e procesit që të munden qytetarët të marrin pjesë në seancat e Këshillit (heqjen e procedurave administrative për praninë e qytetarëve të interesuar);
11. Prezantim publik të Projekt buxhetit në formë të diskutimit publik, për të cilin më parë do të informohen të gjithë qytetarët që janë të interesuar të marrin pjesë dhe të japin propozime të tyre;
12. Vendosjen e monitorimit të buxhetit dhe programeve përmes treguesve adekuat, matjen e kënaqësisë së qytetarëve nga shërbimet e komunës;
13. Edukim/informim të qytetarëve për shërbimet e komunës, rregullisht dhe në kohë, si dhe për të drejtat dhe obligimet e tyre dhe për mundësitë e përfshirjes së tyre në procesin e buxhetimit dhe participimit, si dhe përfitimet nga pjesëmarrja aktive në forume, diskutime dhe komunikim;
14. Ndërmarrjen e masave për të ngritur vetëdijen, për të rritur interesimin dhe aktivizimin e qytetarëve;
15. Vendosjen e një sistemi të të dhënave të hapura, respektivisht publikimin e dokumenteve financiare në forma të cilat mund të përpunohen dhe të analizohen nga qytetarët, organizatat civile, mediat, etj;
16. Edukim të anëtarëve të Këshillit të komunave në fushën e financave publike, dokumentet buxhetore, buxhetimin dhe ngjajshëm, para marrjes së detyrës, me qëllim që të mund të marrin vendime të informuara dhe efikase.

II. Rekomandime për qytetarët për përmirësimin e transparencës dhe procesit buxhetor tek komunat:

[26] Bullgaria e publikon borxhin e komunave përmes regjistrit për borxhin komunal: http://www.pravoto.com/site/diction/12593-tzentralen-registar-na-obshtinskiya-dalg

1. Inkuadrim aktivë në procesin e buxhetimit dhe në kontrollin e pushtetit ekzekutiv lidhur me harxhimin efikas të parave publike, si dhe kërkesë për llogaridhënie të komunave;
2. Edukim të qytetarëve rreth të drejtave të tyre dhe formave të pjesëmarrjes së tyre për promovimin e kulturës ku qytetarët e thjeshtë mund t'i rishqyrtojnë vendimet e atyre me fuqi më të madhe, duke përfshirë edhe vendimet buxhetore;
3. Qytetarët kanë të drejtën themelore të dinë për buxhetin e komunës, mirëpo për shkak të pamjes teknike të dokumenteve buxhetore të cilat i përgatitin komunat ato nuk janë të thjeshta për t'u kuptuar, prandaj është e nevojshme të kërkojnë nga komunat të përgatitin Buxhetin qytetarë;
4. Duhet të shtohet presioni publik për vendosjen e mekanizmave për informimin dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin buxhetor. Me këtë do të mundësohet pjesëmarrje e vazhdueshme e qytetarëve në monitorimin e shpenzimeve, realizimin, si dhe planifikimin më afatgjatë të mjeteve buxhetore të ardhshme;
5. Vendosje të një mekanizmi për komunikim me qytetarë përmes qasjes më të lehtë tek anëtarët e Këshillit të komunave;
6. Aktivizim në organizata civile, rrjete dhe koalicione të cilat synojnë transparencë dhe llogaridhënie më të madhe, por edhe kultivim të marrëdhënieve të punës dhe lidhjeve me vendimmarrësit në pushtetin lokal dhe Këshillin nëpërmjet të cilive qytetarët do të kenë hise në marrjen e vendimeve.

III. Rekomandime për punonjësit në komunat për përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies në procesit buxhetor tek komunat:

1. Mirëmbajtje të ueb faqeve funksionale të cilat do të jenë platformë për komunikim aktiv dhe informim të qytetarëve;
2. Organizim të mirë dhe azhurim të rregullt të ueb faqeve në të cilat publikohen informata për kontakt të përfaqësuesve të Këshillit dhe të punonjësve, si dhe të gjitha raportet që veç më përgatiten edhe sikur të dhëna të hapura që mund të shërbejnë për analiza, për mediat etj;
3. Përgatitje të Buxhetit qytetarë i cili do të prezantohet para qytetarëve;
4. Publikim i plotë i vendimeve të Këshillit të komunës, si dhe dokumente të tëra me të cilat informohet Këshilli, Ministria e financave dhe aktorët e tjerë;
5. Komunikim i hapur me qytetarët me qëllim të përafrimit të procesit buxhetor tek publiku;
6. Konsultime dhe ngritje të vazhdueshme të kapaciteteve të punonjësve në komunat lidhur me përgatitjen dhe prezantimin e dokumenteve buxhetore dhe informatave.

Bibliografia dhe literatura e shfrytëzuar

1. Strategjia fiskale e Republikës së Maqedonisë 2014-2016, Ministria e financave e Republikës së Maqedonisë, Shtator, 2013
2. Nikollov, Bogoevska, Qeverisje e mirë përmes transparencës më të madhe fiskale, Qendra për analiza ekonomike, 2014
3. Nikollov, Trenovski, Risteski, Buxheti qytetarë i Republikës së Maqedonisë. Qendra për analiza ekonomike, 2013, Në dispozicion: http://cea.org.mk/
4. International Monetary Fund‟s (IMF) "Code of Good Practices for Fiscal Transparency", 2007
5. Organization for Economic Cooperation and Development‟s (OECD) "Best Practices for Budget Transparency", 2002
6. Ligji për Buxhetet, tekst i spastruar, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 64/05, 04/08, 103/08,156/09, 95/10, 180/11 dhe 171/12
7. Ligji për vetëqeverisje lokale, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 5/02
8. Ligji për financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale (Tekst i spastruar i Ministrisë së financave të Republikës së Maqedonisë), Gazeta zyrtare nr. 61/04, 96/04, 67/07, 156/09 и 47/11
9. Qarkorja buxhetore – si bazë për përgatitjen e buxheteve të njësive të vetëqeverisjes lokale
10. Ligji për qasje të lirë në informata me karakter publik
11. Ueb portali për Buxhetin e Republikës së Maqedonisë - "Sa na kushton Maqedonia". Në dispozicion: http://www.mkbudget.org/
12. Buxheti i Republikës së Maqedonisë: http://www.finance.gov.mk/view/budget2013
13. Dokumente buxhetore: http://www.finance.gov.mk/view/budget2013
14. Matja e transparencës fiskale në nivel lokal (rasti i Kroacisë), Institut javnih finansija, 2010: http://www.ijf.hr/hr/istrazivanja/dovr-353-ena-istrazivanja/540/2006-2010/indeks-otvorenosti-proracuna-33-hrvatska-grada/168/
15. Open Budget Index (metodologjia, raportet, dokumentet): http://internationalbudget.org/what-we-do/open-budget-survey/
16. Ott. K., Bronic. M. I Petrusic . M, 2013, Otvorenost proracuna hrvatski zupanija, gradova I opcina, Newsletter br 81
17. Ott. K., Bronic. M. I Petrusic . M, 2014, Otvorenost proracuna hrvatski zupanija, gradova I opcina 2013-2014, Newsletter br 87
18. Ott. K., Bronic. M. I Petrusic . M, 2015 Otvorenost proracuna hrvatski zupanija, gradova I opcina 2014-2015, Newsletter br 97
19. Programi për implementimin e procesit të decentralizimit dhe zhvillimin e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Maqedonisë 2011-2014, Ministria e vetëqeverisjes lokale, Nëntor 2011, http://e-

demokratija.mk/documents/10157/26930/Програма+за+спроведување+на+процесот+на+децентрализација+2011-2014
20. Alt, James E.; Dreyer Lassen, David; Skilling, David (2001) : Fiscal Transparency, Gubernatorial Popularity, and the Scale of Government: Evidence from the States, EPRU Working Paper Series, No. 2001-16
21. Raport për realizimin e Programit për implementimin e procesit të decentralizimit dhe zhvillimin e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Maqedonisë 2011-2014, për vitin 2012, Ministria e vetëqeverisjes lokale, Dhjetor 2013, http://www.mls.gov.mk/data/file/Dokumenti/Documents/01%20-%20Integralen%20Izvestaj%20za%20Decentralizacija%202012%20%28MK%29.pdf
22. Vrteski, Ilijeva-Acevska, Hristov (2012), Manual për decentralizimin për përfaqësues të organizatave civile për monitorim të procesit për implementimin e decentralizimit në Republikën e Maqedonisë, Fondacioni Shoqëri e hapur – Maqedoni
23. Studim i transparencës dhe llogaridhënies së njësive të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Maqedonisë, Forum CSRD, 2011
24. Vetëqeverisje lokale të përgjegjshme dhe transparente, Raport nga studimi, Asociacioni për iniciativa demokratike (AID), 2012
25. Wilcox, Cameron, (2006), "Public Relations, Strategies and Tactics", Pearson Education, Inc.
26. Udhëzime themelore për përgatitjen e buxheteve të NJVL për vitin 2015, Shkup, Shtator 2014, Ministria e financave
27. Raporte të organizatave lokale për monitorimin e transparencës buxhetore, www.kbm.mk
28. Sondazhe me këshilltarët, qytetarët, punonjësit në të gjitha komunat e Republikës së Maqedonisë të kryera nga organizatat për monitorim

Aneks

PYETËSORI 1 – Qasja dhe adekuenca e strukturës së dokumenteve që kanë të bëjnë me buxhetin lokal dhe me procesin buxhetor

P-1 Propozim-buxheti i NJVL a ishte publikisht me qasje për nevojat e hulumtimit? **a) Po, ishte me qasje në faqen e internetit të NJVL, apo u mor me kërkesë** **b) Jo/Nuk është e njohur** **Burimi:** **Vërejtje:**
P-2 Për nevojat e hulumtimit, a ishte publikisht me qasje buxheti i nxjerrë i NJVL? **a) Po, ishte me qasje në faqen e internetit të NJVL, apo u mor me kërkesë** **b) Jo/Nuk është e njohur** **Burimi:** **Vërejtje:**
P-3 Për nevojat e hulumtimit, a ishin publikisht me qasje Raportet tremujore, Raporti vjetor nga përmbarimi i buxhetit të NJVL? **a) Po, ishin me qasje në faqen e internetit të NJVL, apo u morën me kërkesë për Raportet tremujore (ose raportet tjera periodike) dhe vjetore** **b) Po, ishte me qasje në faqen e internetit të NJVL, apo u mor me kërkesë vetëm Raporti vjetor** **c) Jo/Nuk është e njohur** **Burimi:** **Vërejtje:**
P-4 Për nevojat e hulumtimit, a ishte publikisht me qasje Raporti nga revizioni i jashtëm i NJVL? **a) Po, ishte me qasje në faqen e internetit të NJVL (ose në tjetër mjet informimi), apo është marrë me kërkesë** **b) Jo/Nuk është e njohur** **Burimi:** **Vërejtje:**
P-5 Për nevojat e hulumtimit, a ishte publikisht me qasje Statuti i NJVL?

a) Po, ishte me qasje në faqen e internetit të NJVL (ose në tjetër mjet informimi), apo është marrë me kërkesë **b) Jo/Nuk është e njohur** **Burimi:** **Vërejtje:**
P-6 Sa ditë kanë kaluar nga nxjerrja e Propozim-buxhetit deri në publikimin e tij në gazetën zyrtare (në ueb-faqen zyrtare ose në ndonjë media tjetër)? **a) Numri i ditëve:** **б) Jo/Nuk është e njohur** **Burimi:** **Vërejtje:**
P-7 A përmban buxheti i propozuar dhe i miratuar të dhëna për shpenzimet sipas klasifikimit funksional? **a) Shpenzimet janë publikuar me detaje sipas klasifikimit funksional** **b) Pjesërisht të publikuar sipas klasifikimit funksional** **c) Nuk përmbajnë** **Burimi:** **Vërejtje:**
P-8 A përmban buxheti i propozuar dhe i miratuar të dhëna për shpenzimet sipas shfrytëzuesve të mjeteve? **a) Shpenzimet janë publikuar detajisht sipas shfrytëzuesve** **b) Pjesërisht të publikuara** **c) Nuk përmbajnë të dhëna** **Burimi:** **Vërejtje:**
P-9 A përmbajnë buxheti i propozuar dhe i miratuar të dhëna për shpenzimet sipas programeve që duhet realizuar? **a) Shpenzimet me detaje janë publikuar sipas klasifikimit programor** **b) Pjesërisht të publikuara (ka mangësi të caktuara në publikim)** **c) Nuk përmbajnë të dhëna**

Burimi: **Vërejtje:**
P-10 A përmbajnë buxheti i propozuar dhe i miratuar të dhëna për gjendjen e borxhit? **a) Ka të dhëna për gjendjen e borxhit** **b) Pjesërisht të publikuara (ka të dhëna vetëm për huamarrjen apo për pagesën e kryegjësë, për kamatën)** **c) Nuk përmbajnë të dhëna** **Burimi:** **Vërejtje:**
P-11 A përmbajnë buxheti i propozuar dhe i miratuar shpjegim të të dhënave makroekonomike dhe indikatorëve të tjerë të rëndësishëm për krijimin e buxhetit? **a) Ka të dhëna makroekonomike dhe detajisht është elaboruar ndërlidhja e tyre me buxhetin e NJVL** **b) Pjesërisht të publikuara (ka vetëm të dhëna makroekonomike, por mungon analiza e tyre në drejtim të të ardhurave/shpenzimeve të NJVL)** **c) Nuk përmbajnë të dhëna** **Burimi:** **Vërejtje:**
P-12 A përmbajnë buxheti i propozuar dhe i miratuar shpjegim për të ardhurat/shpenzimet e ndryshme të cilat janë pjesë e buxhetit (shpjegim të buxhetit)? **a) Ka shpjegime për të ardhurat/shpenzimet e ndryshme** **b) Pjesërisht të publikuara (ka shpjegime vetëm për të hyra të ndara apo për shpenzime të ndara)** **c) Nuk përmbajnë të dhëna** **Burimi:** **Vërejtje:**
P-13 A përmbajnë buxheti i propozuar dhe i miratuar shpjegim për programet e mëvetësishme, të cilat janë pjesë e buxhetit (shpjegim të buxhetit)? **a) Ka shpjegime detajore për programet e ndryshme**

b) Ka shpjegime, por nuk janë të mjaftueshme detajet **c) Nuk përmbajnë të dhëna** **Burimi:** **Vërejtje:**
P-14 A përmbajnë buxheti i propozuar dhe i miratuar të dhëna për shpenzimet sipas klasifikimeve të ndryshme (funksionale, programore dhe ekonomike) për vitin e kaluar (T-1)? **a) Ka të dhëna detajore sipas klasifikimeve të ndryshme për vitin/vitet e kaluar/a** **b) Ka të dhëna të pjesshme apo të pamjaftueshme për vitin e kaluar** **c) Nuk përmbajnë të dhëna/dokument pa qasje** **Burimi:** **Vërejtje:**
P-15 A përmbajnë buxheti i propozuar dhe i miratuar të dhëna për shpenzimet/të hyrat sipas klasifikimeve të ndryshme për vitin e ardhshëm (T+1)/(T+2)? **a) Ka të dhëna të detajuara për vitin/vitet e ardhshëm/ardhshme** **b) Ka të dhëna të pjesshme ose të pamjaftueshme për vitin/vitet e ardhshëm/ardhshme** **c) Nuk përmbajnë të dhëna/dokument pa qasje** **Burimi:** **Vërejtje:**
P-16 Pushteti komunal publikon Buxhet qytetar – publikim për buxhetin komunal dedikuar opinionit publik joprofesional? **a) Publikon dokument të tillë, i cili i përmban të gjitha të dhënat e nevojshme** **b) Publikohet publikimi i tillë, por përmbajtja e tij nuk jep informacione të mjaftueshme apo të njëjtat nuk janë mjaftueshëm të qarta për opinionin joprofesional** **c) Nuk ka publikim të tillë** **Burimi:** **Vërejtje:**

P-17 Raporti vjetor i NJVL a i përmban të gjitha elementet që i përmban buxheti, të shfaqura si të hyra/shpenzime të planifikuara dhe të realizuara për të gjithë shfrytëzuesit e buxhetit? **a) Po, përmban të dhëna të detajuara për të ardhura/shpenzime të planifikuara dhe të realizuara** **b) Të dhënat nuk janë mjaftueshëm të detajuara dhe nuk mund të shihet qartas realizimi/efektiviteti i buxhetit** **c) Nuk ka të dhëna/dokumenti nuk është me qasje** **Burimi:** **Vërejtje:**
P-18 Kryetari i komunës a i dorëzoi Llogarinë vjetore Këshillitë të komunës deri më 28 shkurt të vitit në vijim për vitin e kaluar? **a) Po** **b) Jo/Pse** **Burimi:** **Vërejtje:**
P-19 Këshilli i komunës a e nxori Llogarinë vjetore për vitin e kaluar deri më 15 mars të vitit në vijim dhe deri më 31 mars a iu dorëzua Ministrisë së Financave? **a) Po** **b) Jo/Pse** **Burimi:** **Vërejtje:**
P-20 Kryetari i komunës a ua dorëzon në kohë (në afat prej një muaji pas mbarimit të tremujorit) raportin tremujore Këshillit dhe Ministrisë së Financave? **a) Po** **b) Jo/Pse** **Burimi:** **Vërejtje:**
P-21 Ministria e Financave më së voni deri më 30 shtator të vitit në vijim ka përgatitur cirkular buxhetor për vitin e ardhshëm? **a) Po**

b) Jo **Burimi:** **Vërejtje:**
P-22 A kishte ndonjë mosrespektim të afateve të përcaktuara në kalendarin buxhetor dhe Statutin e komunës? **a) Jo** **б) Po – Cilat:** **Burimi:** **Vërejtje:**

PYETËSORI 2 – Bashkëpunimi me pushtetin qytetës/komunal – informata për bashkëpunim, dokumente dhe anëtarë të Këshillit të komunës

P-1 Pushtetet qytetëse/komunale (të kyçura në procesin buxhetor) a janë të hapur në mënyrë të përgjithshme për bashkëpunim? **a) Po** **b) Jo/Pse:** **Burimi:** **Vërejtje:**
P-2 Sa kohë ishte e nevojshme që nga koha e dorëzimit të një kërkese të caktuar (nëpërmjet e-maiiit, telefonit ose me shkrim) deri në marrjen e përgjigjes për të njëjtën? **a) Numri i ditëve/ e-maile/thirrje telefonike(në vërejtjet specifiko për cilat është fjala)** **b) Nuk morëm përgjigje** **Burimi:** **Vërejtje:**
P-3 Për cilat dokumente kishte nevojë që të dorëzohet kërkesë për dhënie të informatave/të dhënave dhe cilat ishin përgjigjet e tyre më të shpeshta? **a) Përmendi informacionet:** **б) Përmendi përgjigjet më të shpeshta:** **Burimi:** **Vërejtje:**
P-4 Në ueb-faqen e NJVL a mund të gjendet listë e anëtarëve të Këshillit dhe përkatësia e tyre politike? Dhe a ka kontakt-informacione për këshilltarët (telefon ose e-mail)? **a) Ka listë të anëtarëve të Këshillit, përkatësia e tyre politike dhe kontakt-informata** **b) Ka listë të anëtarëve të Këshillit dhe përkatësia e tyre politike** **c) Ka vetëm listë nga anëtarët e Këshillit** **ç) Nuk ka listë të tillë** **Burimi:**

Vërejtje:
P-5 Në ueb-faqen e NJVL a mund të gjenden kontakte të zyrtarëve nga sektori financiar (sektori për buxhet, të kyçur së fundmi në procesin buxhetor) **a) Kontaktet janë publikisht me qasje** **b) Nuk ka informacione me qasje publikisht** **Burimi:** **Vërejtje:**
P-6 Rendi i ditës, sipas të cilit Këshilli planifikon të punojë në mbledhjen që vjen, a është me qasje për publikun (në ueb-faqe, para së gjithash)? **a) Po** **б) Jo/Pse** **Burimi:** **Vërejtje:**
P-7 Diskutimet nga takimet e Këshillit a janë me qasje për publikun (në ueb-faqe, para së gjithash)? **a) Po** **б) Jo/Pse?** **Burimi:** **Vërejtje:**
P-8 Në statutin e NJVL a ka pjesë të caktuara të cilat të shtyjnë që materialet për mbledhjen në vijim dhe rendi i ditës të paraqiten publikisht? **a) Po** **б) Jo** **Burimi:** **Vërejtje:**
P-9 A ka në statutin e NjVL pjesë të cilat më afër e definojnë transparencën dhe llogaridhënien e pushteteve komunale, në lidhje me procesin buxhetor? **a) Cilat janë ato:** **Burimi:**

Vërejtje:
P-10 A kanë të drejtë qytetarët të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit qytetës/komunal? **a) Po** **b) Jo** **Burimi:** **Vërejtje:**
P-11 Gjatë përpjekjes për të marrë pjesë në mbledhjen e Këshillit të NjVL, cilat vërejtje/komente u morën nga këshilltarët/pushteti qytetës të pranishëm etj. **a) Vërejtje/Komente:** **b) Nuk ishte e lejuar prania në mbledhje** **Burimi:** **Vërejtje:**
P-12 Kryetari i komunës/Këshilli a organizon ndonjë aktivitet me qëllim që të përfshihen qytetarët në procesin buxhetor? **a) Nuk organizon** **b) Organizon – çfarë:** **Burimi:** **Vërejtje:**
P-13 Pushteti ekzekutiv a organizon kah fundi i vitit të mëparshëm (ose kah fundi i këtij viti) debat publik (ose ndonjë tip tjetër të komunikimit) për Propozim-buxhetin e komunës? **a) Nuk organizon** **b) Organizon:** **Burimi:** **Vërejtje:**
P-14 Pushteti ekzekutiv a organizon debat publik për raportin/llogarinë vjetore të komunës? **a) Nuk organizon** **b) Organizon:**

Burimi: **Vërejtje:**
P-15 Në periudhën (me bazë mujore) a ka ndonjë iniciativë qytetare me të cilën do të ishte paraqitur nevoja për ndryshimin e buxhetit në korrent (iniciativë qytetare, referendum, tribuna publike, parashtesa, propozime etj.).? **a) JO** **б) PO – Thekso cilat:** **Burimi:** **Vërejtje:**
P-16 Gjatë periudhës a kanë ndodhur aktivitete/ndryshime në komunë, gazetat/mediat publike apo në debatet publike të cilat drejtpërdrejt janë të lidhura me procesin buxhetor (ndodhitë ndiqen në mënyrë të vazhdueshme)? **Burimi:** **Vërejtje:**

PYETËSORI 3 – Perceptimi i anëtarëve të Këshillit të komunës kundrejt procesit buxhetor (nxjerrja, implementimi dhe monitorimi)

Rretho **Gjinia: a) mashkull b) femër** **Mosha: nën 20 vjeç nga 20-30 vjeç nga 30-40 vjeç nga 40 – 55 vjeç nga 55 deri 60 vjeç** **mbi 60 vjeç** **Sa kohë jeni këshilltar: 1-5 vjet 5-10 vjet mbi 10 vjet** **Sa kohë merreni me çështjet financiare/buxhetore:** **për herë të parë ballafaqohem me çështjet e këtilla 1-5 vjet 5-10 vjet mbi 10 vjet** **A jeni anëtar i: Partisë në pushtet Opozitës I pavarur**
P-1 A shfrytëzoni ndonjë prej dokumenteve buxhetore dhe sa shpesh i shfrytëzoni? **a) po, shpesh (cilat?)** **b) po, rrallë** **c) jo** **Vërejtje:**
P-2 A i kuptoni mirë dokumentet buxhetore/financiare që i shfrytëzoni? **a) po, mirë i kuptoj** **b) pjesërisht i kuptoj** **c) nuk i kuptoj** **Vërejtje:**
P-3 Cilat janë shkaqet kryesore për moskuptimin e dokumenteve buxhetore? **a) stili profesional me të cilin janë shkruar** **b) koha e pamjaftueshme** **c) ndërrimi i shpeshtë i terminologjisë** **ç) klasifikimet/ligjet e pakuptueshme**

d) struktura e dokumenteve **dh) i kuptoj plotësisht** **Vërejtje:**
P-4 Cili, sipas jush, është dokumenti më kryesor në procesin buxhetor (bëni rangimin nga 1 deri në 7)? Pse? **a) Cirkulari buxhetor** **b) Propozim-buxheti** **c) Buxheti i miratuar** **ç) Raportet periodike** **d) Raporti vjetor** **dh) Raporti nga revizori** **e) Tjetër** **Vërejtje:**
P-5 Cili, sipas jush, është institucioni më i rëndësishëm në procesin buxhetor (bëni rangimin nga 1 deri në 7)? **a) Kryetari i komunës** **b) Këshilli i komunës** **c) Ministria e Financave** **ç) grupet e realizuara lokale (biznesmenë, lobistë)** **d) sektori civil** **dh) mediat (televizioni, radioja, gazetat etj.)** **e) tjetër** **Vërejtje:**
P-6 Cili, sipas jush, është pjesëmarrësi më i rëndësishëm që kontribuon në transparencën e procesit buxhetor (bëni rangimin nga 1 deri në 8)? **a) stacionet televizive lokale** **b) stacionet lokale të radios** **c) gazetat lokale** **ç) sektori civil** **d) ueb-portalet** **dh) qytetarët** **e) pushtetet qytetëse** **ë) tjetër**

Vërejtje:
P-7 A kishit kohë të mjaftueshme për të diskutuar dhe për të shqyrtuar Propozim-buxhetin dhe prioritete për vitin korrent (ose vijues) para nxjerrjes së tij? **a) Po** **b) Jo (Përse?)** **Vërejtje:**
P-8 A keni kontribuar deri më tani në futjen e ndryshimeve dhe vërejtjeve të caktuara në buxhetin e komunës suaj? **a) Po** **б) Jo (Përse?)** **Vërejtje:**
P-9 Çka, sipas jush, mund të ndikojë dukshëm në rritjen e transparencës dhe në pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin buxhetor? **Theksoni:**
P-10 Çfarë mund të ndikojë dukshëm në rritjen e pjesëmarrjes dhe të ndikimit Tuaj në procesin buxhetor? **Theksoni:**
P-11 A komunikoni Ju me qytetarët dhe si (në idhje me prioritetet dhe strukturën e buxheteve)? **a) Po, shpesh** **b) Ndonjëherë** **c) Nuk komunikoj** **Vërejtje:**
P-12 A keni bashkëpunim të mirë me pushtetin ekzekutiv (kryetarin e komunës) ose me sektorin e financave, lidhur me shkëmbimin e dokumenteve, informatave dhe të dhënave për procesin buxhetor? **a) Po** **b) Pjesërisht (përse?)** **c) Jo (përse?)**

Vërejtje:
P-13 Për cilat zëra buxhetorë diskutuat në mbledhjen e fundit të Këshillit? **Theksoni:**
P-14 Rreth cilës pjesë të procesit buxhetor dhe zërave buxhetorë ka kundërshtime më të mëdha në Këshill? **Theksoni:**

PYETËSORI 4 – Perceptimi i të punësuarve në komunë, të cilët direkt janë të lidhur me procesin buxhetor

Rretho **Gjinia: a) mashkull b) femër** **Mosha: nën 20 vjeç nga 20-30 vjeç nga 30-40 vjeç nga 40 – 55 vjeç nga 55 deri 60 vjeç** **mbi 60 vjeç** **Sa kohë jeni të punësuar: 1-5 vjet 5-10 vjet mbi 10 vjet** **Sa kohë merreni me çështje financiare/buxhetore?:** **për herë të parë takohem me çështje të këtilla 1-5 vjet 5-10 vjet mbi 10 vjet**
P-1 A shfrytëzoni ndonjë prej dokumenteve buxhetore dhe sa shpesh i shfrytëzoni ato? **a) po, shpesh (cilat?)** **b) po, rrallë** **c) jo** **Vërejtje:**
P-2 A i kuptoni mirë dokumentet buxhetore/financiare që i shfrytëzoni? **a) po, mirë i kuptoj** **b) pjesërisht i kuptoj** **c) nuk i kuptoj** **Vërejtje:**
P-3 Cilat janë shkaqet kryesore të moskuptimit të dokumenteve buxhetore? **a) stili profesional në të cilin janë shkruar** **b) koha e pamjaftueshme** **c) ndërrimi i shpeshtë i terminologjisë** **ç) klasifikimet/ligjet e pakuptueshme** **d) struktura e dokumenteve** **dh) i kuptoj plotësisht** **Vërejtje:**

P-4 Cili, sipas jush, është dokumenti më i rëndësishëm në procesin buxhetor (bëni rangimin nga 1 deri në 7)? Përse? **a) Cirkulari buxhetor** **b) Propozim-buxheti** **c) Buxheti i miratuar** **ç) Raportet periodike** **d) Raporti vjetor** **dh) Raporti nga revizori** **e) Tjetër** **Vërejtje:**
P-5 Cili, sipas jush, është institucioni më i rëndësishëm në procesin buxhetor (bëni rangimin nga 1 deri në 7)? **a) Kryetari i komunës** **b) Këshilli i komunës** **c) Minsitria e Financave** **ç) grupet e organizuara lokale (biznesmenë, lobistë)** **d) sektori civil** **dh) mediat (televizioni, radioja, gazetat etj.)** **e) tjetër** **Vërejtje:**
P-6 Cili, sipas jush, është pjesëmarrësi më i rëndësishëm që kontribuon për tnrasparencën e procesit buxhetor?(bëni rangimin nga 1 deri në 8)? **a) stacionet televizive lokale** **b) stacionet lokale të radios** **c) gazetat lokale** **ç) sektori civil** **d) ueb-portalet** **dh) qytetarët** **e) pushtetet qytetëse** **ë) tjetër** **Vërejtje:**
P-7 A keni kohë të mjaftueshme për të parë dhe për të përgatitur dokumentet buxhetore (para së gjithash, Propozim-buxhetin dhe buxhetin e miratuar)?

a) Po **b) Jo (Përse?)** **Vërejtje:**
P-8 Çka, sipas jush, mund të ndikojë dukshëm në rritjen e transparencës dhe të pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin buxhetor? **Theksoni:**
P-9 A komunikoni ju me qytetarët dhe si? **a) Po, shpesh** **b) Ndonjëherë** **c) Nuk komunikoj** **Vërejtje:**
P-10 A keni marrë kërkesë nga ndonjë qytetar/organizatë për të dhënë informata në lidhje me buxhetin? **a) Po, shpesh (në lidhje me çka?)** **b) Ndonjëherë** **c) Nuk kam marrë deri më tani** **Vërejtje**
P-11 A ka ekzistuar ndonjë situatë, apo ajo ekziston në këtë moment, gjatë së cilës procesi buxhetor është çrregulluar (janë shkelur afatet, rregullativa ligjore etj.)? **a) Po (sqaroni se çfarë kanë qenë ato situata)** **b) Nuk ka pasur situatë të tillë** **Vërejtje:**
P-12 Cilat janë shkaqet për ndryshimet/zhvendosjet më të shpeshta në procesin buxhetor (që nga ndryshimi i zërave përkatës, vazhdimi i afateve, kërkesa për ndryshime në buxhet etj.)? **a) Nuk ka pasur rast të tillë** **b) Theksoni shkaqet:**
P-13 Çka mendoni, cili është shkaku më i rëndësishëm për interesimin/mosinteresimin e qytetarëve për punën Tuaj? **Theksoni:**

P-14 Çfarë është bashkëpunimi Juaj me Ministrinë e Financave?

a) I mirë
b) Ka mospajtime të caktuara në lidhje me:
c) Bashkëpunimi mund të përmirësohet në lidhje me:

Vërejtje:

PYETËSORI 5 – Perceptimi i qytetarëve dhe i asociacioneve qytetare

Rretho **Gjinia: a) mashkull b) femër** **Mosha: nën 20 vjeç nga 20-30 vjeç nga 30-40 vjeç nga 40 – 55 vjeç nga 55 deri 60 vjeç** **mbi 60 vjeç** **Sa kohë merreni me çështje financiare/buxhetore?:** **për herë të parë takohem me çështje të këtilla 1-5 vjet 5-10 vjet mbi 10 vjet**
P-1 A shfrytëzoni ndonjë prej dokumenteve buxhetore të vetëqeverisjes lokale dhe sa shpesh i shfrytëzoni ato? **a) po, shpesh (cilat?)** **b) po, rrallë** **c) jo** **Vërejtje:**
P-2 A i kuptoni mirë dokumentet buxhetore/financiare të vetëqeverisjes lokale që i shfrytëzoni? **a) po, mirë i kuptoj** **b) pjesërisht i kuptoj** **c) nuk i kuptoj (përse?)** **Vërejtje:**
P-3 Cilat janë shkaqet kryesore që i kuptoni/ nuk i kuptoni dokumentet buxhetore të vetëqeverisjes lokale? **a) stili profesional në të cilin janë shkruar** **b) koha e pamjaftueshme** **c) ndërrimi i shpeshtë i terminologjisë** **ç) klasifikimi/ligjet e pakuptueshme** **d) struktura e dokumenteve** **dh) i kuptoj plotësisht** **Vërejtje:**

P-4 Cili, sipas jush, është dokumenti më i rëndësishëm në procesin buxhetor të vetëqeverisjes lokale (bëni rangimin nga 1 deri në 7). Përse? **a) Cirkulari buxhetar** **b) Propozim-buxheti** **c) Buxheti i miratuar** **ç) Raportet periodike** **d) Raporti vjetor** **dh) Raporti i revizorit** **e) Tjetër** **Vërejtje:**
P-5 Cili, sipas jush, është institucioni më i rëndësishëm në procesin buxhetor (bëni rangimin nga 1 deri në 7). Përse? **a) Kryetari i komunës** **b) Këshilli i komunës** **c) Ministria e Financave** **ç) grupet e organizuara lokale (biznesmenë, lobistë)** **d) sektori civil** **dh) mediat (televizioni, radiot, gazetat etj.)** **e) tjetër** **Vërejtje:**
P-6 Cili, sipas jush, është pjesëmarrësi më i rëndësishëm që kontribuon për transparencën e procesit buxhetor (bëni rangimin nga 1 deri në 9)? **a) stacionet televizive lokale** **b) stacionet lokale të radios** **c) gazetat lokale** **ç) sektori civil** **d) ueb-portalet** **dh) qytetarët** **e) pushtetet qytetëse** **ë) Ministria e Financave** **f) tjetër** **Vërejtje:**
P-7 A i njihni të drejtat tuaja legale për të kërkuar informacione nga pushtetet lokale dhe për pjesëmarrje në pushtetin lokal (mes të cilave, edhe në procesin

buxhetor)? **a) Po** **b) Pjesërisht** **c) Jo** **Vërejtje:**
P- 8 A ju ka njoftuar ndokush deri më tani për të drejtat tuaja si qytetar që të kërkoni llogari (informacione dhe të dhëna) nga pushtetet lokale për çështje të caktuara që lidhen me buxhetin lokal (dhe për mënyrat sesi mund ta bëni atë)? **a) Po** **b) Jo** **Vërejtje:**
P-9 Komuna a ndërmerr ndonjë aktivitet që t'jua prezantojë dhe t'jua thjeshtojë informacionet për procesin/shpenzimin e mjeteve buxhetore (çfarë aktivitetesh)? **a) Po, ndërmerr aktivitete të vazhdueshme (Cilat?)** **b) Shumë rrallë ndërmerr aktivitete të tilla** **c) Jo –Përse sipas Jush nuk ndërmerr aktivitete të tilla:** **Vërejtje:**
P-10 A keni pasur mundësi deri më tani që të ndikoni në futjen e ndryshimeve dhe vërejtjeve të caktuara në buxhetin e komunës tuaj? **a) Po** **b) Jo (Përse?)** **Vërejtje:**
P-11 Çka, sipas jush, mund të ndikojë dukshëm në rritjen e transparencës të procesit buxhetor? **a) Thekso:** **Vërejtje:**
P-12 Çka do të kishte mundur që dukshëm të ndikojë në rritjen e pjesëmarrjes dhe të ndikimit Tuaj në procesin buxhetor? **a) Thekso:** **Vërejtje:**
P-13 Ndryshimet në implementimin e buxhetit a bëhen në mënyrë transparente dhe të njëjtat a paraqiten në mënyrë transparente para qytetarëve?

a) Po (në çfarë mënyre?) **b) Shumë rrallë** **в) Jo** **Vërejtje:**
P-14 A keni bashkëpunim të mirë me pushtetin ekzekutiv (kryetarin e komunës) apo me sektorin e financave në lidhje me shkëmbimin e dokumenteve, informatave dhe të dhënave për procesin buxhetor. A keni kërkuar deri më tani ndonjë informatë? **a) Po (cilën?)** **b) Jo (Përse?)** **Po qe se keni kërkuar informatë, cila ishte përgjigjja nga komuna (nga kompetentët):** **Vërejtje:**
P-15 Çka do të kishit bërë ju (çka bëni) që procesi buxhetor të jetë më transparent? **a) Thekso:** **Vërejtje:**
P- 16 A ka, sipas jush, shkaqe se përse komunat nuk hapin diskutim për buxhetin me qytetarët para se ai të nxirret, në fazën e implementimit dhe pastaj? **a) Nuk ka shkaqe** **b) Ka shkaqe – cilat janë ato:** **Vërejtje:**
P- 17 A keni ndier në çfarëdo lloj mënyre presion nga pushtetet lokale për atë se keni kërkuar debat publik, apo se keni raportuar për ndonjë ndryshim ose implikim buxhetor ndaj sferave të caktuara të buxhetit? **a) Jo** **b) Po (Theksoni ato raste)** **Vërejtje:**
P- 18 A ndiheni të lirë të diskutoni publikisht (për mediat – të transmetoni në publik) çështje/probleme që lidhen me buxhetin dhe me procesin buxhetor lokal? **a) Nuk ka shkaqe** **b) Ka shkaqe – cilat janë ato:** **Vërejtje:**